


UDHËZUES PRAKTIK

ANGAZHIMI I PARLAMENTIT NË BUXHETIMIN E PËRGJIGJSHËM GJINOR



UDHËZUES PRAKTIK
ANGAZHIMI I PARLAMENTIT NË
BUXHETIMIN E PËRGJIGJSHËM GJINOR

Lista e Shkurtimeve

| | |
|--------------|--|
| BPGJ | Buxheti i Përgjigjshëm Gjinnor |
| BVSH | Buxheti Vjetor i Shtetit |
| CEDAW | Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimi ndaj Grave |
| FMN | Fondi Monetar Ndërkombëtar |
| KLSH | Kontrolli i Lartë i Shtetit |
| MFE | Ministria e Financave dhe Ekonomisë |
| MSHMS | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale |
| NJVQV | Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore |
| OECD | Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim |
| OSHC | Organizata të Shoqërisë Civile |
| OZHQ | Objektiva të Zhvillimit të Qendrueshëm |

Tabela e Përmbajtjes

| | | | |
|---|----|---|----|
| Përmbledhje Ekzekutive | 6 | 3. Roli i parlamentit në integrimin e BPGJ në procesin buxhetor | 46 |
| 1. Hyrje | 9 | 3.1 Parlamenti dhe BPGJ në fazën e formulimit të buxhetit | 47 |
| 1.1 Kuptimi i Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjikor | 10 | 3.2 Parlamenti dhe BPGJ gjatë fazës së miratimit të buxhetit | 49 |
| 1.2 Buxhetimi i Përgjigjshëm Gjikor në kuadrin ndërkombëtar | 13 | 3.3 Parlamenti dhe BPGJ në fazën e zbatimit dhe monitorimit | 53 |
| 1.3 Kuadri ligjor kombëtar dhe detyrimet strategjike në kuadër të integritimit gjikor dhe buxhetimit të përgjigjshëm gjikor në Shqipëri | 15 | 3.4. Parlamenti dhe BPGJ në fazën e auditimit dhe mbikëqyrjes | 54 |
| 1.3.1 Buxhetimi gjikor në njësitë e qeverisjes qendrore | 15 | 4. Programet për të mbështetur parlamentet në procesin e BPGJ | 56 |
| 1.3.2 Buxhetimi gjikor në njësitë e vetëqeverisjes vendore | 16 | 4.1 Strategjia e gjerë për angazhimin e Parlamentit në BPGJ-së | 56 |
| 1.3.3 Buxhetimi i Përgjigjshëm Gjikor si pjesë e detyrimeve strategjike kombëtare | 18 | 4.2 Programi për angazhimin e Parlamentit në BPGJ: Hapat kryesore | 58 |
| 1.4 Rëndësia e buxhetit të shtetit në financimin e politikave dhe programeve të përgjigjshme gjikore | 19 | 4.3 Partneritetet | 61 |
| 1.5 Hartimi i buxhetit vjetor | 20 | 4.4 Pikat e hyrjes për angazhim | 62 |
| 2. Ndërtimi i sistemeve të qeverisjes që mbështesin buxhetimin e përgjigjshëm gjikor në procesin buxhetor | 26 | 5. Konkluzione | 65 |
| 2.1 Integrimi i gjinisë në formulimin e buxhetit vjetor të shtetit | 27 | Anekse | 66 |
| 2.2 Miratimi i buxhetit | 31 | Aneks 1: Pyetjet kryesore për të përcaktuar ndërhyrjet me parlamentin | 66 |
| 2.3 Zbatimi i Buxhetit | 38 | Aneks 2: Përmbledhje e këshillave të shpejta të ofruara në udhëzues | 68 |
| 2.4 Monitorimi i Buxhetit | 38 | Aneksi 3: Pyetjet kryesore për analizën e kontekstit për punën e BPGJ | 69 |
| 2.5 Auditimi i buxhetit për të identifikuar mësimet e nxjerra | 40 | Aneksi 4: OZHQ 5 treguesi 5.c.1 | 70 |
| 2.5.1 Raportimi i përgjigjshëm gjikor | 40 | | |
| 2.5.2 Vlerësimi i ndikimeve gjikore | 41 | | |
| 2.5.3 Auditimi i jashtëm | 41 | | |

Përmbledhje Ekzekutive

Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor (BPGJ) është një qasje strategjike për të integruar në mënyrë sistematike objektivat e barazisë gjinore në politikat qeveritare, planifikim, buxhetim, monitorim, vlerësim dhe auditim.

BPGJ e ve theksin tek ndikimi i buxhetit (të ardhurat dhe shpenzimet) mbi burrat dhe grate dhe ka si objektiv planifikimin e shpërndarjes ose rialokimin e burimeve në dispozicion për të siguruar që të dyja gjinitë të përfojnë njëloj nga shpenzimet qeveritare.¹ Gjithashtu, duke pasur si qëllim arritjen njëkohësisht të drejtësisë gjinore dhe fiskale, Buxhetimi i Përgjigjshëm Gjinor analizon ndikimin e buxheteve qeveritare mbi grupet e ndryshme të njerëzve për të bërë të mundur transformimin e buxhetit në mënyrë të tillë që ai të kontribuojë në arritjen e angazhimeve qeveritare mbi barazinë gjinore².

Pavarësisht progresit të kohëve të fundit drejt barazisë gjinore, normat tradicionale gjinore dhe rolet që shoqëria vendos për burrat dhe grate kanë rezultuar në një numër më të madh grash që mbajnë barrën e kujdesit të paguar dhe papaguar si edhe punëve shtëpiake, duke vendosur një barrë joproporcionale në kohën e tyre, burimet financiare si edhe mirëqënien që grate kanë kundrejt burrave. Nisur nga sa më sipër, Buxhetet e Përgjigjshme Gjinore nevojiten për të siguruar që politikat e qeverisë të mos krijojnë, ruajnë ose përkeqësojnë pabarazitë gjinore si ato të cituara më sipër, por përkundrazi, të punojnë për të përmbushur nevojat e veçanta të burrave dhe grave nga të gjitha kategoritë e grupeve vulnerabël.

Deputetët janë në pozitë të mirë për të çuar përpara barazinë gjinore përmes angazhimit aktiv dhe përdorimit të BPGJ-së gjatë gjithë ciklit buxhetor. Ky manual është një burim praktik për deputetët me qëllim ofrimin e mbështetjes dhe kontribuimin në zbatimin e Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjinor në të gjithë ciklin e menaxhimit buxhetor. Manuali bazohet në analizën dhe integrimin e BPGJ në të gjithë ciklin buxhetor. Ai përmban udhëzime hap pas hapi të nevojshme për t'u ndjekur nga deputetët, raste studimore dhe praktika pozitive premtuese për arritjen e BPGJ në procesin buxhetor. Në terma të përgjithshme, deputetët marrin draft-buxhetin të propozuar nga qeveria gjatë fazës së formulimit të buxhetit. Gjatë diskutimit të draft buxhetit ata, mund të debatojnë drejtimin e përgjithshëm të shpenzimeve dhe prioritetëve qeveritare, analizojnë buxhetet e kaluara dhe të angazhohen në konklime publike për të identifikuar boshllëqet dhe për të identifikuar mundësitë për përmirësim duke kërkuar të dhëna dhe informacione shtesë nga ekzekutivi. Për të mbështetur BPGJ-në në këtë fazë të procesit buxhetor, deputetët mund të kërkojnë që ministrinë, departamentet dhe agjencitë qeveritare të ofrojnë planet/ projektet qeveritare të bazuara në të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe të raportojnë lidhur me ndikimin që sjellin propozimet e tyre (përmes buxhetit) mbi grupet e ndryshme të burrave dhe grave.

Në këtë mënyrë, përmes diskutimit të projekt buxhetit në komisionet qeveritare si edhe duke u bërë pjesë e konsultimeve publike të projekt buxhetit, deputetët janë në gjendje të ndikojnë në formulimin e buxheteve të përgjigjshme gjinore, përmes ofrimit të sugjerimeve/ rekomendimeve mbi propozimeve në shqyrtim. Në shumë juridiksione, pas dërgimit nga qeveria të draft

1. UN Women, 2020. Gender responsive budgeting Blended Training Course. Training Center, UN Women.
2. UK Women's Budget Group, 2018. A Guide to Gender-Responsive Budgeting, London, <https://oxfamlibrary.openrepository.com/bitstream/handle/10546/620429/gt-guide-gender-responsive-budgeting-280218-en.pdf;jsessionid=A14792715657768CCB389D48A9D62D06?sequence=13>.

buxhetit final për miratim nga Parlamenti, mundësia e deputetëve për të ndërhyrë dhe ndyshuar propozimet qeveritare është disi e kufizuar nisur nga kufitimeve procedurale dhe afatet kohore. Megjithatë, edhe gjatë kësaj faze, deputetët mund të angazhohen duke kryer analizën e shpenzimeve financiare të planifikuara për arritjen e angazhimeve qeveritare dhe prioritetëve strategjike.

Për të mbështetur BPGJ-në, deputetët mund të analizojnë propozimet e parashikuara në draft-buxhet me lente gjinore si edhe të kryejnë analiza bazuar në të dhënat në dispozicion për të evidentuar ndikimin e mundshëm negative të shpenzimeve të planifikuara mbi grupet e ndryshme të njerëzve dhe të hartojnë raporte lidhur me këtë gjetje dhe rezultatet e analizës gjinore të shpenzimeve buxhetore të planifikuara. Gjatë fazës së zbatimit nga ana e qeverisë të buxhetit të miratuar, deputetët luajnë një rol kyç në monitorimin dhe vlerësimin e shpenzimeve buxhetore për të siguruar përputhshmërinë me qëllimet, objektivat dhe treguesit e performancës së buxhetit të miratuar. Në këtë fazë deputetët mund të mbështesin BPGJ duke kërkuar që raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit (4 mujore dhe vjetore) të analizojnë realizimin e shpenzimeve buxhetore bazuar në të dhëna të ndara sipas gjinisë për cdo program buxhetor.

Gjithashtu, gjatë kësaj faze, deputetët mund të bashkëpunojnë me aktorë të jashtëm nëpërmjet komisioneve parlamentare për të analizuar dhe raportuar mbi ndikimet gjinore të shpenzimeve publike dhe për të ofruar rekomandime se ku duhet të rialokohen fondet për të mbështetur rezultate të barabarta gjinore. Në fund të çdo viti fiskal, buxheti auditohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Gjithashtu, edhe organizatat e shoqërisë civile mund të hartojnë raportet e tyre të monitorimit dhe auditimit të buxhetit duke ofruar perspektiva të vlefshme lidhur me ndikimin e shpenzimeve publike mbi grupet e ndryshme të burrave dhe grave. Deputetët, edhe pse nuk janë pjesë e veprimtarisë audituese, mund të përdorin raportet e auditit si të Kontrollit të Lartë të Shtetit, ashtu edhe shoqërisë civile me qëllim kryerjen e analizave të performances së buxhetit dhe formulimin e

rekomandimeve në mbështetje të përgatitjes së buxhetit për vitin e ardhshëm. Zhvillimi efektiv i BPGJ kërkon arritjen e një ekuilibri të drejtë midis kompetencave individuale dhe mbështetjes institucionale. Pa mbështetje solide nga lidhshipi dhe korniza të forta institucionale për të mundësuar aktorët shtetërorë dhe të shoqërisë civile që të punojnë së bashku në zhvillimin e buxheteve të përgjigjshme gjinore, BPGJ rrezikon të reduktohet në një ushtrim tërësisht formal ("tick-box"), shumë larg qëllimit të tij për të mbështetur arritjen e barazisë gjinore.

Elementët dhe instrumentat që janë vendimtarë në mbështetjen e përpjekjeve të deputetëve për zbatimin e BPGJ-së:

- ⦿ Ekzistenca e një Strategjie Kombëtare të Barazisë Gjinore e drejtuar nga rëndësia e arritjes së barazisë gjinore në të gjitha sferat e jetës dhe që përmban objektiva të ndjeshme gjinore;
- ⦿ Hartimi dhe publikimi i pasqyrës gjinore të buxhetit (Ministria e Financave dhe Ekonomisë);
- ⦿ Mbështetje e gjerë qeveritare mbi BPGJ për të forcuar njohuritë dhe kapacitetet mbi aspektet ligjore dhe konceptuale të gjinisë, barazisë gjinore dhe buxhetimit të përgjigjshëm gjinor;
- ⦿ Angazhim i fortë për menaxhimin e financave publike, buxhetimin e bazuar në performancë, raportimin, transparencën dhe llogaridhënien, të mbështetura nga politikat për të përmirësuar mbledhjen dhe analizën e të dhënave të ndara sipas gjinisë;
- ⦿ Një kulturë partneriteti dhe bashkëpunimi ndërmjet partive politike, komisioneve, akademisë dhe organizatave të shoqërisë civile për të mbështetur shkëmbimin e hapur të informacionit.

Sa më i institucionalizuar të jetë BPGJ në nivel qeveritar, aq më shumë do të jenë në gjendje deputetët dhe aktorët e tjerë kyç të përmirësojnë situatën e barazisë gjinore me punën e tyre.

Aktorët shtetërorë mund të ndjekin një proces me tetë hapa për hartimin e programeve për të mbështetur deputetët në zbatimin e BPGJ:

1. Kryerja e një analizë të plotë për të kuptuar kontekstin në të cilin do të zhvillohet programi;
2. Përcaktimi i sfidave që politikat dhe/ose programet e propozuara do të adresojnë;
3. Krijimi i një teorie ndryshimi që do të përcaktojë se si politika(t) dhe/ose programi(et) do të adresojnë sfidat e evidentuara gjatë analizës;
4. Identifikimi i aktorëve kryesore përmes të cilave mund të zbatohet politika dhe/ose programi (et);
5. Përqendrimi në testim dhe të provuarit fillimisht të zbatimit të programit/politikës në një shkallë të vogël ose përmes iniciativave pilot;
6. Marrja kohë për të vlerësuar ndërhyrjet e programit për të marrë mësim dhe identifikimi i faktorëve që lidhen me rezultatet e planifikuara;
7. Promovimi dhe ndarja e rezultateve me partnerët dhe përfituesit;
8. Bazuar në rezultatet e arritura, identifikimi i një rrugë për institucionalizimin e reformës/ave.

Ky proces do të ketë një ndikim më domethënës në kushtet e një ndërgjegjësimi më të madh për të ndryshuar prioritetet politike dhe të bashkëpunimit të integruar me një rrjet të partnerëve të zbatimit dhe ekspertëve të fushës nga qeveria, akademia dhe shoqëria civile. Angazhimi i nivelit ekzekutiv ndaj parimeve të barazisë gjinore është, sigurisht, një faktor kyç në suksesin e çdo iniciative dhe politike të aplikimit të BPGJ-së.

Megjithatë, mungesa e angazhimit qeveritar në nivel të lartë nuk duhet t'i pengojë deputetët për të punuar me burimet dhe kapacitetet që kanë në dispozicion për të ndikuar në miratimin e një buxheti që i përgjigjet nevojave dhe prioritetëve të veçanta të burrave dhe grave nga të gjitha grupet.

1. Hyrje

Ka një njohje në rritje të rëndësisë së angazhimit të parlamenteve dhe deputetëve në buxhetimin e përgjigjshëm gjinator për të forcuar kontrollin dhe mbikëqyrjen e formulimit, ekzekutimit dhe vlerësimit të buxhetit të përgjigjshëm gjinator.

Ky manual u drejtohet kryesisht aktorëve që duan të ndërtojnë një sistem efektiv për integrimin e BPGJ-së në procesin vjetor të buxhetit të shtetit. Në mënyrë të veçantë, manuali u drejtohet anëtarëve të Parlamentit (deputetët), komisioneve parlamentare, grupeve të grave deputete, si edhe aktorëve të tjerë, duke përfshirë UN Women ose entitete të tjera të OKB-së që mbështesin një rol më të fortë për parlamentin dhe deputetët në integrimin e BPGJ-së në të gjitha fazat e procesit buxhetor. Manuali do të shërbejë si një mjet praktik për të mbështetur deputetët me qëllim aplikimin nga ana e tyre të BPGJ në mënyrë më të thjeshtuar në të gjitha fazat e ciklit buxhetor.

Manuali është ndërtuar në dy seksione:

1. Ndërtimi i sistemeve qeveritare për të mbështetur BPGJ përmes ciklit buxhetor: në të cilin vendoset theksi tek procesi se si hartohet dhe miratohet Buxheti Vjetor i Shtetit, duke pasur si qëllim kryesor diskutimin lidhur me strategjitë dhe teknikat se si mund të integrohet BPGJ brenda procesit të "ciklit buxhetor" gjatë formulimit, miratimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të buxhetit.
2. Roli i Parlamentit në angazhimin lidhur me integrimin e BPGJ në procesin e buxhetit: në të cilin vendoset theksi tek praktikata më të mira dhe iniciativat që mund të ndërmarrin deputetët gjatë veprimtarisë së tyre me qëllim garantimin e BPGJ në të gjitha fazat e ciklit buxhetor.

Ofrimi i mbështetjes së Parlamentit dhe deputetëve mbi buxhetimin e përgjigjshëm gjinator është me rëndësi të madhe për të siguruar integrimin e analizës gjinore në të gjitha fazat e planifikimit dhe buxhetimit. Në terma të përgjithshme, Parlamentet, në shumicën e shteteve, përfshirë edhe Shqipërinë, kanë kompetencë të miratojnë buxhetin e shtetit dhe më pas të monitorojnë zbatimin e tij me qëllim që t'i mbajnë qeveritë të përgjegjshme. Bazuar në këto kompetenca dhe mandate, ky manual ka si qëllim ofrimin e mbështetjes dhe forcimin e kapaciteteve të brendshme të parlamentit për të kryer analizën e buxhetit nga perspektiva gjinore si edhe forcimi i kapaciteteve të komisioneve parlamentare për të kryer analiza të bazuara në të dhëna të disagregura sipas gjinisë. Gjithashtu, manuali synon të forcojë bashkëpunimin midis Parlamentit dhe aktorëve të tjetër monitorues (Kontrolli i Lartë i shtetit, shoqëria civile etj). Për më tepër, manuali do të ofrojë njohuri jo vetëm për buxhetimin e përgjigjshëm gjinator, por edhe për menaxhimin e financave publike në Shqipëri dhe lidhjen e ngushtë me buxhetimin e përgjigjshëm gjinator për të pasur procese politikëbërjeje, strategjike dhe buxhetore sa më të përgjigjshme ndaj nevojave të ndryshme të grave dhe burrave në Shqipëri.

Duke pasur si qëllim ofrimin e një instrumenti sa më praktik, në manual ofrohen shembuj dhe raste praktike të përfshirjes të BPGJ në menaxhimin e financave publike në Shqipëri si edhe shembuj të praktikave botërore, duke ofruar këshilla dhe rekomandime të cilat do të ndihmojnë deputetët në përfshirjen e BPGJ në faza të ndryshme të ciklit buxhetor.

1.1 Kuptimi i Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjnor

Buxhetimi i Përgjigjshëm Gjnor është procesi i formulimit, miratimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit/auditimit të Buxhetit Vjetor të Shtetit (BVSH) për të siguruar që buxheti i përgjigjet nevojave të veçanta të burrave dhe grave. Si me të gjitha format e vendimarrjes në nivel qeveritar, edhe procesi buxhetor ka qenë tradicionalisht një domen i mbizotëruar nga burra³. Edhe aty ku gratë mund të kenë marrë role më të spikatura në procesin buxhetor, strukturat patriarkale dhe rolet tradicionale mund të ndikojnë në përfshirjen në shkallë të ulët të BPGJ në procesin buxhetor. Në praktikë, kjo nënkupton që vendimet për ndarjen e fondeve shtetërore dhe vendimet për krijimin e projekteve dhe programeve të reja marrin në konsideratë dhe orientohen nga nevojat dhe prioritetet e djemve dhe burrave, duke dështuar të adresojnë në të njëjtën kohë dhe me të njëjtën fokus nevojat dhe prioritetet specifike të grave dhe vajzave. Në terma historikë, vlen të përmendim se BPGJ ka evoluar gjatë 40 viteve të fundit si një qaste strategjike e politikave që mbështet integrimin e plotë të analizës gjinore në ciklin e planifikimit dhe buxhetimit.

Më shumë se 100 vende në botë e kanë përfshirë dhe ose zbatojnë BPGJ në proceset buxhetore kombëtare me qëllim për të adresuar çështjet që lidhen me gjininë dhe mungesën historike të investimeve në shërbimet e kërkuara dhe të nevojshme nga gratë dhe vajzat. UN Women është një udhëheqëse e njohur globale në BPGJ dhe ofron politika dhe mbështetje teknike për partnerët kombëtarë për të krijuar dhe zbatuar sisteme të menaxhimit të financave publike të përgjigjshme gjinore. UN Women e përkufizon buxhetimin e përgjigjshëm gjnor (BPGJ) si: “Një qasje për të integruar në mënyrë sistematike objektivat e barazisë gjinore në politikat qeveritare, planifikimin, buxhetimin, monitorimin, vlerësimin dhe auditimin.

3. IPU and UN Women, 2021. *Map Women in Politics*, <https://www.unwomen.org/sites/default/files/Headquarters/Attachments/Sections/Library/Publications/2021/Women-in-politics-2021-en.pdf>

BPGJ synon të nxjerrë në pah ndikimin e buxhetit (të ardhurat dhe shpenzimet) mbi gratë dhe burrat dhe të rregullojë [ose rialokojë] burimet për të siguruar që të dyja gjinitë të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga burimet e qeverisë⁴. Po kështu, Këshilli i Evropës e përkufizon buxhetimin e përgjigjshëm gjnor si “Aplikim të integritetit gjnor në procesin buxhetor. Ai nënkupton një vlerësim gjnor të buxheteve, përfshirjen e perspektivës gjinore në të gjitha nivelet e procesit buxhetor dhe ristrukturim të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim promovimin e barazisë gjinore.”⁵

Në pamje të parë, shifrat e buxhetit duken neutrale ndaj gjinisë, por studimet tregojnë se modelet e shpenzimeve dhe mënyra e mbledhjes së të ardhurave nga qeveria kanë një ndikim të ndryshëm mbi burrat dhe gratë, djemtë dhe vajzat vecanërisht në dëm të grave dhe vajzave. Kjo shpjegohet me rolet sociale që shoqëria u ka përcaktuar grave/vajzave dhe burrave/djemve, ndarjen gjinore të punës, përgjegjësitë dhe aftësitë e ndryshme që ata kanë dhe me pengesat e ndryshme me të cilat gratë dhe burrat përballen, që të marra së bashku i lenë gratë në pozita të pabarabarta në krahasim me burrat në komunitetin e tyre, me më pak fuqi ekonomike, sociale dhe politike⁶.

Një qeverisje e përgjigjshme gjinore, merr parasysh nevojat, interesat, përparësitë dhe shqetësimet e ndryshme të:

- ⦿ grave dhe burrave,
- ⦿ vajzave dhe djemve

Në këtë aspekt, buxhetimi i përgjigjshëm gjnor është procesi nëpërmes të cilit **analizohen buxhetet publike**, duke i vlerësuar sa i përgjigjen ato nevojave

4 UN Women, 2020. *Gender responsive budgeting Blended Training Course*. Training Center, UN Women

5 Këshilli i Evropës Përfshirja e perspektivës gjinore në procesin buxhetor: Raporti përfundimtar i grupit të specialistëve mbi përfshirjen e perspektivës gjinore në procesin buxhetor (EG-S-GB), Strasburg, EG-S-GB (2004), RAP AN 2005

6. Ibid, fq 10.

të grave dhe burrave, djemve dhe vajzave si dhe nëse ato kontribuojnë apo jo për rritjen e barazisë midis grave dhe burrave. Buxheti i përgjigjshëm gjinator i **paraprin** ndërmarrjes së iniciativave për arritjen e barazisë gjinore. Në diskutimet aktuale, **buxheti gjinator** kuptohet si një **proces për përfshirjen e analizave sistematike** dhe zhvillimin e politikave buxhetore publike, me fokus në barazinë gjinore. Për këtë arsye ai nuk është një proces i vetëm, i shkëputur që bëhet vetëm në fillim të vitit ose në një moment të caktuar. Duke qënë se politikat publike përmbajnë edhe planifikimi buxhetor për arritjen e tyre, atëherë procesi i buxhetimit të përgjigjshëm duhet parë si një proces sistematik, i vazhdueshëm, që duhet të ndërmerret nga të gjithë aktorët që janë pjesë e këtyre politikave në momentin që i hartojnë ato.

Në këtë mënyrë mundësojmë që:

- Që të gjitha vendimet politike të lidhura me buxhetin, masat, programet dhe kuadrin ligjor, **të shqyrtohen në lidhje me impaktin e tyre** të ndryshëm tek të dy gjinitë.
- I gjithë procesi buxhetor të hartohet në mënyrë të tillë që mundëson zbatimin e një **shpërndarje të barabartë** të burimeve sipas nevojave gjinore.

Aktualisht, integrimi gjinator është qasja kryesore ndërkombëtare për të promovuar barazinë midis grave dhe burrave, teksa synon t'i bëjë më të ndjeshëm nga pikëpamja gjinore politikëbërjen dhe zbatimin e programeve nga qeveria, duke shmangur programet e veçuara dedikuar grave ose gjinisë. Megjithatë, kjo qasje do të jetë e frytshme vetëm nëse alokohen burime të mjaftueshme njerëzore, financiare, dhe materiale. Nëse këto burime nuk janë të disponueshme, atëherë aspektet e ndjeshme gjinore të politikave mund të jenë të shkruara në letër, por nuk përkthehen në praktikë. BPGJ-ja përqendrohet te garantimi i disponueshmërisë së burimeve financiare në veçanti⁷.



CFARË ËSHTË BUXHETIMI I PËRGJIGJSHËM GJINOR

BUXHETIMI I PËRGJIGJSHËM GJINOR ËSHTË BUXHETIM I MIRË!

Është një instrument që u mundëson qeverive të të gjitha niveleve t'u përgjigjen nevojave të ndryshme të grave dhe burrave, duke u dhënë mundësinë të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga fondet publike.

Bazuar në sa më sipër, buxheti i përgjigjshëm gjinator është një strategji:

- ⊙ Për të matur dhe monitoruar ndikimin e politikave/programeve mbi gratë dhe burrat Për të përshtatur buxhetet në mënyrë të tillë që të arrihen synime dhe strategji të barazisë gjinore, si dhe që të përmbushen angazhimet e ndërmarrja nga qeveria nëpërmjet strategjive dhe ligjeve të ndryshme
- ⊙ Për të promovuar një analizë sistematike të politikave të buxhetit publik dhe të politikave të tyre përkatëse⁸

Buxheti i Përgjigjshëm Gjinator NUK është⁹:

- ⊙ Buxhet i veçantë vetëm për gratë dhe vajzat
- ⊙ Aplikim i 50% të buxhetit për burrat dhe djemtë dhe 50% për gratë dhe vajzat
- ⊙ Alokimi i më shumë fondeve buxhetore për gratë dhe vajzat sesa për burrat dhe djemtë
- ⊙ Proces i veçantë politikëbërjeje dhe/ose buxhetimi

7 Buxhetet gjinore, Budlender-Hewitt, 2003.

8 "UN Women "

9 Buxheti i Përgjigjshëm Gjinator, Manual për Trajnuesit, UNDP 2005.

Deri më sot, pjesa më e madhe e punës për BPGJ-në është fokusuar në ekzekutivin, duke përfshirë mbështetjen për ministrinë për të aplikuar analiza të ndryshme në proceset dhe vendimet e planifikimit dhe buxhetimit. Megjithatë, aplikimi i BPGJ në mënyrë efektive kërkon një qasje të tërë qeveritare, si dhe angazhimin aktiv të aktorëve të jashtëm në faza të ndryshme.

Duke u bazuar në sloganin **“Njerëz të ndryshëm, nevoja të ndryshme”**, buxheti i përgjigjshëm gjinor ndihmon politikbërësit për t’u njohur me diferencat në nevoja dhe prioritetet midis vajzave dhe djemve, burrave dhe grave në të gjitha sferat e jetës ekonomike, sociale, politike e kulturore.

Për më tepër, përmes këtij procesi arrihen të evidentohen edhe diferencat midis grupeve të ndryshme të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve (aftësi ndryshe, origjinë etnike, të moshuar, pjesë e komuniteteve të largëta/jetojnë në zona të thella malore etj). BPGJ merr në konsideratë situatat, eksperiencat, nevojat dhe kontributin e vecantë të këtyre grupeve duke njohur shërbimet që nevojiten dhe mënyrën e ndryshme se si burrat dhe gratë përdorin dhe përfitojnë nga shërbimet ekzistuese. Në këtë mënyrë buxheti i përgjigjshëm gjinor rrit të kuptuarit në lidhje me pyetjet : **Kush ka nevojë, kur dhe ku?**

Parlamentet mund të luajnë një rol thelbësor në përfshirjen e perspektivës gjinore në procesin buxhetor për të siguruar që buxheti publik pasqyron gamën e përvojave dhe prioritetëve të grave dhe burrave. Një rol i tillë është thelbësor për të siguruar që programet dhe financimi qeveritar adresojnë në mënyrë efektive nevojat e të gjithëve. Për të ndërhyrë në të gjitha fazat e BPGJ, deputetët duhet të njohin se buxheti i përgjigjshëm gjinor është një proces i cili përfshin gjashtë faza kryesore si më poshtë vijon:

Fazat kryesore të Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjinor:

1 Analiza e situatës së grave, burrave, vajzave dhe djemve në një sektor të caktuar, për të kuptuar nevojat e tyre të ndryshme bazuar mbi rolet gjinore që luajnë.

2 Vlerësimi i përmasave në të cilat një politikë sektori trajton situatën (e gjinizuar) e përshkruar në hapin e parë.

3 Integrimi i përparësive të grave dhe burrave (bazuar në rezultatet e analizës dhe vlerësimit të bërë në dy hapat më sipër) në politikën sektoriale për të siguruar që kjo politikë iu përgjigjet në mënyrën e duhur nevojave të burrave, grave, djemve e vajzave.

4 Një vlerësim të faktit nëse alokimet buxhetore janë të mjaftueshme për të zbatuar politikën nga një përjasje që i përgjigjet perspektivës gjinore.

5 Monitorimi i faktit nëse paratë janë shpenzuar sipas planit, çfarë u krye dhe për kë.

6 Një vlerësim i faktit nëse politika siç është zbatuar e ka ndryshuar situatën e përshkruar në hapin e parë, duke sjellë rritjen e barazisë gjinore.

1.2 Buxhetimi i Përgjigjshëm Gjinator në kuadrin ndërkombëtar

Normat dhe standardet ndërkombëtare ofrojnë një bazë të fortë për angazhimet e politikave kombëtare dhe operacionalizimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinator. Kjo përfshin ratifikimin, nga qeveritë, të konventave ndërkombëtare, të tilla si Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave (CEDAW). Ndonëse CEDAW-ja nuk parashikon dispozita specifike për buxhetet, politikat dhe proceset buxhetore, ajo përmban disa dispozita specifike që janë të rëndësishme për pjesëmarrjen e grave në jetën politike dhe publike, politikëbërjen, dhe barazinë gjinore, duke përfshirë sa vijon:



DISPOZITAT E CEDAW

Neni 7

Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në jetën politike dhe publike të vendit dhe në mënyrë të veçantë u sigurojnë grave, në të njëjtat kushte me burrat, të drejtën:

(b) Për të marrë pjesë në formulimin dhe zbatimin e politikave qeveritare, për të mbajtur poste publike dhe për të ushtruar të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisjes;

Neni 24

Shtetet palë zotohen të miratojnë të gjitha masat e nevojshme në shkallë kombëtare për të arritur realizimin e plotë të të drejtave të njohura në këtë Konventë.

Shteti shqiptar ka ratifikuar Konventën CEDAW, me Ligjin nr. 7767, datë 9.11.1993¹⁰ dhe Protokollin shtesë¹¹ të kësaj konvente me Ligjin nr. 9052, datë 17.4.2003. Nga ky moment, shteti shqiptar ka shprehur vullnetin e tij për të përmbushur detyrimet që dalin nga kjo konventë, në lidhje me barazinë gjinore dhe eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave. Krahas CEDAW, të gjitha vendet e rajonit kanë ratifikuar dokumentet e miratuara gjatë Konferencës së Katërt Botërore të Kombeve të Bashkuara për Gratë, në Pekin, në vitin 1995, përkatësisht Deklaratën e Pekinit dhe Platformën e Pekinit për Veprim. Platforma e veprimit i referohet veçanërisht shfrytëzimit të buxheteve për përparimin e grave.

Kuadri normativ për financimin e barazisë gjinore përvijohet nga një sërë marrëveshesh dhe politikash të njëpasnjëshme ndërkombëtare, duke përfshirë Deklaratën dhe Platformën për Veprim të Pekinit (2005), Sesionin e Posaçëm të 23-të të Asamblesë së Përgjithshme (Pekin+5), përfundimet e miratuara të Komisionit të 52-të (2008), 58 (2014), dhe 59 (2015) për Statusin e Grave (KSG).

Në vitin 2015, qeveritë miratuan Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) dhe Agjendën 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm. Në kontekstin e OZHQ 5: Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave, një nga qëllimet e kuadrit monitorues të OZHQ-ve, lidh sistemet kombëtare të buxhetimit me zbatimin e legjisllacionit dhe politikave për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave. Qëllimi 5.c i referohet: "Miratimit dhe forcimit të politikave të shëndosha dhe legjisllacionit të zbatueshëm për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave në të gjitha nivelet"

10 Ligji nr. 7767, datë 9.11.1993, "Për aderimin në Konventën 'Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave'"

11 Ligji 9052, datë 17.4.2003, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin shtesë të Konventës "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave".

Trupa e të drejtave të njeriut, veçanërisht Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore dhe CEDAW, ndalojnë të gjitha format e diskriminimit kundër grave dhe i detyrojnë Shtetet që të marrin masa "nëpërmjet mjeteve të përshtatshme dhe pa vonesa" për të zbatuar politikën e eliminimit të të gjitha formave të diskriminimit, dhe për të përdorur masat buxhetore për realizimin progresiv të të drejtave të grave.

Këto detyrime për qeveritë ofrojnë udhëzime të rëndësishme rreth progresit me mundësimin e financave për barazinë gjinore, si dhe janë pika kyç të punës advokuese për Buxhetimin e Përgjigjshëm Gjinor. Nuk janë vetëm udhëzime për aspektin e shpenzimeve, por edhe për rritjen e të ardhurave shtetërore me qëllimin e garantimit të burimeve të disponueshme për realizimin e të drejtave të grave, sidomos nëpërmjet taksave progresive¹², por edhe nëpërmjet politikave të përshtatshme monetare dhe rregulloreve financiare, asistencës dhe huamarrjes.

Tri instrumentet kyç të OKB-së, që mund të përdoren si referencë për hartimin e legjislationit, politikave, programeve, planeve të veprimit ose projekteve për barazinë gjinore, ose fusha të tjera sektoriale me pikëpamje gjinore, janë:

- ◉ Platforma e Pekinit për Veprimin dhe Dokumenti i Rishikuar 20-vjeçar
- ◉ Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Agjenda shoqërore 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm
- ◉ Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW).

12 Taksat progresive i referohen një strukture taksash, që taton më tepër të ardhurat (ose pasuri) më të larta, duke garantuar që individët me më shumë të ardhura kontribuojnë më tepër të të ardhurat publike. E kundërta e taksave progresive janë taksat regresive, që i referohen një sistemi të tillë që në raport me të ardhurat, ata individë që kanë më shumë të ardhura paguajnë më pak taksë, si përqindje të të ardhurave të tyre. Ky rast gjen zbatim me tatimin e vlerës së shtuar, që zakonisht ka një përqindje fikse dhe të gjithë paguajnë të njëjtën normë tatimore për konsumin e mallrave. Në këtë mënyrë, personat me të ardhura më të ulëta paguajnë një përqindje më të lartë nëpërmjet tatimit të vlerës së shtuar sesa personat me të ardhura më të larta.

Në nivel evropian, vlen të përmendim se barazia gjinore është një nga vlerat themelore të Bashkimit Evropian, ndaj ky i fundit e ka parashtruar qëllimin e tij për të promovuar barazinë ndërmjet grave dhe burrave në Traktatin e Bashkimit Evropian (TBE, Nenet 2 dhe 3 (3), si dhe Nenet 21 dhe 23 të Kartës së të Drejtave Themelore). Krahas kësaj, Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE, Neni 8) i kërkon Bashkimit që të eliminojë pabarazitë dhe të promovojë barazinë midis grave dhe burrave nëpërmjet veprimtarive të veta ("integrimi gjinor).

Gjithashtu, barazia gjinore dhe avancimi i të drejtave të grave përfshihen në të gjitha dokumentet kryesore ligjore dhe politike të BE-së, si:

- ◉ Traktati i Lisbonës (*angazhimi nga Deklarata Nr. 19, shtojcë e Aktit Përfundimtar të Konferencës Ndërqeveritare, gjatë të cilës u miratua Traktati i Lisbonës*)
- ◉ Politika e BE-së për rritjen ekonomike dhe agjenda e të drejtave shoqërore e institucioneve dhe Shteteve Anëtare të BE-së synojnë pjesëmarrjen e grave në tregun e punës. Me një qëllim specifik për të mbuluar kujdesin ndaj fëmijëve, qëllimet e Barcelonës përfshijnë lehtësimin e rakordimit të jetës profesionale dhe familjare të grave dhe burrave.
- ◉ Strategjia e Barazisë Gjinore 2020 - 2025 Bashkimi i Barazisë" që nënvizon detyrimet e Traktatit, dhe zotohet që t'i japë një shtysë të re barazisë gjinore si edhe
- ◉ Plani i veprimit për barazinë gjinore (2021-2025) (GAPIII) miratuar nga Komisioni Evropian dhe Përfaqësuesi i Lartë i BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë në nëntor 2020 që përcakton një axhendë ambicioze për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në veprimin e jashtëm të BE-së, me synimin për të ruajtur progresin dhe për të përsheptuar përparimin drejt Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe angazhimeve të tjera ndërkombëtare

1.3 Kuadri ligjor kombëtar dhe detyrimet strategjike në kuadër të integritetit gjnor dhe buxhetimit të përgjigjshëm gjnor në Shqipëri

Buxheti i Përgjigjshëm Gjnor (BPGJ) është një mjet për të siguruar që angazhimet politike të ndërmarra për arritjen dhe respektimin e barazisë gjnore në nivel të pushtetit qendror dhe njësisive të vetëqeverisjes vendore (NJVV), të reflektohen dhe realizohen në praktikë nëpërmjet buxhetit.

Në terma më specifike, BPGJ është një mjet i njohur botërisht që siguron arritjen e barazisë gjnore nëpërmjet:

- ⦿ Përfshirjes së një perspektive gjnore në të gjitha nivelet e procesit buxhetor dhe ristrukturimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për të promovuar barazinë gjnore;
- ⦿ Bashkërendimit të përpjekjeve për barazi gjnore dhe menaxhimit të financave publike;
- ⦿ Analizimit të ndikimeve të ndryshme që politikatat fiskale dhe buxhetore kanë mbi gratë dhe burrat;
- ⦿ Kontributit që ofron në alokimin me efikasitet dhe efektivitet të fondeve buxhetore.¹³

1.3.1 Buxheti gjnor në njësitë e qeverisjes qendrore

Në terma ligjorë, njësitë e qeverisjes qendrore kanë detyrime të përcaktuara qartë për përfshirjen e buxhetimit të përgjigjshëm gjnor si pjesë e programit buxhetor afatmesëm. Më 18 korrik 2012, Këshilli i

Ministrave të Shqipërisë miratoi Vendimin Nr. 465 "Për integrimin gjnor në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA)". Ky vendim synonte integrimin e parimeve të buxhetimit gjnor në procesin e buxhetimit, me qëllim lehtësimin ose eliminimin e pabarazive gjnore në fusha të ndryshme, që janë prekur nga politikatat publike.

Katër vite më vonë, në 2016, me ndryshimet e ligjit nr.9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar", parimi i barazisë gjnore u shtua si pjesë e parimeve të funksionimit të sistemit buxhetor. Bazuar në Nenin 4 shkronja e) e ligjit nr.9936/2008 **barazia gjnore i referohet situatës ku burri dhe gruaja gëzojnë mundësi dhe akses të barabartë në të drejta dhe përfitime të së njëjtës natyrë.**¹⁴ **Ndryshimet në ligjin e sipërcituar i hapën rrugë përfshirjes së** buxhetimit të përgjigjshëm gjnor në menaxhimin e sistemit buxhetor. Në të njëjtën kohë, përfshirja e parimit të "barazisë gjnore" në ligjin organik të buxhetit të shtetit i hapi rrugë hartimit të akteve nënligjore për përgatitjen e Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjnor në nivel qendror dhe vendor.

Në nivel qendror, baza ligjore për hartimin e BPGJ është udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.7/2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm", në të cilën përcaktohet metodologjia e buxhetimit në bazë programi dhe performance për hartimin e PBA. Ky udhëzim ngarkon titullarët e njësisive të qeverisjes qendrore me përgjegjësinë për të siguruar që dokumenti i programit buxhetor afatmesëm, krahas parimeve të tjera të sistemit buxhetor, të respektojë edhe parimin e barazisë gjnore.

Për garantimin e këtij standardi, Udhëzimi ngarkon nëpunësit autorizues në rolin e koordinatorit të Grupit të Menaxhimit Strategjik që të sigurojnë që gjatë dy fazave të hartimit të kërkesave buxhetore të sigurojnë përfshirjen minimalisht të një qëllimi të

13 Udhëzim nr.23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së "Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore", shtojca nr.4

14 Shih ligj nr nr. 57/2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar"

politikës që adreson respektimin e plotë të barazisë gjinore ose promovon barazinë gjinore në fushën/ sektorin përkatës për secilin program buxhetor në përgjegjësinë e tyre.¹⁵ Gjithashtu, udhëzimi parashikon se aty ku gjykohet e aplikueshme, në bashkërendim me Ministrinë përgjegjëse për financat, programet buxhetore duhet të evidentojnë objektiva konkretë me bazë gjinore të shoqëruara me tregues të përshtatshëm dhe të matshëm performance.¹⁶

Me qëllim planifikimin e qëllimeve dhe objektivave, si edhe matjen e progresit të arritur në fushën e barazisë gjinore, udhëzimi parashikon si pjesë të përgjegjësisë të nëpunësve të autorizuar për marrjen e masave të nevojshme për të mundur evidentimin, mbledhjen dhe administrimin e të dhënave të disagreguara sipas gjinisë. Të njëjtat parashikime përcaktohen në udhëzim edhe në drejtim të Drejtuesit të Programit Buxhetor.¹⁷

Në terma më specifike, shtojca nr.5 e Udhëzimit Nr.7 “nr.7/2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm” e titulluar “Udhëzime mbi përgatitjen e Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjinor” parashikon se “në përputhje me parimin e barazisë gjinore të gjitha programet buxhetore, duhet të përcaktojnë **të paktën një objektiv me bazë gjinore** të shoqëruar me tregues performance respektive në nivel objektiv dhe produkti. Aty ku është e aplikueshme, programet buxhetore duhet të përcaktojnë apo reflektojnë **qëllime të politikës në përputhje të plotë me qëllimet strategjike të arritjes së barazisë gjinore** të përcaktuara në SKZHI, strategjitë ndërsektoriale dhe sektoriale, duke evidentuar qartë dhe treguesit përkatës të performancës.”¹⁸

Gjithashtu, në udhëzimin vjetor të përgatitjes së

15 Udhëzim i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë Nr.7 “nr.7/2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm, kreu 2.4, pika 6, shkronja i.

16 Ibid, shkronja j.

17 Udhëzimi Nr.7 “nr.7/2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm, kreu 2.4, pika 6, shkronja k.

18 Shtojca Nr.5 e Udhëzimit Nr.7 “nr.7/2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm, kreu 2.5, pika 5, shkronja h.

Programit Buxhetor Afatmesëm parashikohet ndër të tjera se të gjitha ministritë e linjës dhe institucionet e tjera buxhetore qendrore, duhet të kryejnë analiza me bazë gjinore të sektorit përkatës, me qëllim:

Përcaktimin e objektivave dhe treguesve të performancës me bazë gjinore, që ndihmojnë në kryerjen e analizave gjinore të sektorit përkatës dhe matjen e performancës së programit buxhetor;

Detajimin e objektivave me bazë gjinore në produkte dhe kosto, të cilat synojnë zbutjen e pabarazive gjinore apo/dhe arritjen e barazisë gjinore, aty ku është e mundur.

1.3.2 Buxhetimi gjinor në njësitë e vetëqeverisjes vendore

Në nivel vendor, baza kryesore ligjore për hartimin e BPGJ është ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” është përcaktuar se ligji ka për qëllim të sigurojë që në krijimin dhe shpërndarjen e burimeve financiare vendore të njësisë të vetëqeverisjes vendore përshpejtohet dhe realizohet barazia gjinore. Në përputhje me këtë parim, të gjitha programet buxhetore, aty ku është e mundur, duhet të përcaktojnë të paktën një objektiv me bazë gjinore të shoqëruar me tregues performance respektive në nivel objektiv dhe produkti.

Gjithashtu, në pikën 4 të nenit 36 “Programi Buxhetor Afatmesëm Vendor”, përcaktohet se PBA përfshin informacion për qëllimet e politikave të programeve, projektet e investimeve publike, produktet e programeve dhe kostot e tyre përkatëse. Sipas

shkronjës c të kësaj pike **“të paktën një nga objektivat e politikave të programeve duhet të adresojë problematika të pabarazisë gjinore ose respektimin e plotë të barazisë gjinore duke identifikuar qartazi produktet dhe treguesit e tjerë të matshëm me bazë gjinore.”**¹⁹

Në terma të hartimit të raporteve të monitorimit, nenin 54 i ligjit nr.68/2017 “Raportimi financiar”, parashikon në mënyrë specifike se treguesit financiarë që publikohen, përfshijnë por nuk kufizohen në raportin e shpenzimeve për politikën që mbështesin barazinë gjinore ndaj shpenzimeve të përgjithshme. Bazuar në ligjin nr. **ligji nr.68/2017, Ministria përgjegjëse për çështjet e financave ka hartuar udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor Afatmesëm të njësisë të vetëqeverisjes vendore”**. Në pjesën e parë të udhëzimit “Të përgjithshme” përcaktohet si më poshtë:

*“Qëllimet e politikës të programit, objektivat e politikës së programeve, produktet e programeve dhe kostot përkatëse, shoqëruar me treguesit e performancës. **Të paktën një nga objektivat e politikave sipas programeve duhet të adresojë problematika të pabarazisë gjinore ose respektimin e plotë të barazisë gjinore, duke identifikuar qartazi produktet dhe treguesit e tjerë të matshëm me bazë gjinore”***

Ky udhëzim përcakton edhe përgjegjësitë e Kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore lidhur me buxhetimin me bazë gjinore. Kështu, Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore në rolin e kryetarit të Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS), ka përgjegjësinë të drejtë, koordinojë GMS dhe të garantojë pjesëmarrjen e drejtuesit të çdo programi buxhetor, në seancat dëgjimore të buxhetit të organizuara me komunitetin.



PËRGJEGJËSITË E KRYETARIT TË GRUPIT TË MENAXHIMIT STRATEGJIK (GMS)

- Të japë udhëzime në lidhje me identifikimin e qëllimeve, objektiveve të politikës së programit për të gjithë drejtuesit e programeve, duke siguruar që për çdo program respektohet barazia gjinore ose promovimi i saj;
- Të kërkojë nga drejtuesit e programeve që të evidentojnë, mbledhin dhe administrojnë të dhëna sipas gjinisë në mënyrë që të planifikohen qëllimet dhe objektivat me bazë gjinore si dhe për të matur progresin në lidhje me to.

Në pikën 38 të udhëzimit, përcaktohet në mënyrë specifike, se Drejtuesit e Ekipit të Menaxhimit të Programit janë përgjegjës për:

a. Përcaktimin për programin buxhetor në përgjegjësinë e tyre të minimalisht një qëllimi të politikës që adreson respektimin e plotë të barazisë gjinore ose promovon barazinë gjinore në fushën/ sektorin përkatës. Aty ku gjykohet e aplikueshme, të përcaktojnë objektiva konkretë me bazë gjinore të shoqëruara me tregues të përshtatshëm dhe të matshëm performance, ku do të synohet që të identifikohet një ose disa produkte me kostot përkatëse që do të kontribuojnë në realizimin e tyre;


Shtojca nr.4 e udhëzimit përmban një informacion të detajuar për buxhetimin gjinor në njësitë e vetëqeverisjes vendore duke parashikuar se në përputhje me parimin e barazisë gjinore të përcaktuar në ligjin Nr. 68, datë Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të gjitha programet buxhetore në njësitë e qeverisjes vendore, aty ku është e mundur, duhet të përcaktojnë të paktën një objektivi me bazë gjinore të shoqëruar me tregues performance respektive në nivel objektivi dhe produkti.

¹⁹ Ligj nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, Neni 36, pika 4/ c

Gjithashtu, në këtë shtojcë parashikohet se “aty ku është e aplikueshme, programet buxhetore duhet të përcaktojnë apo reflektojnë qëllime të politikës në përputhje të plotë me:

- Qëllimet strategjike të arritjes së barazisë gjinore të përcaktuara në SKZHI, strategjitë sektoriale vendore;
- Planet e zhvillimit vendor;
- Udhëzimet e Kryetarit të Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore;
- Udhëzimet e Këshillit të Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore.

Për të siguruar adresimin e drejtë të pabarazive dhe diskriminimit, në kuadër të procesit të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor dhe përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, njësia e vetëqeverisjes vendore, rekomandohet të ndjekë hapat e mëposhtëm:



Në kuadër të përgatitjes së raporteve të monitorimit, **Udhëzimi nr.22 datë 30.07.2022 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore”** parashikon në shtojcën 2 “Përmbajtja e raportit të monitorimit” se relacioni shpjegues për çdo format duhet të përfshijë ecurinë e realizimit të qëllimeve, dhe objektivave të politikës që trajtojnë çështjen e barazisë gjinore nëpërmjet treguesve të performancës.

1.3.3 Buxhetimi i Përgjigjshëm Gjinor si pjesë e detyrimeve strategjike kombëtare

Në nivel strategjik, buxhetimi i përgjigjshëm gjinor ka qënë pjesë e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015- 2020, duke u vendosur në këtë mënyrë në strategjinë ombrellë të të gjithë kuadrit strategjik në Shqipëri. Në harmonizim me SKZHI, koncepti i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor është përkthyer në objektiva specifike dhe masa si pjesë e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030. Konkretisht, Qëllimi strategjik IV i kësaj strategjie “Aplikimi i integritit gjinor si mjet për arritjen e barazisë dhe drejtësisë gjinore në shoqëri parashikon dy objektiva specifike të lidhur me zbatimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në nivel qendror dhe vendor:

Objektivi specifik IV.2: Monitorimi i zbatimit të programeve në të cilat është aplikuar buxhetimi i përgjigjshëm gjinor, në nivel qendror.

Objektivi specifik IV 3: Mbështetja e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për njohjen dhe zbatimin e detyrimit ligjor për aplikimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor.

Për arritjen e objektivave të mësipërm, SKBGj 2021-2030 ka detajuar në planin e saj të veprimit masat konkrete për t’u zbatuar nga njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore me qëllim arritjen e këtyre rezultateve:

- ⊙ Buxheti i alokuar dhe i shpenzuar në lidhje me programet buxhetore të raportuara si programe të ndjeshme gjinore, në nivel qendror, i monitoruar dhe raportuar.
- ⊙ Buxhetet e NJVV reflektojnë zbatimin korrekt të legjislacionit mbi aplikimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinator.

1.4 Rëndësia e buxhetit të shtetit në financimin e politikave dhe programeve të përgjigjshme gjinore

Si administratorë të portofolit publik, qeveritë janë përgjegjëse për ta siguruar që çdo person ka mjetet, mbështetjen dhe shërbimet e nevojshme për të realizuar të drejtat dhe zhvillimin social dhe ekonomik të tij. Qëllimet e politikës së brendshme mund të mbështeten nga instrumentat ndërkombëtare dhe organizatat ndërkombëtare joqeveritare (ONJQ) që mbështesin qeveritë në vendosjen e sistemeve dhe kornizave të yhvillimit ekonomik dhe social në vend. Siç e përmendëm edhe më sipër, në Axhendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, të gjitha shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara (OKB) kanë miratuar dhe janë angazhuar për zbatimin e shtatëmbëdhjetë Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ). Arritja e këtyre Objektivave kërkon një përpjekje të gjithë qeverisë për të formuluar, miratuar dhe zbatuar një kuadër ligjor gjithëpërfshirës në nivel kombëtar dhe lokal.

Që një qeveri të krijojë dhe zbatojë sisteme, politika dhe programe që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, ato kërkojnë një plan gjithëpërfshirës me angazhime specifike financimi. Pothuajse në çdo vend, kjo arrihet përmes Buxhetit Vjetor të Shtetit, i cili mund të konsiderohet si konvertimi i politikave publike të një qeverie (dhe prioriteteteve) në numra (buxheti). BVSH është një proces qeveritar vjetor në të cilat të ardhurat dhe shpenzimet e parashikuara të qeverisë mbi programet përcaktohen njëherësh dhe që është përcaktuar nga Organizata për Bashkëpunimi dhe Zhvillimi Ekonomik (OECD) si:

“Një deklaratë gjithëpërfshirëse e planeve financiare qeveritare që përfshijnë shpenzimet, të ardhurat, deficitin apo suficitin dhe borxhin. Buxheti është Dokumenti kryesor i politikës ekonomike të qeverisë, duke demonstruar se si qeveria planifikon të përdorë burimet publike për të përbushur qëllimet e politikave.”²⁰

Bazuar në kuptimin më lart, buxheti i përgjigjshëm gjinator kërkon të përmirësojë Menaxhimin e Financave Publike duke integruar perspektivën gjinore në mbarë sistemin.

Në këtë drejtim, buxheti i përgjigjshëm gjinator është i rëndësishëm sepse ai përmirëson:²¹

- ⊙ Llogaridhënien e qeverive dhe përfaqësuesve e përfaqësuesve të tyre, në drejtim të barazisë gjinore, nevojave, fuqizimit si dhe të drejtave të gruas.
- ⊙ Efiçencën duke siguruar që ata që kanë nevojë më shumë, të përfitojnë nga shpenzimet publike. (kyesisht gra dhe burra, djem dhe vajza nga grupe të pafavorizuara)
- ⊙ Rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe uljen e korrupsionit.
- ⊙ Monitorimin duke e ditur se ku depërtojnë shërbimet qeveritare.
- ⊙ Pjesëmarrjen e gruas në politikat e planifikimit dhe buxhetimit (kjo mundëson që proceset politikëbërëse të trajtojnë në mënyrë të efektshme nevojat e më të varfërve dhe më të pafuqishmëve).
- ⊙ Fuqizion bashkëpunimin me shoqërinë civile për të përmirësuar ndikimin e zhvillimit dhe qeverisjen demokratike (nëpërmjet proceseve të buxhetimit me pjesëmarrje, që garantojnë pjesëmarrjen e barabartë dhe aktive të grave dhe burrave nga grupet e interesuara).
- ⊙ Raportimin rreth progresit me angazhimet gjinore kombëtare dhe ndërkombëtare (ndihmon gjurmimin më të mirë të shpenzimeve publike, që synojnë trajtimin e hendeqeve gjinore).

20 OECD, Glossary of Key Terms for completing the 2012 OECD Budgeting Practices and Procedures Survey, <https://www.oecd.org/gov/budgeting/Budgeting-survey-glossary.pdf>.

21 Un Women, “Buxheti i Përgjigjshëm gjinator në Shqipëri, Një manual për punonjëset dhe punonjësit e administratës qendrore dhe vendore”, 2019

Sipas UNESCO (2010), Buxheti i Përgjigjshëm Gjikor është i rëndësishëm sepse:

- ⊙ Ndihmon për krijimin e të kuptuarit të përbashkët dhe ilustron ekzistencën e pabarazisë në ndikimet buxhetore të gratë në krahasim me burrat;
- ⊙ Rrit përgjegjshmërinë dhe përshpejton zbatimin e angazhimeve për barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut;
- ⊙ Rrit efikasitetin e buxheteve të qeverisë duke lejuar shpërndarje më të mirë të burimeve financiare. Nëse pabarazitë gjinore në ndikimet buxhetore nuk njihen, ato mund të çojnë në humbje të produktivitetit, si dhe në rënie të cilësisë së tregut të punës, rritjes ekonomike, shëndetit e mirëqenies;
- ⊙ Rrit efektivitetin e politikave dhe programeve duke vlerësuar nëse objektivat e deklaruar janë arritur;
- ⊙ Çon në transparencë, përgjegjshmëri, parashikueshmëri dhe pjesëmarrje në hartimin dhe realizimin e buxhetit.²²

1.5 Hartimi i buxhetit vjetor

Edhe në Shqipëri, si në shumë vende, hartimi dhe zbatimi i buxhetit vjetor të shtetit është kryesisht përgjegjësi e pushtetit ekzekutiv. Çdo vit, Ministria përgjegjëse për çështjet e Financave fillon një sërë konsultimesh të brendshme për të kërkuar të dhëna nga ministritë e linjës dhe agjencitë qeveritare se çfarë burimesh financiare/ fonde shtetërore ata shpresojmë të marrin për të vazhduar implementimin e programeve ekzistuese si edhe miratimin e financimit për programe, iniciativa të reja. Megjithatë, edhe pse

procesi buxhetor shpesh dominohet nga ekzekutivi dhe udhëhiqet nga Ministria përgjegjëse për çështjet e financave, Parlamenti luan një rol me rëndësi në çdo fazë të këtij procesi.

Për ta pasur më të thjeshtë, më poshtë listohen në mënyrë të përmbledhur funksionet kryesore të aktorëve që marrin pjesë në hartimit dhe zbatimin të buxhetit vjetor:

- ⊙ Ministria përgjegjëse për çështjet e financave luan rolin kryesor gjatë hartimit të buxhetit vjetor.
- ⊙ Ministrive dhe agjencive të linjës u kërkohet të paraqesin listën e tyre të prioriteteve të projekteve dhe programeve. Megjithatë, vendimi përfundimtar për financimin total është kompetencë e Ministrisë përgjegjëse për çështjet e financave.
- ⊙ Buxheti vjetor nuk është thjesht një tabelë me shuma financimi të alokuara për programe dhe projekte specifike. Ai përcakton politikën qeveritare dhe prioritetet politike për çdo vit buxhetor.
- ⊙ Parlamenti është organi kompetent përgjegjës për miratimin e buxhetit. Miratimi i legjislacionit dhe shpenzimet nga dega ekzekutive konsiderohet si një nga funksionet kryesore të një parlamenti, siç përcaktohet në kushtetutë ose legjislacionin dhe rregullat kryesore të procedurës, duke i lejuar kështu institucionit të ketë fjalën e fundit se si dhe çfarë fondet ekzekutivi dhe të ardhurat që mbledh. Niveli specifik i angazhimit dhe autoriteti i parlamentit për të ndikuar në versionin final të BVSH do të varet, pjesërisht, nga sistemi politik i vendit.
- ⊙ Pasi Buxheti Vjetor miratohet nga parlamenti, organet e pushtetit ekzekutiv angazhohen në zbatimin e tij. Çdo ministri dhe agjenci e linjës do të duhet të raportojë rregullisht (në periudha katërmujore, gjashtë mujore) mbi ecurinë e zbatimit të buxhetit të miratuar dhe realizimit

22 Un Women, "Buxheti i Përgjigjshëm gjinor në Shqipëri, Një manual për punonjëset dhe punonjësit e administratës qendrore dhe vendore", 2019

të shpenzimeve buxhetore të planifikuara. Paralelisht, sistemet e brendshme të kontrollit monitorojnë dhe masin shpenzimet nga çdo subjekt brenda qeverisë. Kjo është pjesë e sistemit të menaxhimit financiar (SMF) publik. Në këtë fazë, gjithashtu parlamenti ka një funksion të rëndësishëm në monitorimin e zbatimit të BVSH, që shpesh kryhet përmes komisioneve parlamentare.

- Së fundi, me përfundimin e vitit fiskal/buxhetor dhe pasi Buxheti Vjetor i Shtetit është zbatuar plotësisht, procesi përmbyllet me vlerësimin/auditimin e pavarur të BVSH. Ky auditim kryhet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) dhe ka si qëllim kryesisht vlerësimin nëse ekzekutivi ka shpenzuar fondet për arritjen e objektivave dhe qëllimeve të politave të programeve të synuara gjatë miratimit të tij nga parlamenti.




KËSHILLË E SHPEJTË

MERRNI KOHË PËR TË KUPTUAR PROCESIN E BUXHETIT.

Çdo vend ose juridiksion ka një proces unik buxhetor. Pjesa më e madhe e procesit mund të gjendet në rregulla dhe ligje të shkruara, të tilla si Ligji për Buxhetin ose rregullorja e Kuvendit, por shumë nga praktikatat standarde mund të mos jenë të aksesueshme publikisht ose mund të jenë norma të pashkruara që janë zhvilluar me kalimin e kohës. Merrni kohë për t'u siguruar se ka një nivel të kuptuarit se si procesi i buxheti funksionon dhe cilat pika hyrëse, formale dhe joformale, ekzistojnë për të ndikuar në proces.

Figura 1: Procesi buxhetor / Fazat



KUTI 1**QASJA BPGJ: BPGJ E DREJTUAR NGA EKZEKUTIVI**

Shumë vende në Afrikë kanë zbatuar BPGJ si pjesë të procesit të zhvillimit, miratimit dhe zbatimit të buxhetit të shtetit. Në përgjithësi, nuk është e mundur të përcaktohet një qasje e vetme e përfshirjes së BPGJ në kontinent, qasja kryesore e ndjekur nga qeveritë është bazuar në njohjen e rolit të pushtetit ekzekutiv në krijimin e sistemeve të BPGJ-së.

UN Women ka punuar me Qeverinë e Marokut që nga viti 2001 në BPGJ. Faza fillestare e mbështetjes u përqendrua në avokimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit dhe më pas kaloi në mbështetje për hartimin e Raportit të Buxhetit Gjinator (Gender Budget Statement) me të dhëna të ndara sipas gjinisë sipas sektorëve, të përdorura për të monitoruar zbatimin e buxhetit.

Në vitin 2015, miratimi i Ligjit Orgranik të Buxhetit i rishikuar, njohu në mënyrë eksplicite BPGJ-në si një komponent themelor të procesit buxhetor. Në veçanti, që nga miratimi i ligjit të ri, qeveria kërkoi që barazia gjinore të merret parasysh në të gjitha aspektet e buxhetit, duke përfshirë objektivat, rezultatet dhe treguesit e performancës të përfshirë në Buxhetin Vjetor.²³ Me mbështetjen e UN Women, Ruanda ka krijuar një histori të gjatë pune dhe progresi në BPGJ. Në vitin 2008, Ministria e Financave e Ruandës dhe Ministria e Planifikimit Ekonomik ka pilotuar BPGJ brenda ministrive.

Në vitin 2011 Ligji për Buxhetin është ndryshuar për të miratuar BPGJ në të gjithë qeverinë. Deri në vitin 2012, i gjithë aparati qeveritar punonte sipas një sistemi të konsoliduar që përfshinte

ndryshime në strukturën e çdo ministrie dhe ndryshime në kërkesat për transparencë dhe raportim. Që atëherë, drejtorive të planifikimit për secilën ministri iu ofrua mbështetje për zhvillimin e kapaciteteve dhe një nëpunës nga çdo ministri e linjës u caktua si pikë kontakti për çështjet gjinore.

Përveç kësaj, që nga viti 2013 sipas ligjit organik të buxhetit të rishikuar, secilës ministri iu kërkua të prodhojë një Deklaratë Vjetore të Buxhetit Gjinator për qëllimet gjinore të ministrisë, miratuar nga Këshilli të Ministrave dhe Parlamenti (d.m.th., Komisioni i Buxhetit) paralelisht me miratimin e Buxhetit Vjetor. Më pas, çdo ministri duhet të raportojë për zbatimin e planit të saj tek Zyra e Kryeministrit. Ekzekutivi ka krijuar gjithashtu një Zyrë të Monitorimit Gjinator që vepron në mënyrë të ngjashme me një Auditues të Përgjithshëm, por fokusohet në pajtueshmërinë me objektivat gjinore vjetore të përshkruara në pasqyrat buxhetore gjinore.

Së fundi, ekzekutivi bëri një përpjekje për të siguruar mbledhjen dhe shkëmbimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë. Kjo ka çuar në përdorimin e një sistemi informacioni të menaxhimit gjinator që mundëson qeverinë, deputetët dhe parlamentin të monitorojë shpenzimet buxhetore në përputhje me politikat gjinore kushtetuese dhe ligjore. Ruanda ka demonstruar realizueshmërinë e përfshirjes së analizës gjinore në sistemet e menaxhimit të financave publike dhe zbatimin konsistent të BPGJ në nivel kombëtar, nivel sektorial dhe lokal.²⁴

23 Ministère de l'Économie et des Finances, CE-BSG et ONU Femmes (2019), Amélioration du Rapport sur le Budget axé sur les Résultats tenant compte de l'aspect Genre.

24 Uwantege, Emma Carine. 2019. Gender Responsive Budgeting Parliamentary Guide. Rwanda Women Parliamentary Forum.

Në vitin 2007, Qeveria e Zimbabvesë miratoi BPGJ si një nga strategjitë kryesore të integritimit gjinator. Me mbështetjen e UN Women, Qeveria nisi procesin e integritimit të fortë të BPGJ-së në kornizën dhe praktikën ligjore dhe të politikave brenda procesit dhe ciklit të planifikimit të buxhetit kombëtar. Qëllimi i përgjithshëm ka qenë që të forcojë hapësirën e politikave dhe të adresojë kufizimet teknike për sigurimin e financimit për barazinë gjinore përmes ndërtimit të kapaciteteve teknike dhe menaxheriale dhe konsolidimit të partneritetit me institucionet kryesore qeveritare.

Në 2020 dhe 2021, UN Women mbështeti Ministrinë e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik në hartimin e Udhëzimeve mbi buxhetimin e përgjigjshëm gjinator dhe një instrument mbi monitorimi dhe gjurmimit të buxhetit të integruar gjinator.

Të dy këtë instrumenta mund të ndihmojnë edhe politikëbërësit dhe këshilltarët e politikave për të integruar në mënyrë efektive gjininë në të gjithë procesin buxhetor. UN Women siguroi që nëpunësit e departamenteve të buxhetit brenda Ministrisë së Financave dhe nëpunësit nga ministrinë e përzgjedhura të linjës të merrnin trajnime dhe duhur mbi përdorimin ose zbatimin praktik të udhëzimeve dhe instrumentit të monitorimit.

Gjithshtu, ofrimi i ekspertizës dhe mbështetja këshillimore për Ministrinë e Financave përfshiu edhe dërgimin e një eksperti të buxhetit gjinator në Ministri për të mbështetur zhvillimin e kapaciteteve përmes trajnimeve, seminareve, takimeve dhe metodave të tjera.

Në përgatitjen e Buxhetit 2022, Qeveria e Zimbabve paraqiti gjithashtu një kërkesë që të gjitha ministrinë të dorëzojnë pasqyrat buxhetore individuale gjinore me qëllim përpunimin dhe pasqyrimin e tyre në një Deklaratë Buxhetore Kombëtare Gjinore. Raporti i BPGJ prezantohet gjatë prezantimit kombëtar të buxhetit dhe shpërndahet në ministrinë e linjës, parlamentin dhe aktorë të tjerë.²⁵ Po ashtu, janë bërë përpjekje për të lehtësuar dialogun e politikave ndërmjet grave nga i gjithë vendi dhe Ministrinë të Financave dhe politikëbërës të tjerë përkatës në BPGJ për të siguruar që gratë të angazhohen në procesin buxhetor dhe të kryejnë analiza të përgjigjshme buxhetore të programeve dhe politikave të ministrive.

25 Ministry of Finance and Economic Development, Zimbabwe, http://www.zimtreasury.gov.zw/index.php?option=com_phocadownload&view=category&id=67&Itemid=793.

Fazat e Ciklit Buxhetor:

1 Formulimi i buxhetit: Përpara se BVSH t'i dorëzohet për miratim parlamentit, ekzekutivi zbaton një proces për zhvillimin e buxhetit dhe vendos për alokimet për të gjitha programet dhe produktet buxhetore.

2 Miratimi i buxhetit: BVSH i paraqitet Këshillit të Ministrat për miratim para prezantimit, debatit dhe miratimit brenda Parlamentit. Parlamentit i jepet një periudhë e caktuar për të shqyrtuar alokimet buxhetore përpara votimit për miratimin e BVSH.

4 Monitorimi i buxhetit: Gjatë zbatimit, buxheti duhet të monitorohet për t'u siguruar që shpenzimet po realizohen në përputhje me qëllimet dhe objektivat e përcaktuara në BVSH. Kjo përfshin të dy sistemet e monitorimit : monitorimin e brendshëm nga vetë ekzekutivi dhe monitorimin e jashtëm nga parlamenti, shoqëria civile dhe organet e pavarura mbikëqyrëse.


3 Zbatimi i buxhetit: BVSH zbatohet sipas shpenzimeve të planifikuara me qëllim realizimin e objektivave dhe arritjen e treguesve të performancës.

5 Auditimi i buxhetit: Pas përfundimit të vitit buxhetor, KLSH do të kryejë një auditim të pavarur, të jashtëm të BVSH -së dhe do të raportojë gjetjet e tij. KLSH ka mandat për të kryer auditimin e përputhshmërisë ose rregullator (d.m.th. a janë shpenzuar paratë për qëllimet e synuara nga parlamenti) si edhe mandatin për të kryer auditime të performancës që vlerëson nëse programet e qeverisë janë zbatuar duke pasur parasysh ekonominë, efikasitetin dhe efektivitetin.

Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se në terma të formatit të buxhetit vjetore të shtetit ekzistojnë disa formate të hartimit dhe raportimit të buxhetit vjetor:

- Në nivel bazë, buxheti hartohet sipas zërave buxhetore në të cilin projeksionet e shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisë renditen në një format të thjeshtë tabele (exel) ku sipas çdo zëri buxhetor detajohen shpenzimet dhe niveli i financimit nga buxheti i shtetit.. Ky lloj buxheti fokusohet në llogaridhënien financiare dhe në përcaktimin se sa fonde ndahen për çdo zë buxhetor.
- Një proces buxhetimi më gjithëpërfshirës përfshin buxhetin në nivel program buxhetor, në të cilin qeveria identifikon programet buxhetore dhe projektton shpenzime buxhetore për secilin prej programeve dhe produkteve brenda tyre. Ky format lejon një lidhje të qartë ndërmjet programeve të qeverisë dhe fondeve që do të ndahen për secilin prej produkteve buxhetore të identifikuar më parë .
- Në nivel më të lartë hierarkie është buxheti i performances në të cilin krahas buxhetimit sipas programeve hartohen treguesit e performancës me bazë gjinore me qëllim që të matet efektiviteti dhe shkalla e realizimit të objektivave dhe qëllimeve të politikave për çdo program buxhetor.

Figura 2: Formatet e Buxhetit



MESAZHET KRYESORE


1. Përpara integritit të perspektivës gjnore në procesin buxhetor, merrni kohë për të siguruar kuptimin e kuadrit ligjor dhe se si procesi i buxhetit vepron në kontekstin e dhënë.
2. Procesi i buxhetit të shtetit mund të jetë kompleks, ndaj është thelbësore të kuptohen hapat e ndryshëm dhe aktorët kritikë të angazhuar në secilën fazë për të ditur se si mund të angazhohemi për t'i mbështetur ata në zbatimin e BPGJ.
3. Çdo buxhet vjetor i shtetit ndjek një qasje standarde të bazuar në pesë fazat – formulimi, miratimi, zbatimi, monitorimi dhe auditimi – dhe secila fazë paraqet mundësi për BPGJ.
4. Qëllimi i buxhetit vjetor të shtetit është të fokusohet në politika dhe programe, i cili arrihet më së miri përmes buxhetit të performancës, i cili mund të harmonizojë analizat e BPGJ me rezultatet e synuara të performancës.
5. Aty ku procesi i BPGJ-së udhëhiqet nga ekzekutivi, është shumë e nevojshme dhe me rëndësi angazhimi dhe partneriteti me Parlamentin për të siguruar rolin e tij në analizën nëse procesi buxhetor përdor në mënyrë efektive BPGJ dhe instrumentat/mjetet e lidhura me të me qëllim avancimin e barazisë gjnore dhe fuqizimin e grave.

2. Ndërtimi i sistemeve të qeverisjes që mbështesin Buxhetimin e Përgjigjshëm Gjinator në procesin buxhetor

Ky kapitull përshkruan proceset themelore që pushteti ekzekutiv duhet të ndjekë për të zbatuar në mënyrë efektive buxhetimin e përgjigjshëm gjinator në sistemin e menaxhimit të financave publike.

Siç e theksuam edhe në kapitullin e parë, sistemi i menaxhimit të financave publike përshkruan hapat dhe aktorët që marrin pjesë në secilin prej pesë fazave të procesit buxhetor: formulimi, miratimi, zbatimi, monitorimi dhe auditimi. Menaxhimi i financave

publike i përgjigjshëm gjinator mban në konsideratë barazinë gjinore dhe rezultatet specifike gjinore në çdo hap të ciklit buxhetor. *Skema e mëposhtme jep një ide se si mund të kryhet përfshirja efektive e BPGJ-së gjatë ciklit të buxhetit:*



Në këtë kapitull, theksi vendoset në ciklin vjetor buxhetor dhe jo në proceset buxhetore afatmesme (2-3 vjet), të cilat gjithashtu duhet të konfigurohen për planifikim përtej vitit buxhetor të menjëhershëm. Kapitulli është i ndarë në pesë faza të ciklit buxhetor

duke ofruar jo vetëm mundësitë se sim und të integrohet barazia gjinore në secilën fazë, por gjithashtu duke ofruar shembuj praktik ilustrues për secilën prej tyre. Për informacion mbi metodologjinë e përdorur në këtë kapitull, shihni Kutinë 2.

KUTI 2

Shënim mbi metodologjinë për ndërtimin e sistemeve qeveritare për të mbështetur BPGJ në ciklin buxhetor

Ky kapitull është i përshtatur rreth metodologjisë për SDG Treguesi 5.c.1, Llogaridhënies për Shpenzimet dhe Financat Publike (PEFA) dhe Korniza e Menaxhimit të Financave Publike të përgjigjshme gjinore (GRPFM). Korniza e PEFA GRPFM mbështetet në Metodologjinë ekzistuese të Indikatorit 5.c.1, e cila ofron standardin ndërkombëtar për BPGJ dhe është e integruar në kuadrin global të monitorimit për

SDG-të. Treguesi i SDG 5.c.1 mat përqindjen e vendeve me sisteme për të gjurmuar dhe alokuar shpenzime publike për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave. UN Women udhëhoqi përsosjen metodologjike për treguesin, me OECD dhe PNUD, dhe në bashkëpunim me ministritë e financave, ekspertë akademikë dhe organizata të tjera ndërkombëtare. Metodologjia përfundimtare u miratua nga Eksperti Ndërinstitucional i Grupit (IAEG)-SDGs në nëntor 2017, dhe mbledhja e të dhënave me këtë metodologji është realizuar nga viti 2018-2021. Shih Aneksin 4 për më shumë detaje mbi kriteret individuale dhe pyetjet që përfshijnë monitorimin e SDG 5.c.1.

2.1 Integrimi i gjinisë në formulimin e buxhetit vjetor të shtetit

Faza e formulimit të buxhetit paraqet disa pika hyrëse për analizën gjinore. Vlen të theksojmë që në fillim, rëndësinë e veçantë që ka kryerja e vlerësimit/analizës së ndikimeve të mundshme gjinore të propozimeve të buxhetit për të informuar vendimmarrjen dhe rishikimin e buxhetit, debatin dhe miratimin.

Në këtë pjesë detajohen metodat për kryerjen e kësaj analize dhe mekanizmat që nevojiten të përfshihen në udhëzimet e përgatitjes së buxhetit për të mbështetur formulimin e buxhetit vjetor të përgjigjshëm gjinore.

A. ANALIZA E NDIKIMIT GJINOR TË PROPOZIMEVE TË POLITIKAVE BUXHETORE²⁶

Analiza e ndikimit gjinor është procesi i përcaktimit se si ndryshimet në politikën e propozuar mund të kenë efekte të ndryshme tek burrat dhe gratë gjatë dhe si rezultat i zbatimit të politikës. Në procesin buxhetor, kjo analizë duhet të përfshijë propozime për të ndryshuar mënyrën se janë planifikohet shpërndarja e të ardhurave dhe shpenzimeve.

26 PEFA Secretariat, 2020. Supplementary Framework for Assessing Gender Responsive Public Financial Management, Washington, D.C., https://www.pefa.org/sites/pefa/files/resources/downloads/WBG_GRPFM_FRAMEWORK_ENG_PAGES_200609.pdf.

Vlerësimi se si ndryshimet e politikës së propozuar kanë ndikime specifike tek femrat është i rëndësishëm në analizën e propozimeve buxhetore, përmirëson dizajnin e tyre, duke i dhënë përparësi përpjekjeve për promovimin e barazisë dhe zbutjen e efekteve negative mbi barazinë gjinore. Vlerësimet ex ante të ndikimit gjinor shpesh mbështeten shumë në të dhëna të ndara sipas seksit dhe në strategjitë e barazisë ose planet e veprimit të zbatuara nga qeveria. Në mënyrë tipike, ministrinë, departamentet, agjencitë dhe institucionet e pavarura kryejnë analizën e ndikimit gjinor për fushat përkatëse të politikave, edhe pse Ministria përgjegjëse për çështjet e Financave mund të kryejë më vetë ose konsolidon analizat e ndikimit gjinor në përgjithësi për të gjitha drejtimit e politikave të propozuara. Standardet e MFP sugjerojnë se ndryshimet e propozuara në politikën e të ardhurave duhet gjithashtu të përfshijë vlerësimet e ndikimit gjinor.

Për shembull, në Austri, i gjithë legjislati i ri duhet të shoqërohet nga një vlerësim ex ante/paraprak të ndikimit që përfshin jo vetëm objektivat e përgjithshme, por edhe ndikimin në barazinë gjinore, fëmijët, të rinjtë dhe grupet vulnerabel në shoqëri. Këto vlerësime publikohen së bashku me projektligjin për konsultim public dhe drafti i ndryshuar dhe vlerësimi i ndikimit ex ante diskutohen në mënyra të ndryshme në komisionet e Këshillit Kombëtar (Parlamentit). Vlerësimi i ndikimit gjinor informon diskutimet parlamentare për programe specifike të lidhura me gjininë (për shembull, ndërtimi i infrastrukturës për shkollat për të promovuar aftësinë e nënave për të vazhduar punën, krijimi i shërbimeve këshillimore për dhunën ndaj grave), por edhe për shërbimet e përgjithshme publike (ulja e tatimit mbi të ardhurat, rritja e pensioneve apo përfitime të tjera sociale). Pas tre deri në pesë vjet, një vlerësim i ndikimit ex post (për të vlerësuar ndikimin e politikës pas zbatimit) përgatitet nga ministrinë e linjës dhe i nënshtrohet shqyrtimit të Komisionit për Buxhetin, duke mundësuar të mësuarit nga përvoja e mëparshme dhe legjislati i përmirësuar.²⁷

²⁷ PEFA Secretariat, 2020.



KËSHILLË E SHPEJTË

BPGJ FILLON ME TË DHËNA TË NDARA SIPAS GJINISË DHE STATISTIKA GJINORE.

Ju nuk mund ta zgjidhni një problem që nuk e dini se ekziston. Derisa të dhënat e mbledhura nga Qeveria të reflektojnë ndikimin e politikave veçmas tek grate dhe burrat, mund të jetë e pamundur për të treguar nëse gratë janë të disavantazuara nga një program i caktuar. Përvoja nga puna e deritanishme e BGJP ka konfirmuar se një hap i rëndësishëm është sigurimi i mbledhjes dhe shpërndarja e të dhënave të ndara sipas gjinive të përdorura nga Ministrinë e linjës, shoqëria civile dhe parlamenti për të kryer analiza dhe ndjekur reforma që do reflektojnë një qasje më të përgjigjshme gjinore ndaj politikëbërjes.

Në vitin 2015, Islanda shqyrtoi një propozim legjislativ për të ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme kuadrin ligjor të tatimit mbi të ardhurat. Komisioni i buxhetit fillimisht propozoi vazhdimin e lejes për përdorimin e kreditimit tatimor të bashkëshortit me të ardhura më të ulëta, nga e cila kryesisht përfitonin burrat, pasi ata ishin partneri me të ardhura më të larta në 75 nga 100 martesat. Megjithatë, për shkak të prezantimit të BPGJ-së, Ministria e Financave dhe Ekonomisë mundi t'i tregonte Komisionit se kjo iniciative do të bënte që burrat të merrnin përfitime tatimore në bazë të punës dhe pagave të grave dhe kështu të ardhurat e tyre të disponueshme do të rriteshin, ashtu si dhe hendeku i të ardhurave gjinore, në kundërshtim me qëllimin e barazisë ekonomike midis burrave dhe grave. Falë këtij informacioni, propozimi fillestar i komisionit të buxhetit u ndryshua.²⁸

²⁸ Ronnie Downes, Lisa von Trapp, and Scherie Nicol, 2017, Gender Budgeting in OECD Countries, OECD Journal on Budgeting. 2016/3, <https://www.oecd.org/gender/Gender-Budgeting-in-OECD-countries.pdf>.

KUTIA 3**QASJA BPGJ: KAPACITETI PARLAMENTAR PËR TË KRYER ANALIZËN E BUXHETIT GJINOR**

Disa parlamente evropiane mund të karakterizohen se kanë, relativisht, burime të rëndësishme (njerëzore dhe financiare) të cilat kanë lehtësuar zhvillimin e kapaciteteve për t'u përfshirë në procesin e BPGJ-së.

Austria kaloi një reformë të rëndësishme të procesit të miratimit të buxhetit vjetor në 2012, duke përfshirë edhe rolin e Parlamentit në proces. Në vitin 2013, kjo përfshinte krijimin e një Zyre të Buxhetit pranë Parlamentit (PBO) për t'i ofruar Kuvendit kapacitetin për të analizuar buxhetin.

PBO-ja mbështet Komisionin e Buxhetit të Parlamentit për të ofruar analiza dhe të dhëna në raporte. PBO gjithashtu shqyrton procesin e BPGJ në total dhe jep komente për sistemin për llogari të Parlamentit. Analizat e buxhetit të PBO për Parlamentin ofrojnë informacion gjithëpërfshirës për BPGJ-në, duke përfshirë "cilësinë e informacionit, nivelin e ambicjes të objektivave, përshtatshmëria dhe zhvillimi i treguesve përkatës, disponueshmëria e të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe nivelet e koordinimit ndërmjet ministrive." Kjo punë ka qenë efektive në nxitjen e debatit parlamentar dhe sigurimin e integritetit të çështjeve gjinore në debatet parlamentare mbi buxhetin. Ministritë e linjës në qeveri ofrojnë përditësimet për zbatimin e buxhetit të tyre tek Komisioni i Buxhetit.²⁹

Që nga viti 2016, Parlamenti i Italisë merr një Raport të Buxhetit Gjinator të mandatuar nga legjislacioni. Kjo ka rezultuar në rritjen e kapacitetit të Parlamentit për të analizuar dhe t'u përgjigjur për çdo raport vjetor. Në 2019, Parlamenti shkoi më tej dhe tani iu ofron deputetëve me një analizë të ndikimit gjinor për çdo projektligj të paraqitur për debat. Tradicionalisht, Dhoma e Deputetëve e fokusoi rolin e saj në procesin e buxhetit në rishikimin ex post se si zbatohet Buxheti Vjetor. Megjithatë, që nga momenti kur raportet e Buxhetit Gjinator janë publikuar, Parlamenti është bërë më proaktiv.

Në vitin 2020, një mocion i kaluar nga Dhoma e Deputetëve kërkon që Departamenti i Kërkimeve pranë saj të prodhojë analiza dhe të dhëna gjinore sa here që t'i kërkohet nga Parlamenti dhe mbi bazë pilot.³⁰

Në vitin 2018, Parlamenti i Portugalisë ndryshoi rregulloren e tij të procedurës për të gjitha projektligjet, duke përfshirë edhe buxhetin vjetor të shtetit, duke parashikuar që ato të shoqërohen me një analizë të ndikimit gjinor. Në këtë rast, analiza prodhohet ose nga propozuesi i projektligjit ose kryhet me kapacitetin e brendshëm i Kuvendit nëpërmjet Zyrës së Dokumentacionit.³¹

²⁹ PEFA Secretariat, 2020.

³⁰ Italian Chamber of Deputies Research Service, 2021. Briefing on Gender Budgeting and Gender Scrutiny.

³¹ Law No. 4/2018 - Official Gazette No. 29/2018, of February 9, gender impact assessment legal framework of normative acts, Portugal.

Vlerësimet ex ante të ndikimit gjinor shërbejnë për të informuar formulimin e buxhetit dhe për të siguruar që vendimet të pasqyrohen në metodologjinë e treguesit SDG 5.c.1, si pjesë e vlerësimit të vendit nëse ata kanë një sistem gjithëpërfshirës për të gjurmuar alokimet e buxhetit gjinor.

B. QARKORET/ UDHËZIMET MBI BUXHETIMIN E PËRGJIGJSHËM GJINOR

Qarkoret buxhetore janë dokumenta të nxjerra nga Ministria e Financave ndaj njërive të buxhetit për t'i udhëzuar mbi procedurat standarte të përgatitjes së buxhetit. Gjithashtu, të njohura si udhëzimet e buxhetit, këto dokumenta u japin udhëzime Ministrive të Linjës dhe institucioneve në nivel qendro dhe lokal për të përgatitur projektbuxhetet e tyre në njësitë e qeverisjes qendrore ose vetëqeverisjes lokale. Qarkoret/Udhëzimet mbi Buxhetimin e Përgjigjshëm Gjinor përmbajnë udhëzime sipas të cilave propozimet për projektbuxhetin/ shpenzimet e reja apo edhe reduktimet e shpenzimeve të propozuara të përmbajnë justifikime për barazinë gjinore ose të analizojnë rezultatet e parashikuara mbi baza të ndara sipas gjinisë. Standardet e Menaxhimit të Financave Publike sugjerojnë përfshirjen e të dyja elementëve: përfshirja e ndikimit gjinor në rritjet apo reduktimet e të ardhurave apo shpenzimeve buxhetore të propozuara dhe përfshirja e të dhënave të ndara sipas gjinisë në produktet apo rezultatet e planifikuara.

C. KLASIFIKIMI I BUXHETIT TË PËRGJIGJSHËM GJINOR

Në thelb procesi i klasifikimit të buxhetit përdor një diagram llogarish për të identifikuar:

1. Kush i shpenzon paratë (njësia administrative)?
2. Për çfarë qëllimi shpenzohen paratë (klasifikimi funksional) dhe çfarë parash shpenzohen (klasifikimi ekonomik) që bën të mundur klasifikimin dhe gjurmimin e shpenzimeve buxhetore sipas shpenzimeve të dedikuara për rezultatet e synuara gjinore.



SDG 5.C.1 METODOLOGJIA NË FOKUS

- Pyetja 2.1. A harton Ministria e Financave/ Zyra e buxhetit qarkore/ udhëzime standarte, që parashikojnë udhëzime specifike për alokimet buxhetore të përgjigjshme gjinore?
- Pyetja 2.2. A janë politikat dhe programet kryesore, të propozuara për t'u përfshirë në buxhet, subjekt i një vlerësimi ex ante të ndikimit gjinor?

Ky proces njihet gjithashtu si "etiketim". Shpenzimet gjurmohen kundrejt alokimeve buxhetore që janë klasifikuar në mënyrë eksplicite të lidhura me rezultate të synuara gjinore. Në 117 vendet pjesëmarrëse në Anketën e Buxhetit të Hapur për 2019, 49 (ose 42%) e të anketuarve kishin sisteme klasifikimi funksionale dhe ekonomike në përputhje me standardet ndërkombëtare. Jo të gjitha vendet i përdorin këto sisteme klasifikimi për të gjurmuar barazinë gjinore, por vendosja e tyre e bën atë më të aksesueshme. Në Indonezi, i gjithë dokumentacioni i projekt-buxhetit përgatitur nga Ministrinë e Linjës duhet të shoqërohet me etiketim buxhetor. Rrjedhimisht, Ligji për Buxhetin Vjetor të Shtetit dhe Dokumenti i Zbatimit të Buxhetit, ndër të tjera, kanë përfshirë referenca për barazinë gjinore. Gjithashtu, referenca të tilla kanë edhe të gjitha dokumentet e planifikimit afatmesëm, duke përfshirë planin e zhvillimit afatmesëm dhe Plani Strategjik Pesëvjeçar për Ministrinë e Linjës (ML).³² Ndërmjet viteve 2012 dhe 2015, qeveria "blloko" lirin e alokimeve buxhetore për ML-të nëse ato nuk plotësonin kërkesat e 'etiketimit gjinor' dhe përgatitjes së një Deklarate të Buxhetimit Gjinor (Gender Budget Statement). Kjo dispozitë u hoq në vitin 2015. Si

32 PEFA Secretariat, 2020, PEFA Assessment of Gender Responsive Public Financial Management: Indonesia, <https://www.pefa.org/sites/pefa/files/2021-07/ID-Jun20-GRPFM-Public%20with%20PEFA%20Check.pdf>.

rezultat, ndarja e buxhetit për produktet e etiketuara gjinore pothuajse u përgjysmua.³³ Qëllimi i këtij shembulli nuk është të vërë në dukje trendin negativ, por të nxjerrë në pah praktikën pozitive të krijuar duke lidhur dhenat buxhetore me përfundimin e procesit të etiketimit.³⁴

2.2 Miratimi i buxhetit

A. DOKUMENTACIONI I PROJEKT- BUXHETIT TË PËRGJEGJSHËM GJINOR

Dokumentacioni i projekt - buxhetit publikohet nga qeveria dhe përfshin planet e ekzekutivit shpenzimet dhe të ardhurat gjatë gjithë vitit buxhetor.

Së bashku me dokumentacionin mbështetës, BVSH i nënshtrohet shqyrtimit legjislativ dhe miratimit parlamentar.

Të dhënat dhe analizat gjinore mund të përfshihen në të gjithë dokumentacionin e draft - buxhetit ose përmes hartimit të një Pasqyre të Buxhetit Gjinator (e cila shërben si dokument llogaridhënie).



OZHQ 5.C.1 METODOLOGJIA NË FOKUS

- Pyetja 2.5. A janë alokimet buxhetore subjekt i "etiketimit" duke përfshirë klasifikues funksionale, për të identifikuar lidhjen e tyre me objektivat e barazisë gjinore?

33 The budget allocation for gender-tagged outputs declined from IDR 230.47 billion in 2015 to IDR 120.48 billion in 2016. See PEFA Assessment of Gender Responsive Public Financial Management: Indonesia.

34 During 2012-2015, a regulation required the government to block the release of budget to spending units if they did not complete requirements of 'gender tagging' and preparing a GBS. 29 PEFA Secretariat, 2020. <https://www.pefa.org/sites/pefa/files/>

Për të siguruar që dokumentacioni i politikave buxhetore të jetë i përgjigjshëm gjinator, qeveria duhet:

- Të japë një pasqyrë të planeve për përmirësimin e barazisë gjinore gjatë vitit buxhetor përkatës;
- Të evidentojë iniciativat e të ardhurave dhe shpenzimeve që janë krijuar në mënyrë specifike për të promovuar barazinë gjinore; dhe
- Të vlerësojë ndikimet gjinore të politikave buxhetore. Elementi përfundimtar mund të përfshijë vlerësimet ex ante të ndikimit gjinator të ndërmarra nga Ministria e Financave ose Ministrinë e Linjës dhe të përshkruajë rezultatet dhe ndikimet e synuara për politikën e hartuara për barazinë gjinore ose që targetojnë një gjini të caktuar (specifike gjinore).

Standardet e Menaxhimit të Financave Publike kërkojnë që dokumentacioni i publikuar i buxhetit vjetor të përfshijë të tre dokumenta si vijon:

- Pasqyrë e prioriteteve të politikave të qeverisë për përmirësimin e barazisë gjinore;
- Detaje të masave buxhetore që synojnë forcimin e barazisë gjinore; dhe
- Vlerësimi i ndikimeve të politikave buxhetore në barazinë gjinore.³⁵

Pasqyra e Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjinator duhet të përfshijë, ndër të tjera:

- Analizën e situatës së çështjes kritike gjinore/pabarazia gjinore e cila kërkon planifikimin e shpenzimeve buxhetore. Kjo duhet të rezultojë nga një analizë e plotë gjinore dhe të mbështetet nga të dhëna të ndara sipas gjinisë;
- Vlerat Bazë - tregojnë se nga fillon agjencia në mënyrë që të mund të matet progresi;
- Objektivat - të nevojshme për të vendosur dhe ndihmuar për të matur progresin kundrejt vlerave.³⁶

35 PEFA Secretariat, 2020..

36 Uwantege, 2019. 34 Debbie Budlender, 2016, Budget Call Circulars and Gender Budget Statements in the Asia Pacific, UN Women,

KUTI 4**QARKORET E BUXHETORE TË PËRGJEGJSHME GJINORE**

Në Kirgistan, në vitin 2012, një rekomandim nga Parlamenti drejtuar Ministrisë së Financave nxiti ndarjen e burimeve nga buxhetet shtetërore dhe sektoriale për të mbështetur zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin Kombëtar të Veprimit. Ministria e Financave reagoi duke shpërndarë një qarkore të brendshme për të drejtuar kërkesat buxhetore.³⁷

Në Ruandë, Qarkoret Buxhetore u bënë një pjesë thelbësore e Ministrisë së Financave dhe procesit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në vitin buxhetor 2009/2010.

Udhëzimet e përfshira në qarkoren e parë përcaktuan pesë hapa për analizën e buxhetit të përgjigjshëm gjinor, vendosën kritere të qarta për përzgjedhjen e nën-programeve dhe inkurajuan përdorimin e të dhëna të ndara sipas gjinisë për të kryer analizën gjinore gjatë procesit buxhetor. Fillimisht, ky program u prezantua si një program pilot për katër sektorë. Në vitin buxhetor 2010/2011, udhëzimet u shtrinë në të gjitha ministrinë për të mbështetur integrimin gjinor në procesin buxhetor dhe deri më sot, këto udhëzime shpërndahen çdo vit përmes qarkores së thirrjes për të drejtuar procesin buxhetor.³⁸ Suedia filloi të zhvillojë strategjinë e integritit gjinor në procesin e buxhetit në vitin 2002.

37 UN Women, 2015. Handbook on Costing Gender Equality, <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2015/7/handbook-on-costing-gender-equality>.

38 Emma Carine Uwantege, 2019, Gender Responsive Budgeting Parliamentary Guide: Final Document, Rwanda Women Parliamentary Forum.

Që nga viti 2016, si pjesë e kësaj strategjie është hartuar qarkorja/udhëzimi buxhetore për njësitë buxhetore duke i udhëzuar ato të marrin në konsideratë barazinë gjinore duke kryer vlerësimin ex ante të ndikimit gjinor të të gjitha propozimeve të politikave buxhetore. Ky udhëzim parashikon gjithashtu kërkesën për të mbledhur të për të dhëna të ndara sipas gjinisë.³⁹

Në vitin 2004, Qeveria e Ugandës, nëpërmjet Ministrisë së Financave, Planifikimit dhe Zhvillimi Ekonomik, në përpjekje për të siguruar që sistemi i menaxhimit të financave publike të adresojë çështjet gjinore, hartoi një udhëzim të buxhetit gjinor në Qarkoren e Thirrjes Buxhetore, duke i kërkuar qeverisë përmes Ministrive të Linjës të demonstrojnë se si do t'i adresojnë çështjet gjinore përmes buxheteve të tyre.⁴⁰

Që nga viti 2004, përfshirja e BPGJ-së në qarkoren e thirrjeve buxhetore është ruajtur dhe forcuar. Që nga viti 2016, udhëzimet buxhetore janë mbështetur më tej nga një certifikatë gjinore dhënë nga Ministria e Financave në bashkëpunim me Komisionin e Shanseve të Barabarta. Kjo kërkohet lidhur me kornizat buxhetore që do të miratohen dhe buxhetet që do të alokohen.

Në Shqipëri, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka miratuar Udhëzimet standarde për përgatitjen e buxhetit në nivel qendror dhe lokal të cilat përmbajnë edhe udhëzimet mbi përfshirjen e BPGJ-së. Në nivel qendror, baza ligjore për hartimin e BPGJ është udhëzimi i

39 PEFA Secretariat, 2020.

40 Equal Opportunities Commission (EOC) of Ugandan Parliament, 2017, Gender and Equity Compliance Guide for Parliament

Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.7/2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, në të cilën përcaktohet metodologjia e buxhetimit në bazë programi dhe performance për hartimin e PBA.

Ky udhëzim ngarkon titullarët e njësive të qeverisjes qendrore me përgjegjësinë për të siguruar që dokumenti i programit buxhetor afatmesëm, krahas parimeve të tjera të sistemit buxhetor, të respektojë edhe parimin e barazisë gjinore. Për garantimin e këtij standardi, Udhëzimi ngarkon nëpunësit autorizues në rolin e koordinatorit të Grupit të Menaxhimit Strategjik që të sigurojnë që gjatë dy fazave të hartimit të kërkesave buxhetore të sigurojnë përfshirjen minimalisht të një qëllimi të politikës që adreson respektimin e plotë të barazisë gjinore ose promovon barazinë gjinore në fushën/sectorin përkatës për secilin program buxhetor në përgjegjësinë e tyre.

Shtojca nr.5 e Udhëzimit Nr.7 “nr.7/2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm” e titulluar “Udhëzime mbi përgatitjen e Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjikor” parashikon se “në përputhje me parimin e barazisë gjinore të gjitha programet buxhetore, duhet të përcaktojnë të paktën një objektiv me bazë gjinore të shoqëruar me tregues performance respektive në nivel objektiv dhe produkti.

Aty ku është e aplikueshme, programet buxhetore duhet të përcaktojnë apo reflektojnë qëllime të politikës në përputhje të plotë me qëllimet strategjike të arritjes së barazisë gjinore të përcaktuara në SKZHI, strategjitë ndërsektoriale dhe sektoriale, duke evidentuar qartë dhe treguesit përkatës të performancës.”⁴¹

Në nivel vendor, udhëzimi nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor Afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”, parashikon në pjesën e parë të udhëzimit “Të përgjithshme” se “Qëllimet e politikës të programit, objektivat e politikës së programeve, produktet e programeve dhe kostot përkatëse, shoqëruar me treguesit e performancës. Të paktën një nga objektivat e politikave sipas programeve duhet të adresojë problematika të pabarazisë gjinore ose respektimin e plotë të barazisë gjinore, duke identifikuar qartazi produktet dhe treguesit e tjerë të matshëm me bazë gjinore”⁴²

41 Shtojca Nr.5 e Udhëzimit Nr.7 “nr.7/2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm, kreu 2.5, pika 5, shkronja h.

42 Udhëzimi nr.23, datë 30.07.2018 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor Afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore

KUTI 5

PROCESI I RUANDËS PËR HARTIMIN E PASQYRËS SË BUXHETIMIT TË PËRGJIGJSHËM GJINOR⁴³

Për të mbështetur plotësimin e dokumentacionit të projekt-buxhetit të përgjigjshëm gjinor, Ministria e Financave dhe Planifikimit Ekonomik të Ruandës (MINECOFIN) ofron një proces prej 5 hapash që të gjitha ministrinë dhe qarqet të përgatisin pasqyrat e tyre buxhetore gjinore në një aneks të Qarkores së Thirrjes Buxhetore. Si pjesë e këtyre udhëzimeve, MINECOFIN ofron gjithashtu një tabelë të standardizuar (shih më poshtë) për të gjitha ministrinë dhe qarqet që duhet plotësuar si pjesë e propozimeve të tyre.

PROCESI I SHQIPËRISË PËR HARTIMIN E PASQYRËS SË BUXHETIMIT TË PËRGJIGJSHËM GJINOR

Në Shqipëri, pasqyra e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor iu bashkangjiti për herë të parë Buxhetit të vitit 2022. Kjo pasqyrë përgatitet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe përmban një përmbledhje të iniciativave dhe objektivave të përgjigjshme gjinore të cilat përfshihen në draft buxhetin që do të miratohe në të njëjtin vit në Parlament.

Pasqyra e BPGJ-së gjithashtu tregon totaline shpenzimeve të planifikuara për BPGJ dhe përqindjen që shpenzimet për BPGJ zenë ndaj totalit të shpenzimeve të planifikuara për atë vit.

Në vitin buxhetor 2022, Pasqyra e BPGJ-së tregoi se 47 programe buxhetore të 11 Ministrive të Linjës dhe dy institucioneve shtetërore ishin të përgjigjshme gjinore.

Gjithashtu për vitin 2022, shpenzimet e planifikuara për BPGJ zinin 9% të totalit të shpenzimeve buxhetore të planifikuara. Nga viti 2022, Pasqyra e BPGJ shoqëron çdo vit dokumentin e buxhetit vjetor.

Në krahasim me 2022, Pasqyra e BPGJ për 2024 tregon se 53 programe buxhetore janë të përgjigjshme gjinore dhe ka një tendencë në rritje (edhe pse e ulët) të përqindjes që BPGJ do të zerë ndaj totalit të shpenzimeve buxhetore (2024 – 9.6%).

Programi: Emërtimi i Programit dhe Ndarja Totale e Buxhetit

Nën-programi: Emërtimi i Nën- Programit

| Analiza e situatës gjinore (përcaktoni në mënyrë të qartë problemin) | Rezultati | Aktiviteti | Treguesi (i ndarë sipas seksit) | Target-i (i ndarë sipas seksit) | Buxheti i miratuar Viti Buxhetor 2020/21 |
|---|-----------|------------|----------------------------------|----------------------------------|--|
|---|-----------|------------|----------------------------------|----------------------------------|--|

Totali i Buxhetit të Përgjigjshëm Gjinor

BPGJ % vs Buxhetit Total

43 Ministry of Finance and Economic Planning of Rwanda, Annex 8: Guidelines for the Preparation of the Gender Budget Statement FY 2020/21, https://www.minecofin.gov.rw/fileadmin/user_upload/Minecofin/Publications/REPORTS/National_Budget/Budget_Call_Circular/2020-2021_Second_Budget_Call_Circular/Local_Government/Annex_8_GBS_FY_2020-21.docx

Por nëse pasqyra e BPGJ do të jetë një mjet efektiv si pjesë e një procesi më të gjerë të BPGJ-së, ajo duhet të jetë pjesë e një arkitekture më gjithëpërfshirëse për të siguruar që të mund të përdoret në kohën e duhur. Kjo mund të përfshijë ngritjen e kapaciteteve për stafin parlamentar dhe deputetët me qëllim që ata të kuptojnë se si të interpretojnë dokumenta të tilla. Ajo mund të përfshijë gjithashtu analiza të detajuara nga komisionet parlamentare që shqyrtojnë pasqyrën e BPGJ-së dhe identifikojnë çdo boshllëk ose sfidë me informacionin e dhënë në pasyrën mbi BPGJ. Analizat e fundit kanë treguar se pa një arkitekturë të tillë ndikimi i një Pasqyre të BPGJ-së do të jetë i kufizuar.⁴⁴

Në Indonezi, Qeveria miratoi një strategji kombëtare për të përshejtuar integrimin gjinator përmes Planifikimit dhe Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjinator, e cili ishte nisur që në vitin 2012. Plani kërkon që Ministrinë dhe Agjencitë e Qeverisë të prodhojnë një Pasqyrë të BPGJ, duke specifikuar aktivitetet dhe masat specifike për adresimin e boshllëqeve gjinore të përcaktuara në analizën e tyre.⁴⁵

Në Marok, BVSH i paraqitet Parlamentit së bashku me raporte të ndryshme të detyrueshme, përfshirë Raportin e Buxhetit Gjinator. Raporti synon të jetë një instrument llogaridhënie. Ai paraqet në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse çdo program dhe përpjekje financiare për të reduktuar pabarazitë gjinore nga çdo ministri/departament financiar nga buxheti i shtetit. Gjithashtu, raporti shqyrton nëse Ministrinë e Linjës kanë kryer një analizë sektoriale gjinore dhe si ato i kanë aplikuar rezultatet në procesin e planifikimit dhe buxhetimit.⁴⁶

44 <https://asiapacific.unwomen.org/en/digital-library/publications/2016/05/budget-call-circulars-and-genderbudget-statements-in-the-asia-pacific>.

45 PEFA Secretariat, 2020b.

46 Secrétariat PEFA, 2016, Rapport sur la performance de la gestion des finances publiques: Royaume du Maroc, <https://www.pefa.org/sites/pefa/files/assessments/reports/MA-Sep16-PFMPR-Public-with-PEFA-Check.pdf>.



SDG 5.C.1

METODOLOGJIA NË FOKUS

- ⦿ Pyetja 1.2. A kanë këto politika dhe/ose programe shpenzime adekuate të alokuara brenda buxhetit, të mjaftueshme për të përmbushur njëkohësisht objektivat e përgjithshme dhe qëllimet lidhur me barazinë gjinore?
- ⦿ Pyetja 2.4. A ofron qeveria, në kontekstin e buxhetit, një deklaratë të qartë mbi objektivat e lidhura me gjininë (psh pasqyra e buxhetit gjinator ose legjislati buxhetor i përgjigjshëm gjinator)?

Në Ruandë, ku UN Women ka mbështetur Ministrinë e Financave, dokumenti i draft buxhetit përfshin edhe pasqyrën e buxhetimit të përgjigjshëm gjinator të përgatitur nga çdo Ministri. Kabineti miraton një aneks të Pasqyrës së BPGJ-së të Konsoliduar në Dokumentin Kuadër të Buxhetit Vjetor dhe ia paraqet Parlamentit. Pasqyra e BPGJ-së e Ruandës përdor instrumentin standard duke zgjedhur programet ekzistuese buxhetore, nënprogramet, rezultatet, aktivitetet, treguesit, dhe ndarjet buxhetore. Kjo e bën të lehtë, si për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave që të përgatisë pasqyrat buxhetore të konsoliduara gjinore, ashtu edhe për parlamentarët dhe publikun për të lexuar dhe kuptuar pasqyrat e buxhetit gjinator në të gjitha Ministrinë e Linjës.⁴⁷

Në Spanjë, raporti i përgjithshëm i ndikimit gjinator përgatitet nga Sekretari i Shtetit për Buxhetin dhe Shpenzimet si pjesë e Librit të Bardhë të Buxhetit të Përgjithshëm të Shtetit. Raporti "paraqet analizën e ndikimit gjinator të shpenzimeve buxhetore sipas

47 Equal Opportunities Commission (EOC) of Ugandan Parliament, 2017.

programeve të parashikuara në Projektligjin për Buxhetin Vjetor të Shtetit për vitin 2021, i përgatitur duke përdorur informacionin e dhënë nga departamentet ministrore”.³⁸ Sipas legjislacionit, Raporti i Ndikimit Gjinator duhet të përbëhet nga tre kapituj kryesorë që i referohen “Realitetit”, “Përfaqësimit” dhe “Burimet-Rezultatet.”

Seksioni “Realiteti”, realizuar në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Statistikave ofron “indiktorët më të rëndësishëm për të bërë një diagnozë të realitetit gjinator në shoqërinë spanjolle.” Seksioni i dytë, mbi Përfaqësimin, analizon “situatën dhe përfaqësimin e grave dhe burrave në Administratën e Përgjithshme shtetërore.” Së fundi, Burimet - Rezultatet analizojnë “ndikimin gjinator të shpenzimeve të programuara sipas gjinisë”.⁴⁸

B. PËRDORIMI I TË DHËNAVE TË NDARA SIPAS SEKSIT NË DOKUMENTIN E BUXHETIT

Të dhënat e ndara sipas seksit janë një burim shumë i rëndësishëm informacioni lidhur me formulimin dhe vlerësimin e produkteve dhe programeve qeveritare. Këto të dhëna mund të targetojnë të gjithë popullësinë (në nivel kombëtar ose local) apo grupe të veçanta Brenda popullsisë (viktimat e dhunës, të moshuarit, persona me aftësi të kufizuara).

Buxheti me bazë performancën gjithnjë e më shumë i sheh të dhënat e ndara sipas seksit si çelës i të kuptuarit të ndikimeve gjinore të programeve dhe produkteve. Standardet e MFP rekomandojnë publikimin vjetor të të dhënave të ndara sipas seksit për shumicën e produkteve të planifikuara nga Ministrinë e Linjës si pjesë e planifikimit buxhetor të tyre.

Gjithashtu, ML rekomandohet të mbledhin dhe publikojnë të dhëna të ndara sipas seksit edhe lidhur me kategori të tjerash shërbimesh, produkteve që

ato mund të ofrojnë brenda fushës së sektorit që mbulojnë. Këto të dhëna do të shërbejnë gjithashtu si burim i rëndësishëm informacioni që mund të përdoret nda deputetët gjatë hartimit të analizave gjinore të buxhetit apo raporteve të vlerësimit të progresit të barazisë gjinore në fusha apo sektorë të caktuar.

Në kuptimin e përgjithshëm të dhëna të ndara sipas seksit janë:

- Çdo e dhënë për individët e ndarë sipas gjinisë. Statistikat gjinore mbështeten te këto të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe pasqyrojnë realitetet e jetës së grave dhe burrave dhe çështjet e politikave që lidhen me gjininë.
- Të dhënat e mbledhura dhe tabeluara veçmas për gratë dhe burrat. Ato lejojnë matjen e dallimeve midis grave dhe burrave në plane të ndryshme sociale dhe ekonomike dhe janë një nga kërkesat për përfundimin e statistikave gjinore.

Përveç të dhënave të ndara sipas seksit, me rëndësi është gjithashtu vendosja e treguesve me ndjeshmëri gjinore në dokumentin e buxhetit. Parimisht, një tregues është “një pikë referimi kundrejt së cilës mund të vlerësohen ndryshimet me kalimin e kohës”. Në këtë kuptim, nëpërmjet një “treguesi gjinator” ne përpiqemi të matim ndryshimet që lidhen me gjininë me kalimin e kohës, pra situatën e burrave dhe grave dhe hendekun që rezulton midis grave dhe burrave.

Duke matur ndryshimet gjinore në shoqëri me kalimin e kohës, ata janë të dobishëm pasi zbulojnë pabarazitë gjinore. Gjithashtu, duke identifikuar ndryshimet në statusin dhe rolet e grave dhe burrave që duam të arrijmë dhe duke ditur se si do t’i masim këto, deputetët mund të analizojnë rezultatet e programeve buxhetore dhe të vlerësojnë nëse ato kontribuojnë në progresin e barazisë gjinore apo jo.

48 Government of Spain, 2020, Gender Impact Report, <https://www.sepg.pap.hacienda.gob.es/sitios/sepg/en-GB/Presupuestos/InformesImpacto/Paginas/InformelImpactoGenero.aspx>. 39 Ibid.

Treguesit me ndjeshmëri gjinore

- ⊙ *Matin hendekun mes burrave dhe grave;*
- ⊙ *matin rolet, përgjegjësitë dhe aksesin e ndryshëm të anëtarëve të ndryshëm të shoqërisë të burimet;*
- ⊙ *Matin progresin drejt arritjes së objektivave të barazisë gjinore;*
- ⊙ *Kërkojnë që të dhënat të ndahen sipas gjinisë, moshës dhe variablave të tjerë;*
- ⊙ *Kërkojnë një analizë gjinore të të dhënave;*
- ⊙ *Nxisin integrimin e çështjeve të barazisë gjinore që nga planifikimi i një politike, programi ose projekti deri të zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi;*
- ⊙ *Demonstrojnë ndikimin e ndryshimeve midis grave dhe burrave të marrëdhëniet e pushtetit.*

Në vitin 2018, si pjesë e një projekti pilot në Irlandë, gjashtë departamente shtuan objektivat me bazë gjinore dhe treguesit e ndjeshëm gjinore si pjesë e dokumentit të buxhetit në terma të informacionit të performancës. ⁴⁹një vit më vonë, ky projekt u shtri në nëntë departamente dhe u zgjerua akoma më shumë. Pjesë e informacionit ishin edhe formulimi i qëllimeve të përgjigjshme gjinore.

Për shembull, një "qëllim i nivelit të lartë" për Departamentin e Turizmit, Kulturës, Arteve, Sportit dhe Medias në Irlandë ishte të "punojë për të arritur nivele më të larta të përfaqësimit të grave dhe vajzave në filma dhe përmabjtjen e ekranit televiziv të mbështetur nga Fís Eireann/Screen Ireland." Si objektiva specifike të lidhur me arritjen e këtij qëllimi ishin rritja e nivelit të aplikimeve të pranuar nga gra shkrimtare, producente apo regjizore si edhe rritja e nivelit të aplikimeve të sukseshme. ⁵⁰

49 Government of Ireland, 2019, Revised Estimates Volume for Public Services, <https://assets.gov.ie/5516/110119140212-1f5f87d995e643cf96a12e5e42b7f25f.pdf>.

50 PEFA Secretariat, 2020, Kingdom of Tonga: Public Expenditure and Financial Accountability Gender Responsive Budgeting Assessment Report 2019, <https://assets.gov.ie/5516/110119140212-1f5f87d995e643cf96a12e5e42b7f25f.pdf>.


**SDG 5.C.1
METODOLOGJIA NË FOKUS**

- ⊙ Pyetja 2.3. A përdoren statistikat gjinore dhe të dhënat e ndara sipas seksit në politikat dhe programet kryesore në mënyrë që mund informojnë politikat lidhur me buxhetin?

Në Tonga, të dhënat e ndara sipas gjinisë publikohen çdo vit për shumicën e shërbimeve të ofruara nga çdo ministri e vendit. Këto të dhëna publikohen në planet vjetore të Ministrive dhe mbulojnë sektorët specifike brenda fushës së përgjegjësisë të Ministrive. Përshembull, Ministria e Shëndetësisë mbledh dhe publikon të dhëna të ndara sipas seksit për programet e shëndetit dhe mëmësisë; Ministria e Policisë dhe Shërbimit të Zjarrfikjes mbledh dhe publikon të dhëna të ndara sipas seksit për programe që trajtojnë dhunën me bazë gjinore etj.⁵¹

Në Shqipëri, në udhëzimin vjetor të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm parashikohet ndër të tjera se të gjitha ministritë e linjës dhe institucionet e tjera buxhetore qendrore, duhet të kryejnë analiza me bazë gjinore të sektorit përkatës, me qëllim:

- a) përcaktimin e objektivave dhe treguesve të performancës me bazë gjinore, qëndihmojnë në kryerjen e analizave gjinore të sektorit përkatës dhe matjen e performancës së programit buxhetor;
- b) detajimin e objektivave me bazë gjinore në produkte dhe kosto, të cilat synojnë zbutjen e pabarazive gjinore apo/dhe arritjen e barazisë gjinore, aty ku është e mundur.

Në këto kushte, drejtuesit e programeve buxhetore duhet të evidentojnë, mbledhin dhe administrojnë të dhëna sipas seksit në mënyrë që të planifikohen qëllimet dhe objektivat me bazë gjinore dhe për të matur progresin në lidhje me to.

Megjithatë, Kontrolli i Lartë i Shtetit në Raportin Përfundimtar të Auditimit të Performancës “Fuqizimi Ekonomik i Gruas në vendin tonë”, në 2023, ka konstatuar se planifikimi i Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjikor në programet ekzistuese nga Ministrinë e Linjës nuk ka tregues më ndarje gjinore edhe monitorimi e gjurmueshmëria e shpenzimeve buxhetore dhe vlerësimi e matja e ndikimeve të tyre nuk janë realizuar.

Në lidhje me këtë, KLSH duke konkluduar se “Shpenzimet buxhetore në sistemet elektronike të menaxhimit dhe monitorimit të buxhetit, duke mos pasur kodifikim produkti e treguesish gjinorë nuk kanë favorizuar monitorimin e shpenzimeve buxhetore sipas treguesve gjinore, si dhe matjen e performancës së programeve buxhetore me BPGJ dhe të progresit të arritur”, ka rekomanduar që brenda vitit 2023 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të dakordësojnë plane vjetore trajnimesh, në fuqizimin e kapaciteteve planifikuese, monitoruese dhe vlerësuese të institucioneve qendrore e vendore për programet buxhetore në përgjithësi dhe buxhetimin e përgjigjshëm gjikor si edhe të përfshijnë në planet vjetore të auditimit të përputhshmërisë, monitorimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjikor në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Në vijim të këtij rekomandimi, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka miratuar Udhëzimin Plotësues Nr.22 datë 7.7.2023 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026” me qëllim udhëzimin e Njesive të Qeverisjes Qendrore lidhur me përgatitjen e dokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026. Referuar buxhetimit të përgjigjshëm gjikor, MFE ka udhëzuar NJQQ të hartojnë tregues të performancës me bazë gjinore sipas programeve buxhetore që ata administrojnë.

2.3 Zbatimi i Buxhetit

Zbatimi i Buxhetit është procesi i financave publike që fillon me miratimin zyrtar të buxhetit në Kuvend dhe përfundon me veprimtarinë përmbyllëse të vitit

fiskal/buxhetor, pasi Kuvendit i paraqitet një bilanc përfundimtar. Qëllimi i procesit të ekzekutimit është menaxhimi i burimeve për të arritur objektivat e deklaruara të qeverisë. Zbatimi/ekzekutimi i buxhetit është shumë më tepër sesa pagesa e faturave dhe regjistrimi i transaksioneve financiare.

Futja e elementeve të BPGJ-së në fazën e zbatimit të buxhetit përfshin zhvillimin e kriterëve të financimit me ndjeshmëri gjinore ose që trajtojnë pabarazitë ekzistuese gjinore nga ana e ministrive të linjës. Kjo përfshin, për shembull, pikë shtesë për gratë që aplikojnë për grante dhe subvencione. Nga ana tjetër, në fazën e kontrollit të buxhetit mund të përdoret edhe një gjurmim gjithëpërfshirës i shpenzimeve për barazinë gjinore, i referuar edhe si “etiketimi i buxhetit gjikor”, i cili përmban parakushte të sistemit për të identifikuar dhe gjurmuar shpenzimet në lidhje me gjininë.

Për sa i përket **integritit të përgjigjshmërisë gjinore në raportimin e zbatimit të buxhetit**, duhet të përshtaten sisteme informacioni për të prodhuar raporte që përfshijnë të dhëna specifike gjinore. Për të gjeneruar këto raporte, mund të nevojitet modifikimi i klasifikimit të buxhetit dhe planit kontabël, dhe të sigurohet që raportet përkatëse të prodhohen automatikisht nëpërmjet sistemit të informacionit të menaxhimit financiar (SIMF) të vendit.

2.4 Monitorimi i Buxhetit

Gjurmimi i shpenzimeve buxhetore të qeverisë në përputhje me angazhimet e bëra në projekt-buxhetin promovon llogaridhënien dhe qeverisjen e mirë. Ajo ofron garanci se fondet publike po ndahen sipas qëllimeve të politikës . Nëse qeveria në një moment mund të kërkojë të bëjë rialokim të buxhetit për zëra buxhetore të caktuar, ajo duhet të marrë autorizimin e Parlamentit. Nga perspektiva gjinore, gjurmimi i shpenzimeve buxhetore është thelbësor sepse tregon nëse burimet e alokuara për promovimin e barazisë gjinore janë përdorur në të vërtetë për atë qëllim. Përveç monitorimit të shpenzimeve të qeverisë

në mënyrë eksplicite për programe dhe shërbime specifike gjinore apo që janë me ndjeshmëri gjinore është me rëndësi edhe monitorimi dhe gjurmimi i shpenzimeve buxhetore duke për programet dhe shërbimet që mund të mos kenë një fokus të qartë gjinor, por kanë ndikime indirekte gjinore.

Standardet e MFP sugjerojnë që shpenzimet buxhetore të gjurmohen kundrejt ndarjeve buxhetore/zërave buxhetore nrenda programeve apo produkteve që janë klasifikuar nga qeveria si të lidhur me rezultatet e synuara gjinore. Siç do të diskutohet në seksionin më poshtë dhe Aneksin 4 të këtij Udhëzuesi, gjurmimi i shpenzimeve buxhetore për barazinë gjinore është një hap kyç në vlerësimin e progresit të përgjithshëm të vendit mbi përmbushjen e Objektivave të Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Qëndrueshëm OZHQ 5.

Për shembull, në Indonezi, është duke u zbatuar një sistem i ri gjurmimi për të monitoruar shpenzimet buxhetore lidhur me barazinë gjinore. Pasi shpenzimet janë etiketuar si “të lidhura me rezultatet e barazisë gjinore”, qeveria mund të gjurmojë nëse shpenzimet janë realizuar sipas qëllimit. Kjo lejon ndjekjen e politikave të lidhura me gjininë në të gjithë fazën e ekzekutimit, duke lejuar analizën e saktë të zërave të linjës buxhetore dhe ndarjet e programit.⁵²

Në Shqipëri, monitorimi i zbatimit të buxhetit rregullohet me Ligjin Organik të Buxhetit nr.9336/2008 të ndryshuar. Bazuar në këtë ligj, në periudha 4 mujore, nëpunësit autorizues hartojnë raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e politikës. Gjithashtu, Ministri i Financave i paraqet për informim Këshillit të Ministrave një përmbledhje të raporteve të monitorimit dhe të zbatimit të buxhetit, sa herë që kërkohet. Të gjitha raportet e monitorimit e të zbatimit të buxhetit publikohen nga nëpunësi autorizues në faqen zyrtare të ministrisë përkatëse, brenda një muaji pas përfundimit të periudhës së raportimit. Ndërkohë, Ministri i Financave, sa herë që kërkohet, paraqet



SDG 5.C.1 METODOLOGJIA NË FOKUS

- Pyetja 1.3. A ka procedura në vend që të sigurojnë që burime ekzekutohen sipas buxhetit?
- Pyetja 2.5. A i nënshtrohen shpenzimet buxhetore “etiketimit”, përfshirë përmes klasifikuesve funksionale, me qëllim për të identifikuar lidhjen e tyre me objektivat e barazisë gjinore?

në komisionin përkatës kuvendor raporte periodike, pasqyra financiare dhe raportin vjetor për zbatimin e buxhetit në Republikën e Shqipërisë. Me kërkesë të komisionit, ai raporton gjatë vitit edhe për çështje të tjera, që kanë lidhje me zbatimin e buxhetit dhe kontrollin e brendshëm financiar publik.⁵³ Referuar buxhetimit të përgjigjshëm gjinor, në Shqipëri, nga 2021, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka përfshirë një Aneks të veçantë për Buxhetimin e Përgjigjshëm Gjinator në Dokumentin e PBA-së, i cili do iu paraqitet kryeministrit dhe parlamentit. Veç kësaj, të gjitha ministrive të linjës iu kërkohet që të përfshijnë dy seksione për BPGJ-në dhe Proceset me Pjesëmarrje në Përmbledhjen Ekzekutive të dokumentit të PBA-së.

Së fundi, vlen të nënvizojmë se analizat gjinore të viteve të fundit kanë identifikuar se sistemet për klasifikimin e shpenzimeve të lidhura me barazinë gjinore përfaqësojnë një fushë kyçe për përmirësim në nivel ndërkombëtar. Strategjitë për përmirësimin e gjurmimit të shpenzimeve buxhetore mbi barazinë gjinore shpesh theksojnë nevojën për qartësinë e klasifikimit përgjatë ciklit buxhetor. Klasifikimi i zërave brenda planit kontabël përmirëson transparencën dhe lehtëson monitorimin e shpenzimeve sipas programeve

52 PEFA, 2020b.

53 Ligj nr. Ligji nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, I ndryshuar, Neni 65.

buxhetore. Gjithashtu ai mundëson analizën ex post të zërave buxhetore dhe programeve buxhetore, e cila është me rëndësi pasi mund të informojë vendimarrjen e ardhshme në drejtim të politikave mbi barazinë gjinore. Klasifikimi i qartë gjithashtu lejon gjurmimin për të promovuar më tej llogaridhënien vis-à-vis përpjekjeve të qeverisë për të trajtuar pabarazinë gjinore.⁵⁴

2.5 Auditimi i buxhetit për të identifikuar mësimet e nxjerra

2.5.1 Raportimi i përgjigjshëm gjinor

Raportet e qeverisë për zbatimin e buxhetit ndryshojnë shumë nga vendi në vend, por raportimi vjetor për programet apo shërbimet e ofruara për publikun e gjerë (ose për grupe specifike të synuara të qytetarëve) është një praktikë e zakonshme. Gjithnjë e më shumë, Qeveritë po përfshijnë praktika të raportimit të përgjigjshëm gjinor, për të theksuar informacionin specifik përsa i përket shpenzimeve dhe të ardhurave të lidhura me gjininë.

Standardet e MFP-së përcaktojnë katër lloje të informacionit që raportimi i përgjigjshëm gjinor mund të mbulojë:

- Një raport mbi rezultatet për barazinë gjinore,
- Të dhëna për shpenzimet gjinore,
- Vlerësimi i zbatimit të politikave buxhetore dhe ndikimet e tyre në barazinë gjinore, dhe
- Të dhëna të ndara sipas seksit për buxhetet për punësimin në nivel të qeverisë qendrore.

Në Belgjikë, për shembull, raportimi i përgjigjshëm gjinor kërkohet nga Ligji i Integritimit Gjinor, 2007, i cili siguron, ndër të tjera, përcaktimin e objektivave strategjike gjinore për çdo politikë të re që do të miratohet. Ligji gjithashtu kërkon që çdo projektligj ose politika e propozuar të kalojnë një “test gjinor” si edhe i kërkon qeverisë për të përcaktuar objektivat strategjike për barazinë gjinore në fillim të legjislaturës për çdo fushë politike që bie nën kompetencën e saj. Këto parashikime janë me rëndësi në terma të raportimit të përgjigjshëm gjinor, duke marrë në konsideratë faktin që ligji parashikon edhe monitorimin dhe vlerësimin e këtyre detyrimeve. Gjithashtu, sipas të njëjtit ligj, Ministrave u kërkohet të përcaktojnë treguesit gjinorë për matjen e arritjes së objektivave strategjike të përcaktuara dhe të përgatisin raportet vjetore për masat dhe projektet e kryera në zbatim të objektivave strategjike të parashikuara.⁵⁵

Në Itali, që nga 2016, Ministria e Ekonomisë dhe Financave përgatit çdo vit Raportin e Buxhetit Gjinor. Ky raport përfshin të dhënat si referuar shpenzimeve ashtu edhe të ardhurave dhe vlerëson ndikimin e ndryshëm të politikës buxhetore mbi gratë dhe burrat për sa i përket parave, shërbimeve, kohës dhe punës së papaguar.

Gjithashtu, në Ruandë, Ligji i Buxhetit kërkon hartimin e një raporti vjetor për zbatimin e Pasqyrës së Buxhetit Gjinor. Ky raport duhet të përmbajë të dhëna dhe analizoje qartë arritjet në lidhje me buxhetin gjinor, zbatimin e objektivave në fushën e barazisë gjinore, sfidat, mësimet e nxjerra dhe rekomandimet për proceset e ardhshme të planifikimit dhe buxhetimit.⁵⁶ Në Shqipëri, në kuadër të përgatitjes së raporteve të monitorimit, Udhëzimi nr.22 datë 30.07.2022 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore” parashikon në shtojcën 2 “Përmbajtja e raportit të monitorimit” se relacioni shpjegues për çdo format duhet të përfshijë

54 Institute for the Equality of Women and Men, 2008, Acts of the cycle of seminars a new challenge for the federal government and the administrations, <https://igvm-iefh.belgium.be/sites/default/files/downloads/actesGENDER-E.pdf>.

55 Italian Chamber of Deputies, 2021

56 Uwantege, 2019.

ecurinë e realizimit të qëllimeve, dhe objektivave të politikës që trajtojnë çështjen e barazisë gjnore nëpërmjet treguesve të performancës.

Gjithashtu, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, harton nga 2021, çdo vit, raportin e realizimit të shpenzimeve të parashikuara në Aneksin 4 "Mbi Buxhetimin e Përgjigjshëm Gjnor" që shoqëron dokumentin e buxhetit. Ky raport përmban të dhëna me rëndësi në drejtim të përbushjes së objektivave për barazinë gjnore dhe realizimit të shpenzimeve buxhetore sipas qëllimit të politikës në këtë fushë. Deputetët mund ta përdorin raportin e realizimit të BPGJ-së si dokument jo vetëm për t'u njohur me situatën dhe progresin e barazisë gjnore në vend, por gjithashtu për të rekomanduar marrjen e iniciativave të reja në terma të përmirësimit të gjendjes së barazisë gjnore.

Në nivel qendror, udhëzimi standard i hartimit të buxhetit nuk përmban udhëzime lidhur me raportimin e BPGJ-së. Për këtë arsye, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në auditimin e performancës me temë "Fuqizimi ekonomik i gruas në vendin tonë" i ka rekomanduar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë që, brenda 2023, të përfshijë në udhëzimin vjetor të buxhetit raportimin mbi Buxhetim të Përgjigjshëm Gjnor gjatë procesit të hartimit dhe miratimit të projektbuxhetit pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financën dhe Nënkomisionit për Barazinë Gjnore, për të përmirësuar performancën buxhetore të programeve buxhetore me tregues gjnor.

2.5.2 Vlerësimi i ndikimeve gjnore⁵⁷

Vlerësimet ex post të ndikimit të programeve mbi barazinë gjnore janë mjete thelbësore për promovimin e efikasitetit dhe efektivitetit. Duke vlerësuar ndikimet gjnore të shërbimeve publike dhe produkteve të realizuara, qeveritë marrin informacione të vlefshme që mund të ndihmojnë në dizajnimin e programeve dhe shërbimeve të reja ndërkohë që mbajnë në



SDG 5.C.1 METODOLOGJIA NË FOKUS

- Pyetja 2.6. A janë politikat dhe programet kryesore subjekt i vlerësimit ex-post të ndikimit gjnor?

vemendje pasojat e dëmshme dhe të padëshiruara që mund të adresohen. Në disa raste, mund të jetë e përshtatshme kryerja e vlerësimeve specifike të programeve me ndjeshmëri gjnore por, si rregull, qeveritë marrin informacion më të qëndrueshëm lidhur me ndikimin gjnor kur ky vlerësim përfshihet në procesin e rregullt të vlerësimit të zbatimit të buxhetit. Standardet e MFP-së sugjerojnë që ministritë duhet të kryejnë vlerësimin e pavarur të efikasitetit dhe efektivitetit brenda tre viteve, të cilat përfshijnë edhe vlerësimet e ndikimit gjnor. Për shembull, Në Ukrainë, pas prezantimit të buxhetimit të përgjigjshëm gjnor në 2014, mbi 200 analiza ex post të ndikimeve gjnore i kanë ofruar qeverisë dhe aktorëve në nivel kombëtar dhe lokal një mori informacionesh nga perspektiva gjnore. Shumica e rekomandimeve janë fokusuar në mbledhjen e të dhënave të ndara sipas seksit dhe përmirësimin e objektivave të programeve buxhetore si edhe parashikimit të aktiviteteve për të kontribuar më mirë në barazinë gjnore.⁵⁸

2.5.3 Auditimi i jashtëm

Funksioni i kontrollit dhe auditimit në procesin buxhetor kryhet nga institucionet e larta të auditimit, si vlerësim i pavarur. Institucionet e Larta të Auditimit (ILA), në përgjithësi ndërmarrin tre lloje të auditimeve:

- Auditimet financiare që vlerësojnë besueshmërinë dhe saktësinë të raporteve të financave të njërive publike
- Auditimet e pajtueshmërisë vlerësojnë pajtueshmërinë e një entiteti publik me autoritetin e qeverisjes së tij

- ⊙ Auditimet e performancës vlerësojnë nëse programet e qeverisë janë zbatuar duke pasur parasysh ekonominë dhe efikasitetin.

Shumica e literaturës mbi auditimin gjinor është e lidhur me auditimin e performancës. Edhe pse auditimet e performancës mund të jenë të gjera, kur lidhen me barazinë gjinore, ato mund të përmbajnë sa vijon:

1. Analizojnë shkallën e përputhshmërisë me angazhimet kombëtare dhe ndërkombëtare për barazinë gjinore,
2. Identifikojnë dhe shqyrtojnë e ndikimet specifike gjinore të programeve të qeverisë dhe
3. Japin rekomandime që mund të çojnë në "përmirësime në formulimin , zbatimin dhe rezultatet e politikës dhe programeve të qeverisë, duke kontribuar në rezultate më të mira të barazisë gjinore."⁵⁹

Ekzistojnë disa mënyra se si auditimi i performancës mund të integrojë perspektivën mbi barazinë gjinore. Këto janë paraqitur në figurën e mëposhtme dhe mund të përfshijnë:

- ⊙ Auditim pa fokus – Nuk ka plan formal për të audituar barazinë gjinore, por çështjet e barazisë gjinore linden gjatë një auditimi,
- ⊙ Fokusi jo specifik – Disa hapa në auditim prekin barazinë gjinore, duke mos pasur kritere specifike gjinore,
- ⊙ Fokusi specifik – Auditimi gjinor është pjesë e një auditimi më të gjerë performance, ose
- ⊙ Fokusi ekskluziv – Auditimi fokusohet në mënyrë specifike në çështje specifike që lidhen me barazinë gjinore.

Figura 4. Spektri i auditimeve mbi barazinë gjinore



Në Shqipëri, në 2023, Kontrolli i Lartë i Shtetit ndërmorri një auditim performance ekskluziv të lidhur me barazinë gjinore me titull "Fuqizimi Ekonomik i Gruas në vendin tonë". Subjekte të këtij auditimi kanë qenë institucionet shtetërore në nivel të qeverisjes qendrore (dhe institucionet e tyre të varësisë) që janë përgjegjëse për miratimin dhe zbatimin e politikave të përgjigjshme gjinore në fushën e punësimit, si një nga elementet e fuqizimit ekonomik, si dhe në fushën e zhvillimit bujqësor rural si thelbësor në fuqizimin ekonomik të grave dhe vajzave në Shqipëri, kryesisht Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet e varësisë: AZHBR, AREB dhe QTTB, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim dhe Drejtoritë Rajonale.

Ky auditim kishte si objekt vlerësimin e efektivitetit të veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse për konkretizimin e fuqizimit ekonomik të gruas në vendin tonë duke nisur nga ligji për barazinë gjinore, zbatimi i strategjive të barazisë gjinore si dhe buxheti i përgjigjshëm gjinor kryesisht në fushën e punësimit dhe zhvillimit bujqësor rural për periudhën 2016 – 2021.

Shembull pozitiv është edhe iniciative që Kontrolli i Lartë i Shtetit Shqipëri ka ndërmarrë në 2023 së bashku me institucionet homologe në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut dhe në bashkëpunim me UN Women Albania për të kryer auditimin e përbashkët me temë "Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës".



SDG 5.C.1 METODOLOGJIA NË FOKUS

- Pyetja 2.7. A është buxheti subjekt i auditimit të pavarur për të vlerësuar shkallën që ai promovon politika të përgjigjshme gjinore?

Shembull tjetër është edhe auditimi i performancës i kryer për vitin 2018, nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm në Tonga, ku auditimi kishte si objekt vlerësimin e gatishmërisë së Qeverisë së Tongës për të zbatuar Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara. Në këtë auditim, Zyra e Auditimit e konsideroi barazinë gjinore nën kontekstin e SDG/ OZHQ numër 5. Kjo çoi në një analizë të nivelit të lartë të barazisë gjinore dhe ndikimeve gjinore në vend të një analize të fokusuar tek shërbimet dhe programet individuale⁶⁰.

Disa shembuj të tjerë lidhur me auditimet mbi barazinë gjinore jepen në Kutinë e mëposhtme.

KUTIA 6

SHEMBUJ TË AUDITIMIT GJINOR

Auditime të ndryshme mund të kontribuojnë në promovimin e barazisë gjinore. Kjo kuti nënvizon disa shembuj të auditimeve gjinore nga një sërë vendesh dhe institucionesh.

KANADA: ZBATIMI I ANALIZËS ME BAZË GJINORE

Raporti i vitit 2016 i Auditorit të Përgjithshëm të Kanadasë shqyrtoi nëse katër departamente kishin kryer analiza adekuate me bazë gjinore plus (GBA+) për të informuar vendimmarrjen, nëse një sërë agjencish qeveritare mbështesnin zbatimin e GBA+, dhe nëse rekomandimet e mëparshme ishin zbatuar. Në këtë raport, Auditori i Përgjithshëm konstatoi se zbatimi i GBA+ ishte i paplotë dhe joadekuat, pavarësisht progresit të bërë nga qeveria drejt promovimit të GBA+. Auditori i Përgjithshëm bëri një seri rekomandimesh për të forcuar kapacitetet dhe praktikën në lidhje me integrimin e GBA+ në të gjithë qeverinë. Që nga ky raport, është zhvilluar një plan veprimi GBA+, dhe u prezantuan kërkesa të reja të detyrueshme rreth analizave të bazuara në gjini në procesin e buxhetimit.

FIXHI: KOORDINIMI I VEPRIMEVE PËR ELIMINIMIN E DHUNËS NDAJ GRAVE⁶³

Ky raport i Auditorit të Përgjithshëm 2019 rishikoi kornizën ekzistuese ligjore dhe të politikave, regjistrimet e aktiviteteve, monitorimin dhe

raportimin e angazhimeve të ndërmarra ndaj eliminimit të dhunës ndaj grave nga Ministria e Grave, Fëmijëve dhe Zbutjes së Varfërisë në koordinim me aktorët e saj. Ky auditim i performancës konstatoi se Plani i Veprimit të Grave për eliminimin e dhunës ndaj grave përgjithësisht ishte zbatuar, por kuadri legjislativ dhe institucional kërkon zhvillim të mëtejshëm për të adresuar në mënyrë adekuate nevojat e viktimave të dhunës. Rregullimet e monitorimit dhe raportimit u identifikuan më tej si fusha në përmirësim.

OLACEFS: AUDITIMI IBERO-AMERIKAN MBI OBJEKTIVIN E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

Ky auditim i koordinuar i vitit 2019 u realizua nëpërmjet një partneriteti të 16 Institucioneve të Larta të Auditimit në Amerikën Latine, Kontrollori i Bogota DC, dhe Gjykata Spanjolle e Llogarive, nën mbikëqyrjen e Zyrës Kiliane të Kontrollorit të Përgjithshëm, për të vlerësuar përgatitjen e qeveritë kombëtare të vendeve pjesëmarrëse për të zbatuar **Objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm nr 5**. Përveç ofrimit të rezultateve të një auditimi të performancës për të gjitha juridiksionet pjesëmarrëse për planifikimin, financimin, dhe ndjekja e programeve të promovimit të OZHQ 5, ky raport përfshin një anketë të perceptimit të stafit të KLSH-së lidhur me barazinë gjinore brenda institucioneve, kulturën organizative dhe zbatimin e brendshëm të barazisë gjinore.

MESAZHE KRYESORE

1. Zhvillimi i proceseve, instrumentave dhe sistemeve në përputhje me BPG mund të ndihmojë për të siguruar që promovimi i barazisë gjinore të mbetet një çështje e ndjeshme gjatë gjithë ciklit buxhetor vjetor.
2. Mbledhja, analiza dhe përdorimi i të dhënave të ndara sipas seksit është një hap i parë vendimtar në proceset e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor.
3. Ministritë e Linjës mund të kryejnë analiza të ndikimit gjinor të propozimeve të tyre, ndërkohë që Ministria e Financave mund të nxjerrë qarkore/udhëzim buxhetore të përgjigjshme gjinore për të përshkruar prioritetet për Ministritë e Linjës.
4. Kur qeveria dorëzon dokumentin e buxhetit vjetor, një pasqyrë buxhetore gjinore mund të mbështesë dokumentacionin e objektivave të politikës gjinore të qeverisë dhe veprimet buxhetore për zbatimin e tyre. Planet e Performancës të ndara sipas seksit gjithashtu kontribuojnë në BPGJ në fazën e miratimit duke vendosur kushte që mund ta mbajë qeverinë përgjegjëse për propozimet e saj.
5. Gjatë fazës së zbatimi, qeveria duhet të ndjekë shpenzimet buxhetore për programet që lidhen me promovimin e barazisë gjinore. Këto procese mund të lehtësohen nga sisteme të qarta dhe të fuqishme etiketimi dhe gjurmimi për të ndjekur alokimet dhe shpenzimet buxhetore.
6. Raportimi i përgjigjshëm gjinor nga Ministritë e Linjës në fazën ex post ndihmon në qartësimin e statusit dhe progresit të programeve që promovojnë barazinë gjinore dhe masën në të cilën buxhetet mbështetën (ose nuk arritën të mbështesin) progresin. Përveç kësaj, Standardet e Menaxhimit të Financave Publike sugjerojnë që ministritë të marrin vlerësime të pavarura në terma të efikasitetit dhe efektivitetit, të cilat përfshijnë vlerësimet e ndikimit gjinor.
7. Auditimet gjinore të ndërmarra nga Institucionet e Larta të Auditimit ofrojnë një vlerësim të jashtëm të progresit lidhur me realizimin e shpenzimeve buxhetore të përgjigjshme gjinore.

3. Roli i Parlamentit në Integrimin e BPGJ në Procesin Buxhetor


Praktikat më të mira ndërkombëtare sugjerojnë se qeveria duhet të prodhojë dokumente gjatë gjithë ciklit buxhetor dhe t'i verë ato në dispozicion të Parlamentit.

Ashtu siç e theksuam në kapitullin II, procesi buxhetor kalon në pesë faza kryesore (formulimi, miratimi, zbatimi, monitorimi dhe auditimi. Roli i Parlamentit duhet të shihet i lidhur me secilën prej këtyre fazave në shkallë të ndryshme.

Përveç raporteve të paraqitura nga institucione si Kontrolli i Lartë i Shtetit ose Zyra e Buxhetit Parlamentar, këto raporte ndihmojnë në informimin e deputetëve teksa shqyrtojnë propozimet dhe performancën e qeverisë.⁶¹

Pikërisht, kjo marrëdhënie midis Qeverisë dhe Parlamentit është e lidhur me garantimin e transparencës fiskale. Ndërsa parlamenti përmbush rolin e tij gjatë gjithë ciklit buxhetor, deputetët mund t'i shohin rolet e tyre të mbikëqyrjes buxhetore me lente gjinore në çdo fazë. Ky kapitull do të ofrojë më shumë detaje lidhur me rolin e Parlamentit në secilën prej fazave të procesit buxhetor si edhe mekanizmat dhe veprimet që mund të ndërmarrin deputetët për të garantuar integrimin e gjinisë në ciklin buxhetor.

Figura 5: Cikli buxhetor



61 Geoff Dubrow, 2020, Weathering the COVID-19 Crisis and Beyond: The Role of Parliament in Public Debt Management, Westminster Foundation for Democracy.

3.1 Parlamenti dhe BPGJ në fazën e formulimit të buxhetit

Ndërsa faza e formulimit është kuptuar si përgjegjësi parësore e pushtetit ekzekutiv në vend të pushtetit legjislativ, parlamentet mundën në këtë fazë të ndihmojnë përmes ofrimit të të dhënave të mbledhura si rezultat i raportimeve të Ministrive të Linjës, Institucioneve të Pavaruara apo studeimeve të kryera nga Institutet e Kërkimit brenda Parlemeve.

Ndërkohë, krahasuar me fazën e miratimit e cila mund të jetë më kufizuese për sa i përket kohës në dispozicion, në fazën e formulimit kjo hapësirë është më e hapur. Debatet para formulimit të buxhetit i ofrojnë parlamentit një mundësi për të debatuar mbi prioritetet buxhetore dhe për të dhënë komente mbi dokumentet e hartuara nga qeveria në fazën e formulimit.

Deputetët, për shembull, mund të evidentojnë fushat prioritare që mund të kenë qenë nën-financuar në buxhetet e kaluara.⁶² Edhe nëse parlamenti mund të mos ketë kapacitete për të kryer analiza të bazuara në prova për të mbështetur buxhetimin e përgjigjshëm gjikor, nënvizimi i sfidave dhe boshllëqeve në proces mund të nxisë qeverinë, veçanërisht Ministrinë e Financave, për të adresuar sfida të tilla.

Mbajtja e gjinisë 'në radar' në fazën e formulimit është kyçe për lehtësimin e suksesit të BPGJ-së. Është thelbësore që ashtu siç propozimet për shpenzime dhe të ardhura hartohen gjatë fazës së formulimit të buxhetit, të kuptohet edhe ndikimi i ndryshëm që propozimet e reja të ndarjes së buxhetit mund të kenë mbi burrat dhe gratë. Vlerësimi i ndikimit gjikor mund të përfshihet në vlerësimin e nevojave të hartuara nga Ministrinë e Linjës dhe Ministria e Financave. Parlamenti mund të mbështesë BPGJ në fazën e formulimit përmes disa ndërhyrjeve.



KËSHILLË E SHPEJTË

PARLAMENTI DUHET TË KONSULTOHET DHE TË RAPORTOJË PËRPARA FINALIZIMIT TË BUXHETIT, Faza e formulimit të buxhetit është një mundësi për parlamentin dhe deputetët për të identifikuar dhe promovojnë aspekte të përgjigjshme gjikore të buxhetit vjetor. Kjo do të kërkojë një qasje proaktive të deputetëve në procesin buxhetor, duke përfshirë aktivizimin e deputetëve në komisionet parlamentare që të kryejnë seanca dëgjimore publike, kërkimi i të dhënave nga OSHC-të, organizatat e grave dhe publiku mbi shqetësimet e tyre dhe çfarë është nevojshme për t'u marrë në konsideratë me qëllim që buxheti të reflektojë nevojat dhe interesat e të gjithë burrave dhe grave.

Për shembull:

- ⦿ **Komisionet parlamentare mund mbështesin integrimin gjikor gjatë gjithë procesit buxhetor.** Në maj 2018, Komisioni i Irlandës për Mbikëqyrjen Buxhetore prodhoi një raport mbi buxhetimin gjikor, duke marrë parasysh se si procesi i buxhetimit gjikor dhe barazisë gjikore mund të futen dhe integrohen në procesin e formulimit të buxhetit vjetor. Raporti theksoi disa sfida, duke përfshirë nevojën që zyrtarët e përfshirë në formulimin e buxhetit të pranojnë se buxheti nuk është një ushtrim neutral ndaj gjinisë.⁶³
- ⦿ **Dokumentacioni parësor i përdorur gjatë fazës së formulimit mund të jetë objekt rishikimi për t'u fokusuar në konsideratat e lidhura me gjininë.** Përshembull, në Ugandë, Komisioni i Financave mbështet buxhetimin gjikor në fazën e formulimit duke ofruar udhëzime të qarta për buxhetimin gjikor në nxjerrjen e Qarkoreve të planifikimit

62

63 Irish Parliamentary Budget Office, 2021.

dhe përgatitjes së buxhetit në mënyrë që buxheti vjetër të integrojë perspektivën gjinore në buxhet.

⦿ **Parlamenti mund të promovojë BPGJ gjatë mbajtjes së debateve parlamentare përpara finalizimit të buxhetit.**

Ka një tendencë në rritje që parlamentet e OECD-së të debatojnë drejtimin e gjerë të politikës fiskale dhe prioritetet buxhetore para dorëzimit të buxhetit vjetor për miratim.⁶⁴ Për shembull, në Suedi, formulimi dhe miratimi i buxhetit kalojnë në një proces legjislativ me dy hapa, ku Projektligji i Politikës Fiskale (Pranverë) (dorëzuar në prill) lejon një debat më të përgjithshëm mbi politikën fiskale dhe debati për projektligjin e buxhetit (i dorëzuar në shtator) mbulon propozime të detajuara të qeverisë për shpenzimet për vitin e ardhshëm buxhetor.⁶⁵ Kjo lejon më shumë kohë për përfshirjen e parlamentit në buxhetimin gjinor gjatë debateve para finalizimit të buxhetit.

⦿ **Parlamenti mund të mbajë konsultime publike.**

Ndërsa në përgjithësi pritet që qeveria të konsultohet me publikun dhe OSHC-të lidhur me formulimin e buxhetit, shumë pak qeveri duket se bëjnë një përpjekje të përbashkët për të angazhuar gratë rregullisht, veçanërisht gratë nga grupet minoritare ose ato që i përkasin grupeve vulnerabël. Nga 117 vende të anketuara në Anketën e Buxhetit të Hapur 2019, vetëm gjashtë vende përdorën procese pjesëmarrjeje të dizajnuara për të arritur këto grupe. Prandaj, parlamentet mund të konsiderojnë mbajtjen e konsultimeve paraprake me përfaqësues të organizatave të grave, me fokus grupet e marginalizuara të grave.

64 OECD, 2019, Parliament's Role in Budgeting, from Budgeting and Public Expenditures in OECD Countries, <https://www.oecd.org/gov/budgeting/Parliament-role-in-budgeting.pdf>

65 Ibid.

Përparësitë e konsultimeve paraprake parlamentare përfshijnë:

- ⦿ Sigurimi i një forumi publik për palët e interesuara (qytetarët, si dhe publikun, organizata private dhe jofitimprurëse) për të paraqitur dhe shpjeguar rekomandimet për prioritetet për përfshirje në buxhetin e ardhshëm,
- ⦿ Sigurimi i një raporti me shkrim të pikëpamjeve të publikut për t'u shqyrtuar nga Ministria
- ⦿ të Financave dhe Ministrisë e Linjës, dhe
- ⦿ Forcimi i funksionit përfaqësues të deputetëve duke ofruar një forum për të kërkuar dhe dëgjuar pikëpamjet e palëve të interesuara lidhur me nevojat dhe prioritetet e veçanta të tyre.

Dokumentat më me rëndësi për një debat parlamentar mbi BPGJ në fazën e formulimit janë:

1. Strategjitë dhe Planet Kombëtare të Zhvillimit.

Këto dokumente janë të dobishme për t'u marrë referencë në debatin parlamentar me qëllim që t'i mundësojnë qeverisë të ndërtojë një politikë afatgjatë planesh/prioritetesh përtej atyre të parashikuara në një vit buxhetor. Sipas UN Women, "Integrimi i angazhimeve të barazisë gjinore në planet kombëtare ndërton një mjedis politikash që mundësojnë gjithëpërfshirjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Një plan zhvillimi kombëtar i përgjigjshëm gjinor integron perspektivën gjinore në analizën e situatës, formulimin e objektivave për sektorë të caktuar si edhe në kuadrin e monitorimit dhe vlerësimit. Kjo kërkon një harmonizim të plotë të planeve të zhvillimit me strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit për barazinë gjinore si edhe kuadrin

gjithëpërfshirës të politikës kombëtare për barazinë gjinore.”⁶⁶

2. **Deklaratat para-buxhetore.** Para se të diskutohet për buxhetin vjetor të ardhshëm, legjislativi duhet të ketë një mundësi për të rishikuar prioritetet e gjeratë përfshira në buxhetin e qeverisë dhe parametrat fiskalë. Kjo shpesh parashtrahet në një deklaratë paraprake buxhetore, të cilën ekzekutivi mund t’ia paraqesë legjislativit për shqyrtim, debat, ose të dyja.
3. **Programi buxhetor afatmesëm (PBA).** Ndërsa cikli i buxhetit vjetor është një proces thelbësor për planifikimin ekonomik dhe zhvillimin afatshkurtër, OECD argumenton se “programi buxhetor afatmesëm është një mjet i rëndësishëm për tejkalimin e kufizimeve të buxhetit vjetor duke adoptuar një perspektivë afatmesme për arritjen e objektivave fiskale të qeverisë.⁶⁷ Informacioni i dhënë në deklaratën parabuxhetore shpeshherë pasqyron gjetjet e Programit buxhetor afatmesëm të qeverisë, që përcakton prioritetet afatmesme të shpenzimeve dhe kufizimet buxhetore.⁶⁸ Në Nigeri, parlamentit i kërkohet të miratojë “Programin Buxhetor Afatmesëm dhe Dokumentin e Politikave Fiskale” para se të paraqitet buxheti.⁶⁹ Në raste të tjera, si Shqipëria apo Maqedonia e Veriut⁷⁰ Programi Buxhetor Afatmesëm mund të dërgohet në Parlament vetëm për qëllime informative.

66 UN Women, Inclusive National Planning, <https://www.unwomen.org/en/what-we-do/governance-and-nationalplanning/inclusive-national-planning..>

67 OECD, Medium-term expenditure framework, <https://www.oecd-ilibrary.org/sites/5b0d4f77-en/index.html?itemId=/content/component/5b0d4f77-en>.

68 Dubrow, 2020.

69 Vanguard, 2016, Reps adopt MTEF as Buhari presents 2017 budget, <https://www.vanguardngr.com/2016/12/repsadopt-mtef-buhari-presents-2017-budget/>.

70 Dubrow, 2020.

3.2 Parlamenti dhe BPGJ gjatë fazës së miratimit të buxhetit

Qeveria e paraqet projekt-buxhetin në Parlament për shqyrtim dhe miratim gjatë asaj që njihet si faza e miratimit të buxhetit. Buxheti votohet në seancë plenare pas diskutimit në komisionin përgjegjës për çështjet e financave dhe/ose komisionet parlamentare sektoriale (d.m.th., shëndetësi, arsim, të drejtat e njeriut etj). Në rastin kur në parlament ka një Komision/ Nënkomision për barazinë gjinore, projekt buxheti duhet të shqyrtohet edhe pranë kësaj strukture.

Prezantimi i buxhetit për miratim shpesh merr një pjesë të madhe të vëmendjes së mediave dhe publikut; megjithatë, mundësitë për kontributin parlamentar në këtë fazë janë disi të kufizuara. Në gjysmën e vendeve të OECD-së votimi për buxhetin konsiderohet si një mocion besimi.

Gjithashtu , për shkak se diskutimet në fazën e miratimit ndodhin në një kornizë kohore të kufizuar, deputetët janë të kufizuar në mundësitë e tyre për të ndikuar në përmbajtjen e buxhetit.⁷¹

Megjithatë, ndërsa mund të pranohet se roli i parlamentit në këtë fazë është më i kufizuar, kjo nuk i përjashton deputetët nga:

- ⊙ Shqyrtimi i përafritit midis planeve dhe programeve të qeverisë për barazinë gjinore dhe shpenzimeve buxhetore të planifikuara;
- ⊙ Mbajtja e debateve për buxhetin për të hetuar mbi performancën e buxhetit të kaluar dhe avokuar për mbështetjen e barazisë gjinore në ndarjet e shpenzimeve buxhetore. Kjo mund të përfshijë analizën e efektivitetit të programeve dhe politikave nga perspektiva gjinore dhe përafriti dhe lidhja e tyre me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planet Kombëtare të Veprimit.

71 Dubrow, 2020a.

Veprimi i parë specifik që parlamenti mund të ndërmarrë në promovimin e BPGJ-së në fazën e miratimit përfshin rishikimin e objektivave të politikës nga perspektiva gjinore. Pasqyra Buxhetore Gjinore zakonisht përshkruhet si “një llogaridhënie specifike gjinore, dokument i prodhuar nga një agjenci qeveritare për të treguar se cilat janë programet dhe buxhetet që lidhen me barazinë gjinore.” Ajo paraqitet në Parlament, shpesh së bashku me dokumentin e projekt buxhetit. Shqyrtimi i Pasqyrës buxhetore gjinore është shpesh mënyra më e mirë për të shqyrtuar synimet e politikave të qeverisë siç

artikullohet në buxhet. Në të njëjtën kohë, komisionet mund të shqyrtojnë gjithashtu ndarjet buxhetore, veçanërisht duke u fokusuar në dimensionin gjinor të programeve dhe produkteve buxhetore. Gjithashtu, komisionet parlamentare mund të përgatisin me ekspertizën e tyre ose në partneritet me shoqërinë civile analiza dhe informacione me rëndësi lidhur me situatën e barazisë gjinore në sektorë të caktuar si edhe objektivat apo prioritetet qeveritare në këtë fushë.

KUTIA 7

QASJA E BPGJ: MBJELLJA E FARAVE TË BPGJ

Rajoni i Azisë është një nga shembujt e shumtë sesi parlamenti mund të angazhohet në analizën gjinore e buxhetit vjetor të shtetit.

Në Australi, BPGJ ka qenë pjesë e procesit buxhetor që nga viti 1985 – duke e bërë atë një nga vendet e para (nëse jo i pari) për të zbatuar parimet e BPGJ-së. Kjo arrihej kryesisht përmes publikimit të Pasqyrës vjetore të Buxhetit të Grave si aneks ose dokument paralel i buxhetit vjetor. Në vitet më pas, kjo iniciativë evoluoi në një qasje më gjithëpërfshirëse ku çdo ministri kërkohet të raportojë mbi ndikimin që iniciativat e saj kanë mbi gratë dhe vajzat .

Në Timor-Leste, puna për vendosjen e BPGJ-së në procesin buxhetor ka qenë shumëplanëshe. Përpjekjet rezultuan në miratimin e një rezolute në 2010 (nr. 12/2010) në parlament për njohjen e BPGJ si një komponent integral i procesit buxhetor. Që nga viti 2010, mbështetje gjithashtu iu ofrua disa OShC-ve për të lehtësuar angazhimin e tyre aktiv në procesin e buxhetit. Qeveria kohët e fundit ka përshtatur buxhetin vjetor me një buxhet me bazë programi dhe në 2017, siguroi që BPGJ të bëhej pjesë e Udhërrëfyesit të Buxhetimit të Programit ku u miratua edhe një Shënim i Politikës së BPGJ-së për të udhëzuar ministrinë dhe agjencitë për zbatimin e tij.⁷²

72 UN Women, 2021. Timeline of Key Gender Responsive Budgeting Milestones in Timor-Leste. https://asiapacific.unwomen.org/sites/default/files/Field%20Office%20ESEAAsia/Docs/Publications/2021/02/GRB%20book%20ENGLISH_Final.pdf.

Një shembull se si rishikimi i objektivave të politikës mund të bëhet përmes shqyrtimit të një Pasqyre Buxhetore Gjimore gjendet në Ruandë, ku ligji i buxhetit parashikon shprehimisht se Pasqyra Buxhetore Gjimore është një nga anekset e dokumentit kornizë të buxhetit që duhet të miratohet njëkohësisht nga Qeveria, si edhe nga Parlamenti. Në këtë rast, deputetet mund t'i përgjigjen Pasqyrës Buxhetore Gjimore duke kërkuar informacion dhe pyetur lidhur me rezultatet e synuara, aktivitetet, praktikat e monitorimit dhe ndikimet e parashikuara në afat të mesëm. Këto debate ndodhin gjatë rishikimit të objektivave të politikave të prezantuara nga qeveria. Pasqyra e buxhetit gjinator, ndër të tjera, mund të:

- Tregojë se si sektorë të ndryshëm kanë planifikuar ndërhyrje për të adresuar pabarazinë gjimore në vitin e ardhshëm fiskal,
- Tregojë prioritetet e barazisë gjimore sipas sektorëve,
- Tregojë objektivat strategjike të propozuara sipas sektorëve dhe rezultatet e pritshme,
- Identifikojë programet dhe burimet e propozuara për të adresuar çështjet e barazisë gjimore sipas sektorëve
- Rishikojë rezultatet e pasqyrës së buxhetit gjinator të vitit të kaluar, d.m.th., objektivat, programet e ndërmarra dhe burimet e përdorura.⁷³

Objektivat e politikës mund të rishikohen gjithashtu gjatë diskutimit të projekt buxhetit me komisionin përgjegjës për çështjet e financave, ku deputetet mund të pyesin Ministrin e Financave lidhur me propozimet në projekt buxhet.⁷⁴ Për shembull, gjatë shqyrtimit të Buxhetit 2019, Ministri i Financave për Kanadanë doli para Dhomës së Komisionit të Përhershëm të Përbashkët për Statusin e Grave. Seanca e komisionit titullohej "Efekti i Buxhetit 2018 mbi Gratë dhe Vajzat në Kanada" dhe përfshinte katër tema kryesore të reflektimit: barazia e pagave, shpërndarja e të ardhurave,

arsimi dhe trajnimi dhe leja prindërore.⁷⁵ Edhe pse komisioni nuk publikoi ndonjë raport, deputetët ishin në gjendje të ngrinin prioritetet dhe të pyesin ministrin mbi objektivat e politikës që lidhen me promovimin e barazisë gjimore gjatë fazës së miratimit të buxhetit. Më tej, në përputhje me kërkesat e Ligjit kanadez mbi buxhetimin gjinator 2018, raportet e ndikimit prodhohen rregullisht për të paraqitur ndikimin e ndryshëm të çdo mase të re buxhetore mbi secilën orej gjinine.⁷⁶ Përveç objektivave të politikave, deputetët dhe komisionet parlamentare mund të rishikojë ndarjet buxhetore specifike përmes një lente gjimore. Për shembull, në Afrikën e Jugut, Komisioni i Përhershëm për Gratë, Rininë dhe Personat me Aftësi të Kufizuara në Parlamentin e Afrikës së Jugut, si pjesë e procesit të miratimit të buxhetit, rishikoi Parashikimet e Shpenzimeve Kombëtare për vitin 2021.

Parashikimet tregonin se Departamenti do të fokushej në çështjet e mëposhtme në periudhën afatmesme:

- Trajtimi i dhunës me bazë gjimore dhe mbështetja e fuqizimit të grave,
- Promovimi i planifikimit, buxhetimit dhe monitorimit të përgjigjshëm gjinator në të gjithë qeverinë,
- Promovimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara
- Mbështetja e fuqizimit të të rinjve.⁷⁷

Krahas komenteve të përgjithshme mbi prioritetet e parashtruara, Komisioni i Përhershëm rishikoi ndarjet buxhetore specifike që adresonin dhunën me bazë gjimore dhe vrasjen e grave në vend. Raporti i tyre përfundimtar përfshinte 12 rekomandime, me kërkesa për përditësime mbi progresin e bërë në adresimin e objektivave kryesore. Në lidhje me ndarjet buxhetore specifike, Komisioni i Përhershëm:

73 UN Women, 2019, A Toolkit to Support Ethiopian Parliament to Better Implement Gender Responsive Budgeting, <https://drive.google.com/file/d/1OUcP4uuhHzg0L2p8GVHj19fZy6BMVk1D/view>.

74 Edhe në Shqipëri, ligji organik për buxhetin parashikon se "me kërkesë të komisionit parlamentar përgjegjës për financat publike, Ministri i Financave mund të japë shpjegime para tij për vlerësimet dhe parashikimet e miratuara nga Këshilli i Ministrave."

75 Parliament of Canada, 2018, FEWO Committee meeting evidence, <https://www.ourcommons.ca/DocumentViewer/en/42-1/FEWO/meeting-98/evidence>

76 <https://www.canada.ca/en/government/system/transparency/gender-diversity-impacts-programs.html>

77 Parliamentary Monitoring Group, 2021, ATC210514: Report of the Portfolio Committee on Women, Youth and Persons with Disabilities on the Annual Performance Plan (Budget Vote20) of the Department of Women, Youth and Persons with Disabilities for financial year 2021/22, dated 14 May, 2021, <https://pmg.org.za/taled-committeereport/4582/>.

- ⊙ Kërkoj sqarime nga Departamenti për të shpjeguar “si do të shpenzoheshin 5 milionë R (Rand i Afrikës së Jugut) që ishin planifikuar për të zbatuar Planin Kombëtar Strategjik mbi dhunën me bazë gjinore për të arritur objektivat e programit?
- ⊙ Pyeti se çfarë po bën Departamenti për të monitoruar zbatimin e Plani Strategjik Kombëtar (PSK) për dhunën me bazë gjinore dhe vrasjen e grave në vend,
- ⊙ Vuri në dukje se qeveria ka zotuar 12 miliardë dollarë për të zbatuar komponentët të ndryshëm të Plani Strategjik Kombëtar (PSK) për dhunën me bazë gjinore dhe vrasjen e grave në vend dhe pyetën se si ishte Departamenti po monitoronte shpenzimet në këtë drejtim dhe kuadrin kohor në të cilin fondet duhet të shpenzoheshin.⁷⁸

⊙ KUTI 8

RAST STUDIMOR: UN WOMEN MBI ROLIN E KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR ÇËSHTJET E FINANCIVE DHE BUXHETIT NË FAZËN E MIRATIMIT TË BUXHETIT

Në vitin 2019, UN Women mbështeti Parlamentin Etiopian në zhvillimin e një sërë pyetjesh që do të udhëhiqnin punën e Komisionit të Përhershëm për Çështjet e Financave dhe Buxhetit në shqyrtimin e buxhetit gjatë fazës së miratimit. Seria e pyetjeve ofron një pikë fillimi të frytshëm Për deputetët dhe komisionet parlamentare që të shqyrtojnë mënyrën më të mirë për të vlerësuar promovimin e barazisë gjinore në projekt - buxhetin e qeverisë.

- ⊙ A janë identifikuar çështjet gjinore nëpërmjet një analize të situatës të grave, burrave, djemve dhe vajzave në nivele sektoriale? (16)
 - Nëse po, cilat çështje janë marrë parasysh në buxhetin e sektorëve? A ka të dhëna të ndara sipas seksit?
- ⊙ A kryen sektori/departamenti publik analiza për të vlerësuar përgjigjshmërinë gjinore të politikave? (16)
 - Nëse jo, pse?
 - Nëse po, a janë politikat adekuate për të adresuar çështjet e identifikuara gjinore dhe për të siguruar rezultatet e dëshiruara?
 - A janë specifikuar mirë parashikimet? A i plotësojnë ato nevojat dhe prioritetet e

burrave dhe grave së bashku apo nevojat specifike të secilit?

- ⊙ Nëse ka politika të ndjeshme ndaj gjinisë, duhet të parashikohen shpenzime buxhetore adekuate për implementimin e tyre. Gjatë shqyrtimit të buxhetit, komisioni mund të kërkojë (17-18):
 - A ka përdorur mjetet e duhura analiza e buxhetit të vitit të kaluar?
 - A kanë ndikuar këto gjetje në buxhetin e vitit aktual?
 - A ndahen objektivat sipas gjinisë nëpër dokumente buxhetore?
 - A ka tregues specifikë gjinorë për të matur ndikimin e politikave mbi pabarazitë gjinore?
 - A janë ndarë burimet adekuate për zbatimin e politikave të përgjigjshme gjinore? A synojnë ato veçanërisht gratë/vajzat apo meshkuj/djem?
 - A janë lënë mënjanë burimet për mbështetjen e punësimit (d.m.th. çerdhe, leje prindërore me pagesë) për të promovuar barazinë gjinore në shërbimin publik? Nëse po, për çfarë qëllimi? Nëse jo, pse jo?
 - A ka shpenzime të planifikuara për të sjellë gratë në rolet vendimmarrëse dhe pozicione drejtuese/udhëheqëse? Nëse jo, pse? A është planifikuar kjo për të ardhmen? A është analizuar në mënyrën e duhur analiza e ndikimit socio-ekonomik të burimeve të alokuara gjinore?

Për ta përmbledhur, ndërsa bazuar në traditën e votimit të buxhetit mund të argumentohet se parlamenti është disi i kufizuar në aftësinë e tij për të vepruar në fazën e miratimit të buxhetit, ai dhe komisionet e tij mund të bëjnë ende disa përpjekje gjatë kësaj faze për të promovuar barazinë gjinore. Nëpërmjet shqyrtimit të buxhetit dhe dokumentacionit shoqëruës (si p.sh. pasqyra buxhetore gjinore), Parlamenti dhe komisionet e tij mund të shqyrtojnë objektivat e politikave të qeverisë dhe ndarjet buxhetore në lidhje me promovimin e barazisë gjinore. Seancat dëgjimore me Ministrin e Financave dhe/ose zyrtarë të tjerë të qeverisë mund të ndihmojnë të promovojnë llogaridhënien për programet e barazisë gjinore. Së fundi, duke siguruar që çështjet gjinore të jenë në fokus të debatit parlamentar, deputetët mund të ndihmojnë në parashtrimin e çështjeve me rëndësi në terma të përmirësimit të situatës të barazisë gjinore në vend.

3.3 Parlamenti dhe BPGJ në fazën e zbatimit dhe monitorimit

Llogaridhënia e ekzekutivit ndaj legjislativit vazhdon edhe pasi Parlamenti ka miratuar buxhetin. Si pjesë e fazës së ekzekutimit, praktikat ndërkombëtare sugjerojnë se pushteti ekzekutiv duhet të jetë i kufizuar për të rregulluar nivelet e financimit për zërat buxhetore dhe kërkesat për ndryshim apo fonde shtesë duhet të bëhen me autorizimin nga parlamenti.⁷⁹ Një praktikë e tillë do të garantonte mbrojtjen ndaj paprekshmërisë së fondeve të planifikuara për BPGJ duke mos lejuar që rezultatet e planifikuara për përmirësimin e çështjeve të barazisë gjinore të zhvendosen për t'i shërbyer arritjes së qëllimeve të tjera. Nëse ka shtesë në të ardhura, parlamenti mund të thirret për të dhënë të dhëna se ku ato janë alokuar dhe mund të pyesë nëse është kryer një analizë e ndikimit gjinor mbi propozimet e paraqitura. Në mënyrë të ngjashme ekzekutivi duhet të kërkojë miratimin nga legjislativi para reduktimit

të shpenzimeve nëse ka mungesë të të ardhurave. Kjo është e rëndësishme nga perspektiva e BPGJ-së, duke ofruar njëfarë transparence rreth zgjedhjeve të qeverisë për të bërë rialokimi të fondeve larg cënimit të programeve me rezultate gjinore. Gjithashtu, praktikat më të mira sugjerojnë që një komision legjislativ duhet të shqyrtojë brenda vitit zbatimin e buxhetit të miratuar gjatë periudhës përkatëse të ekzekutimit të buxhetit, duke përfshirë edhe analizën nga perspektiva gjinore. Rishikimet e buxhetit mes-vjeçar, përgatitur nga Ministria e Financave, janë një tjetër pikë hyrëse thelbësore për shqyrtimin parlamentar në fazën e ekzekutimit të buxhetit⁸⁰. Edhe në terma të raportimit, praktikat më të mira sugjerojnë që rishikimi i buxhetit në mes të vitit duhet të raportojë edhe mbi zbatimin e buxhetit në gjysmën e parë të vitit buxhetor. Dokumenti i rishikimit të buxhetit “duhet të sigurojë një përditësim gjithëpërfshirës mbi zbatimin e buxhetit”, e cila përfshin një analizë të shpenzimeve aktuale kundrejt shpenzimeve nga Buxheti i miratuar⁸¹. Nëse, për shembull, janë shpenzuar vetëm 15% të shpenzimeve nga buxheti i miratuar për rezultatet gjinore në gjysmën e vitit fiskal, një nga komisionet parlamentare mund të mbajë seancë dëgjimore dhe të kërkojë të pyesë nëse qeveria është në rrugën e duhur për të përmbushur objektivat e saj gjinore për vitin aktual. Megjithatë, pavarësisht rëndësisë së rishikimit të zbatimit të buxhetit gjatë vitit, mbi 40% e vendeve të anketuara në Anketën e Buxhetit të Hapur nuk kishin asnjë Komision Parlamentar që shqyrtonte zbatimin e buxhetit brenda vitit.⁸²

78 Ibid.

79 The Enacted Budget is the ASB, including any amendments, that has been approved by the legislature.

80 International Budget Partnership, 2016, Guide to the Open Budget Questionnaire: An Explanation of the Questions and the Response Options, <https://internationalbudget.org/wp-content/uploads/open-budget-survey-2017-guideand-questionnaire-english.pdf>.

81 Pamela Gomez, Joel Friedman and Isaac Shapiro, 2005, Opening Budgets to Public Understanding and Debate: Results from 36 Countries, OECD Journal on Budgeting Volume 5, No. 1.

82 Based on Review of Open Budget Survey indicator 114 using the OBS Data Explorer. Best practice for indicator 114 78 ACTION KIT: ENGAGING PARLIAMENTS IN GENDER RESPONSIVE BUDGETING consisted of parliamentary committee examination of in-year implementation of the enacted budget at least once during the course of the relevant budget year. The committee examination was to be accompanied by a published a report containing findings and recommendations.

Edhe në rastin e Shqipërisë, referuar ligjit organik të buxhetit, në rast të kërkesave për fonde shtesë, roli i Parlamentit është i kufizuar lidhur me miratimin ose jo të tyre. Neni 45 i ligjit parashikon vetëm se Ministri i Financave vë në dijeni, me shkrim, në mënyrë periodike, Kuvendin për kërkesat për shtesë fondesh, të miratuara nga Këshilli i Ministrave, nëpërmjet përdorimit të fondit rezervë të Buxhetit të Shtetit dhe, në bazë të kërkesës së bërë nga kryetari i komisionit parlamentar përgjegjës për financat publike, u përgjigjet pyetjeve të këtij komisioni rreth kësaj çështjeje. Në këtë kuptim, parlamenti mund të kërkojë vetëm shpjegim nga Ministri i Financave sidomos lidhur me zërat e tjerë të fondeve buxhetore të miratuara, që mund të reduktohen për të siguruar fondin e nevojshëm, si dhe pasojat që një reduktim i tillë do të kishte mbi arritjen e objektivave të tjerë, veçanërisht objektivave të parashikuara për barazinë gjinore.

3.4. Parlamenti dhe BPGJ në fazën e auditimit dhe mbikëqyrjes

Faza ex post e auditimit dhe e mbikëqyrjes përfshin aktorë të ndryshëm që shqyrtojnë performancën e qeverisë gjatë vitit buxhetor. Parlamenti shqyrton dokumentet prodhuar nga qeveria dhe subjekte të tjera (p.sh. Kontrolli i Lartë i Shtetit), me misionin kryesor "rishikimin dhe vënien në përgjegjësi të qeverisë si i ka shpenzuar dhe menaxhuar fondet publike."⁸³ Komisionet parlamentare luajnë një rol thelbësor në shqyrtimin e shpenzimeve qeveritare gjatë mbikëqyrjes ex post/ pas zbatimit të buxhetit. Kjo fazë është gjithashtu një mundësi e rëndësishme për të vlerësuar ndikimet gjinore të shpenzimeve dhe të ardhurave të ndërmarra në një vit fiskal. Ashtu si vlerësimet e ndikimi ex post të shpenzimeve, programeve dhe shërbimeve qeveritare mund të nxisin efikasitetin dhe efektivitetin, kryerja e analizave me lente gjinore në këto procese vlerësimi mund t'i japë qeverisë dhe parlamentit informacion të vlefshëm për statusin e rezultateve të synuara gjinore.

RAPORTIMI I QEVERISË

Raportet qeveritare mbi iniciativat lidhur me gjininë mund t'i ofrojnë parlamentit perspektivën e qeverisë për progresin e bërë në promovimin e barazisë gjinore në fund të vitit fiskal. Në Ruandë, raportet vjetore nga ministrinë dhe departamentet mbi zbatimin e buxhetit vjetor janë të detyrueshëm me Ligjin e Buxhetit. Këto raporte duhet artikulojnë qartë arritjet e zbatimit të buxhetit vjetor, sfidat, mësimet e nxjerra dhe rekomandime për proceset e ardhshme të planifikimit dhe buxhetimit.⁸⁴

Udhëzuesi mbi Buxhetimin e Përgjigjshëm Gjinor i përgatitur për deputetët e Ruandës nënvizon disa pyetje qendrore që mund të bëjnë deputetët kur vlerësojnë raportet e zbatimit të buxhetit vjetor nga qeveria:

- ⦿ *Çfarë arritjesh për barazinë gjinore theksohen në raport?*
- ⦿ *A përfshijnë raportet një analizë të dimensioneve të barazisë gjinore me të dhëna të ndara sipas seksit dhe statistika gjinore për të mbështetur analizën?*
- ⦿ *Cili ndikim në lidhje me barazinë gjinore është krijuar si rezultat i zbatimit të ndërhyrjeve të ndryshme (A analizon raporti ndikimin e programit/projektit/aktivitetit si për burrat ashtu edhe për gratë, djemtë dhe vajzat)?*
- ⦿ *A dokumenton raporti disa mësimet/praktika/risi premtuese që ndikuan në arritjen e objektivave të barazisë gjinore?*
- ⦿ *Cilat sfida kryesore janë dokumentuar dhe çfarë rekomandimesh/ prioritetesh janë lënë për programin pasues?*⁸⁵

KOMISIONET PARLAMENTARE DHE RAPORTET E KLSH

Raportet e KLSH-së mund të jenë një mjet jetik për komisionet parlamentare për të ushtruar rolin e tyre mbikëqyrës. Në përgjithësi ekziston një marrëdhënie e ngushtë midis Institucioneve të Larta të auditimit dhe

83 Dubrow, 2020.

84 Uwantege, 2019.

85 Ibid.

Parlamentit. Në rastin e auditimeve të performancës lidhur me gjininë, kjo do të thotë se Komisionet përgjegjëse Parlamentare mund të rishikojnë gjetjet dhe rekomandimet e auditimit dhe të mbajnë seanca dëgjimore me grupet e interesit dhe ekspertë të fushës për të diskutuar mbi hapat e ardhshëm të propozuar dhe mësimet e nxjerra. Për shembull, në Ruandë, një raport i fundit mbi integrimin gjinnor theksoi Komisionet Parlamentare dhe Institucionet e Larta të Auditimit mund të bashkëpunojnë në forma të ndryshme. Ky raport sugjeron që Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) duhet të prodhojë raporte auditimi të ndjeshme gjinore ose auditime që fokusohen në buxhetin e shpenzuar për rezultatet gjinore dhe Komisionet Parlamentare mund t'i përdorin këto raporte për të mbajtur një hetim ose seancë dëgjimore.⁸⁶ Raporti detajon më tej pyetjet udhëzuese që anëtarët e komisionit parlamentar mund të paraqesin për të kontekstualizuar dhe shqyrtuar këto raporte:

- ⦿ A tregojnë raportet buxhetin e shpenzuar për ndërhyrjet për barazi gjinore?
- ⦿ Çfarë shume dhe përqindje (%) e buxhetit total është përdorur për ndërhyrje specifike gjinore ose veprime që promovojnë barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave?
- ⦿ Në çfarë mase është përdorur buxheti për të arritur objektivat e barazisë gjinore të programit?
- ⦿ Në çfarë mase po përdoret buxheti sipas qëllimit?
- ⦿ A ka ndryshuar jetën e përfituesve të synuar zbatimi i ndërhyrjeve? (burra dhe/ose gra/ të rinj-djem dhe vajza)?
- ⦿ Cilat sfida/boshllëqe janë regjistruar? Në cilin nivel?
- ⦿ Cili institucion ka bërë progres në barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, i cili mund të shërbejë si model për të tjerët?⁸⁷

MESAZHE KRYESORE

1. Buxhetimi i përgjigjshëm gjinnor në parlament e ve theksin tek roli i deputetëve në mbikëqyrjen e

buxhetit përmes një lente gjinore në çdo fazë të ciklit buxhetor.

2. Në fazën e formulimit, deputetët mund të identifikojnë dhe promovojnë aspekte të përgjigjshme gjinore të buxhetimit dhe inkurajojnë Ministrinë e Financave të marrin në konsideratë vlerësimet e ndikimit gjinnor në vlerësimet e nevojave dhe propozimet lidhur me Programet Buxhetore Afatmesme. Komisionet parlamentare mund të ftojë ekspertë për të dhënë këshilla, të dhëna, sugjerime dhe rekomandime për propozimet që kanë të bëjnë me gjininë të shqyrtuara nga komisionet gjatë fazës së formulimit.
3. Në fazën e miratimit, deputetët mund të shqyrtojnë lidhjen ndërmjet planeve të qeverisë për rezultatet gjinore dhe shpenzimeve të planifikuara për arritjen e tyre në buxhet. Komisionet parlamentare mund të promovojnë barazinë gjinore duke mbajtur debate dhe dëgjesa lidhur me ndikimet gjinore të propozimeve buxhetore.
4. Në fazën e ekzekutimit, deputetët mund të kërkojnë informacion mbi ndikimin gjinnor kur shqyrtohen rialokimet e propozuara nga qeveria, reduktimet ose rritjet në shpenzimet e propozuara. Komisionet parlamentare mund të shqyrtojnë ndikimet gjinore të programeve si pjesë e rishikimeve të tyre në raportet gjashtë mujore dhe vjetore.
5. Në fazën e monitorimit dhe auditimit, parlamenti dhe komisionet e tij mund të analizojnë raportet e monitrimin dhe auditimit të prodhura specifikuara nga qeveria dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit. Analizat gjinore dhe auditimet gjinore mund të ofrojnë informacion të detajuar për shqyrtimin parlamentar të programeve dhe angazhimeve të qeverisë për të promovuar barazinë gjinore. Gjithashtu këto raporte mund t'i japin mundësi Parlamentit për të organizuar seanca të veçanta dëgjimore me OSHC, ekspertë, grupe interesi lidhur me progresin e barazisë gjinore dhe nivelin e zbatimit të BPGJ në vend, sfidat dhe rekomandimet për përmirësimin e situatës në periodat e ardhshme.

86 Uwantege, 2019.

87 Ibid.

4. Programet për të Mbështetur Parlamentet në Procesin e BPGJ

Kapitulli në vijim do të fokusohet në atë se çfarë mbështetje mund dhe duhet t'iu ofrohen parlamenteve për t'u mundësuar institucionalizimin e rolit të tyre në të gjitha fazat e ciklit buxhetor dhe lehtësuar veprimtarin e tyre në këtë proces.

Fokusi i këtij udhëzuesi deri më tani ka qenë i roli i parlamenteve në integrimin e perspektivës gjinore në procesin buxhetor dhe BPGJ. Seksionet në vijim do të ketë në fokus të gjithë aktorët që punojnë në mbështetje të përpjekjeve të parlamentit për t'u përfshirë në mënyrë aktive në procesin e BPGJ, duke përfshirë gjithashtu bashkëpunimin me OSHC-të, deputetët dhe institucionet e pavarura mbikëqyrëse që punojnë në fushën e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor. UN Women punon drejtpërdrejt me më shumë se 80 vende mbi BPGJ dhe në të paktën 40 vende vende, organizata po angazhon parlamentet në procesin e BPGJ. Në shumë raste, UN Women po përkrah parlamentet për të luajtur një rol kyç në BPGJ dhe yhvilluar analiza të ndikimit gjinor në të gjitha aspektet e punës së tyre. Rezultatet specifike dhe pikat hyrëse janë të ndryshme dhe varen nga nevojat dhe vullneti politik brenda çdo parlamenti.

Duke nënvizuar se Parlamentet janë pjesë e një sistemi më të gjerë politik që është unik për çdo juridiksion, duhet të kuptojmë se ndërhyrjet në nivel programesh për të mbështetur Parlamentin mbi BPGJ mund të bëhen pasi të kryhet një vlerësim dhe analizë e kontekstit të parlamentit dhe vendit të tij në sistemin politik. Gjithashtu, duhet të ketë një kuptim të qartë të procesit buxhetor dhe sistemit të menaxhimit të financave publike në fuqi. Për më tepër, autoriteti ligjor i parlamentit për t'u angazhuar në këto procese duhet të përputhen me autoritetin de facto dhe kompetencat e institucionit, komisioneve dhe deputetëve.

Mjeti kryesor që përdor UN WOMEN për mbështetjen e Parlamentit në BPGJ është përmes zhvillimit dhe implementimit të programeve/projekteve specifike me Parlamentin si përfitues. Përmbajtja e një programi të tillë, do të varet gjithashtu nga konteksti institucional dhe politik i vendit në përgjithësi dhe Parlamentit në veçanti.

Megjithatë, duke marrë në konsideratë se ndërhyrjet në vende të ndryshme mund të variojnë, ky udhëzues do të përqipet në seksionin në vijim të ofrojë disa hapa dhe rekomandime në këtë drejtim.

4.1 Strategjia e gjerë për angazhimin e Parlamentit në BPGJ-së

Puna në BPGJ mund të jetë shumë teknike dhe aftësia për të angazhuar staf dhe deputetë të veçantë që mund të kërkojnë mbështetje ose janë në pozicione për të bërë ndryshime mund të jetë tërheqëse. Gjithashtu, brenda Parlamentit mund të ketë shumë deputetë që janë aktiv në çështjet gjinore dhe promovojnë barazinë gjinore gjatë mandatit të tyre.

Megjithatë, ndërsa identifikimi dhe puna me deputetë individualë mbi BPGJ-së në parlament është e rëndësishme, është po ashtu e nevojshme të institucionalizohen proceset dhe metodat e punës për të garantuar ndjekjen e një politike efektive më afatgjatë.

Një program mbështetës në të gjithë parlamentin do të jetë i nevojshëm për disa arsye:

- Reformat e nevojshme për të përmirësuar kapacitetin e parlamentit për t'u angazhuar në mënyrë efektive në procesin e BPGJ-së do të kërkojnë përfshirjen e zyrtarëve më të lartë brenda institucionit. Kryetari i parlamentit dhe i Sekretari i Përgjithshëm i Parlamentit duhet t'i miratojnë këto reforma dhe luajnë një rol strategjik në zbatimin e tyre.
- 1. Shumë nga reformat mund të kenë ndikime përtej BPGJ-së. Për shembull, ngritja e kapaciteteve brenda parlamentit për të kryer analiza të buxhetimit gjinor ka një ndikim më të gjerë për zbatimin e përgjithshëm të buxhetit. Mbështetja e ofruar për një komision parlamentar të fokusuar në çështjet e financave ose auditimin do të rrisin kapacitetin e komisionit përtej ndërhyrjeve të tyre lidhur me BPGJ. Kjo pasi, nëse kapaciteti për të kryer analiza gjinore integrohet në punën e komisioneve parlamentare, i njëjti kapacitet mund të përdoret edhe gjatë procesit buxhetor në tërësi.
- 2. Përvoja e mëparshme në zhvillimin parlamentar ka treguar se programet/projektet e suksesshme kanë një fije të përbashkët – që lidhet me vendosjen e një marrëdhënie të besueshme me aktorët kryesorë të parlamentit – stafin dhe deputetët – që mund të përdoren për të përshpejtuar dhe institucionalizuar reformat.

Në Kolumbi, UN Women ka një projekt shumëplanësh për mbështetjen e Kongresit. Me kalimin e viteve, programi ndërtoi marrëdhënie të forta, të besueshme me gratë deputete dhe stafin që u zhvilluan përmes ndërhyrjeve në kohë, të orientuara nga kërkesa, të cilat stafi dhe deputetët i vlerësuan.

Megjithatë, vetëm në vitin 2019 u miratuan ndryshime ligjore për të promovuar BPGJ dhe qasjen e Kongresit në informacion dhe të dhëna për të miratuar dhe monitoruar buxhetin vjetor. Ndërkohë, me vendosjen



KËSHILLË E SHPEJTË

NDËRTIMI I BESIMIT ME PARLAMENTET,

Parlamentet janë institucione politike, dhe politika ka të bëjë me rrjetëzimin dhe marrëdhëniet. Në këtë kuptim, ndërmarrja e një iniciative apo ndërhyrje me Parlamentin nuk do të rezultonte e sukseshme pa ndërtimin e marrëdhënieve të besueshme afatgjata me parlamentin dhe aktorët kryesorë të tij – Kryetari, Sekretari i Përgjithshëm, Kryetarët e Komisioneve dhe Grupit të Grave Parlamentare. Ndërtimi i një marrëdhënie të tillë do kërkojnë shenja të hershme të reagimit për nevojat e institucionit dhe individët që mbajnë poste kyçe brenda tij. Duke iu përgjigjur në kohë dhe me cilësi kërkesave për informacion dhe duke ofruar analiza të bazuara në të dhëna, UN Women mund të zhvillojë marrëdhëniet me Parlamentin. Kjo është thelbësore për hapjen e rrugës së bashkëpunimit jo vetëm për ndarjen e njohurive, por gjithashtu duke e çarë këtë mundësi si një gatishmëri për të eksploruar reforma që do t'i njihnin Parlamentit një rol kyç në procesin e BPGJ-së.

e bashkëpunimit dhe fitimin e besimit, reformat që mund të kenë qenë fillimisht si problematike, u bënë të arritshme për shkak se përfituesit ishin të gatshëm të merrnin në konsideratë ide të ofruara nga partnerë të besuar. Strategjia specifike për arritjen e reformave që do të rezultojnë në një rol të fuqishëm të parlamentit në procesin e BPGJ do të varet nga konteksti politik dhe teoria e ndryshimit e zhvilluar për një parlament specifik. Por çelësi i çdo strategjie në punën me një institucion politik siç është parlament është të punuarit në nivele strategjike dhe teknike.

Një qasje e dytë e përbashkët strategjike për të punuar me parlamentin është në drejtim të zhvillimit

të kapaciteteve të stafit dhe deputetëve. Metodatat e përzgjedhura përfshirë trajnimin, mentorimin, dhe pilotimin e ndërhyrjeve ofrojnë mundësi në kohë reale për të mësuar dhe aplikuar. Kjo, nga ana tjetër, ka rezultuar të jetë më e orientuar drejt rezultateve. Në këtë drejtim është me rëndësi mbajtja e sa më shumë aktiviteteve të përbashkëta për forcimin e kapaciteteve të deputetëve dhe stafit të Parlamentit si tilla si seminare trajnimi dhe vizitat studimore.



KËSHILLË E SHPEJTË

PARLAMENTEVE IU DUHET KOHË E MJAFTUESHME PËR TË ANALIZUAR DHE PËR T'U ANGAZHUAR NË PROCESIN E BUXHETIT,

Një mësim kyç i nxjerrë nga ku parlamentet janë përpjekur të luajnë një rol më të rëndësishëm në BPGJ dhe në procesin e buxhetit është se rregullat e miratimit të buxhetit kërkojnë kohë të mjaftueshme për deputetët dhe komisionet që të të shqyrtojnë në mënyrë efektive buxhetin përpara miratimit.

Por në shumë vende ka një afat kohor të shkurtër (deri në dy javë), që parlamenti të marrë, shqyrtojë dhe miratojë buxhetin vjetor. Kjo mungesë kohe rezulton në një proces miratimi që është më formal dhe, nga ana tjetër, kufizon aftësinë e parlamentit për të bërë rregullime në buxhet përpara miratimit. Hartimi i rregullores së procedurës ose legjisllacionit buxhetor që i lejon parlamentit kohë të mjaftueshme për t'u angazhuar dhe analizuar buxhetin vjetor janë thelbësore për një rol më efektiv të parlamentit në procesin e buxhetit .

4.2 Programi për angazhimin e Parlamentit në BPGJ: Hapat kryesore

Vendimi për të hartuar dhe zbatuar një program për të mbështetur rolin e parlamentit në BPGJ bazohet në disa faktorë, përfshirë kërkesën nga qeveria, vullnetin politik të parlamentit, kuadrin ligjor mbi BPGJ dhe kapacitetet e organizatave të shoqërisë civile për të mbështetur një punë të tillë. Disa hapa që mund të merren në konsideratë, menjëherë pas marrjes së miratimit paraprak për nevojën e një bashkëpunimi me Parlamentin janë si më poshtë:

HAPI 1: ANALIZA E KONTEKSTIT

Çdo punë me një institucion politik, si parlamenti, duhet të fillojë me një analizë të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të institucionit. Shtojca 3 e këtij Udhëzuesi ofron mostra të pyetjeve që duhet të përbëjnë bazën e çdo analize të tillë dhe i referohet disa burimeve të jashtme që mund të përdoren në kryerjen e një analize të tillë. Por në këtë fazë, është thelbësore të kuptojmë se çfarë boshllëqe në informacion duhet të plotësohen. Kjo përfshin:

- a. Strukturat formale nën të cilat funksionon parlamenti
- b. Dinamika e pushtetit joformal që ndikon në funksionimin e parlamentit
- c. Analiza gjinore e parlamentit me fokus në:
 - o Kuadrin ligjor që promovon barazinë gjinore;
 - o Strukturat formale dhe joformale të pushtetit pasi ato lidhen me barazinë gjinore; dhe
 - o Boshllëqet në kapacitet dhe rregulla që po e pengojnë parlamentin të veprojnë në mënyrë të përgjigjshme gjinore
- d. Kuadri ligjor i parlamentit
- e. Burimet në dispozicion të parlamentit, grupeve parlamentare, grupeve të grave parlamentare dhe deputetëve për t'u angazhuar në buxhetim të përgjigjshëm gjinor
- f. Marrëdhëniet ndërmjet parlamentit dhe aktorëve të tjerë politikë dhe roli i tyre në punën me parlamentin për të promovuar BPGJ në mënyrë efektive, duke përfshirë:

- Shoqëria civile;
- Organet e qeverisjes qendrore;
- Gjyqësori; dhe
- Komisionet / organet e pavarura

Të pasurit e këtij informacioni përpara hartimit të një projekti ose programi do të mundësojë një kuptim të plotë dhe të qartë të dinamikës brenda parlamentit dhe jashtë tij si edhe niveli i mbështetjes që do të duhet për të promovuar një qasje të re ndaj barazisë gjinore dhe BPGJ.

HAPI 2: PËRCAKTIMI I SFIDAVE TË ZHVILLIMIT

Pasi të jetë kryer analiza e kontekstit, hapi tjetër është përcaktimi i sfidave që duhet të adresohen. Kjo do të bëjë të mundur që të monitorohet progresi për të përmbushur sfidat e paracaktuara gjatë kohëzgjatjes së një programi. Duke marrë analizën në tërësi, duhet të jetë e mundur të identifikohen rrënjët e sfidave që kanë penguar zhvillimin ekonomik dhe social në vend. Këto shkaqe më pas duhet të lidhen me rrethanat aktuale politike, si p.sh çështje të barazisë gjinore në një vend dhe konkretisht parlamenti dhe roli i tij (ose mungesa e tij) në procesin e BPGJ. 114

HAPI 3: PËRCAKTIMI I NJË TEORIE TË NDRYSHIMIT

Pasi është kryer analiza e kontekstit dhe është përcaktuar sfidën e zhvillimit, hapi tjetër është përcaktimi i Teorisë së Ndryshimit. Ekzistojnë disa modele për të prodhuar një teori të ndryshimit që demonstroi se si një program ose projekt do të ndërhyjë për të adresuar sfidën e zhvillimit dhe të krijojë ndryshime pozitive. Në një kuptim më të gjerë, Teoria e Ndryshimit (ToC) është një renditje e thjeshtë e punës së një programi. Ndërkohë, në një nivel më të thellë, Teoria e Ndryshimit duhet të lejojë shqyrtimin e kujdesshëm të supozimeve dhe rreziqet që lidhen me të gjitha programet. Ajo duhet të sfidojë supozimet e paramenduara dhe perceptimet për të siguruar që një qasje e mirë-projektuar dhe e orientuar drejt rezultateve është përfshira në punën e programit të propozuar.

HAPI 4: IDENTIFIKIMI I PIKAVE TË HYRJES

Është e rëndësishme të theksohet se bazuar në punën e mëparshme të kryerjes së analizës, përcaktimit të sfidës dhe teorisë së ndryshimit, qëllimi është siguri i pikave të sakta hyrëse për mbështetjen programore dhe reformat eventuale.

HAPI 5: TESTONI DHE PROVONI QASJE TË REJA

Puna e mëparshme me parlamentet ka treguar se mënyra më e mirë për të arritur reformat institucionale është mbështetja e stafit parlamentar dhe deputetëve që të “mësojnë duke bërë”. Në këtë kuptim, me rëndësi është të hartohen qasje të reja për të siguruar rolin efektiv të parlamentit në BPGJ të cilat mund të testohen në një shkallë të vogël. Për shembull, puna për të mbështetur një mbikëqyrje më të fortë nga komisionet mund të fillojnë me mbështetjen e një komisioni që kryen një mbikëqyrje e që përfshin analizën e ndikimit gjinor. Kjo qasje mund të zgjerohet në pyetje të tjera nga i njëjti komitet për të ndërtuar kapacitetin e tyre për të kryer një punë të tillë nëpërmjet aplikimit të tij në botën reale, mbështetur nga asistencë teknike e programit.

HAPI 6: VLERËSONI REZULTATET

Pasi ka pasur pilotim të qasjeve të reja, është jetike të vlerësohet puna. Vlerësimi në këtë fazë nuk duhet të jetë formal, por duhet të sigurojë që mësimet e nxjerra nga pilotimi janë kapur. Duke përdorur shembullin e një komiteti pilotues analiza gjinore si pjesë e një hetimi mbikëqyrës, vlerësimi i një pilotimi të tillë duhet rezultojnë në një grup të qartë parametrash sipas të cilave të gjitha komitetet mund të bëjnë të njëjtën punë.

HAPI 7: NDANI REZULTATET

Pasi të jetë kryer vlerësimi, nxjerrë rezultatet dhe përcaktuar parametrat për punën e ardhshme, hapi tjetër është që të ndahen rezultatet me leadershipin politik dhe palët e interesuara. Pasi aktorët politikë të shohin se pilotimi i qasjes së re ka rezultuar në vlerë të shtuar dhe, ndoshta, përfitim politik, do të kenë më shumë gjasa të mbështesin përsëritjen e punës pilot në të gjithë parlamentin. Përsëri duke përdorur shembullin e komisionit, duke ndarë rezultatet se si ka përdorur një komision pilot analizën e ndikimit gjinor, për të zhvilluar rekomandime, politika ose ndryshime legjislative më të mira, është kritike për të siguruar pranimin e reformës nga ana e tyre në një shkallë më të gjerë.

HAPI 8: INSTITUCIONALIZIMI I REFORMËS

Qëllimi është të mbështetet institucionalizimi i reformave që adresojnë sfidat origjinale në mënyrë të qëndrueshme. Kjo mund të kërkojë ndryshime në

kuadrin ligjor ose rregullat sipas të cilave funksionon parlamenti. Mund të jetë çështje ndryshimi i financimit ose shpërndarjen e burimeve. Mund të nënkuptojë një ndryshim të sjelljes midis deputetëve dhe stafit. Por çelësi është të punohet me zyrtarët e lartë të parlamentit për të mbështetur tranzicionin e kërkuar që do të rezultojë në ndryshim të përhershëm. Përsëri duke përdorur shembullin e thjeshtë të Komisionit

Pilot: pasi të ketë një konsensus se ka pasur një vlerë të shtuar nga analiza e ndikimit gjinor në punën mbikëqyrëse të komisionit, kjo mund të rezultojë me ndryshim në rregulloren e parlamentit ose një ndryshim në procedurat standarde të funksionimit për Komitetet për të lejuar që një analizë e ndikimit të tillë të zbatohet në mënyrë rutine nga të gjitha komisionet.

KUTIA 9

PUNA ME AKTORË TË NDRYSHËM NË BPGJ

Një komponent dallues i mënyrës se si BPGJ zbatohet në Amerikën Latine është roli i aktorëve të jashtëm – OSHC-të kombëtare, OJQ-të dhe organizatat shumëpalëshe – të cilët mbështesin qeveritë dhe parlamentet ndërsa zbatojnë BPGJ. UN Women ka punuar me Kongresin e Kolumbisë për disa vite. Duke ndërtuar një marrëdhënie të besueshme përmes ofrimit në kohë të analizave politike dhe teknike, agjencia e OKB-së ka ndihmuar me sukses të advokojë për ndryshime në sistemi buxhetor kombëtar. Në vitin 2019 sistemi u rishikua për të kërkuar etiketimin gjinor në të gjithë produktet buxhetore që lidhen me barazinë gjinore. UN Women mbështeti ndërtimin e kapaciteteve brenda qeverisë për të mbledhur dhe shpërndarë të dhëna të ndara sipas seksit. Në vitin 2020 sistemi u rishikua më tej për të kërkuar raportimin gjinor, duke përfshirë një aneks të buxhetit vjetor dhe si pjesë e raportit vjetor të qeverisë për Kongresin. UN Women ka punuar me Ministrinë e Financave dhe Planifikimit të mbështesin zbatimin e këtij raportimi. Gjatë procesit të miratimit të buxhetit, Grupi i Grave të Kongresit merr një analizë të detajuar të buxhetit nga UN Women. Instituti Kombëtar i Grave të Kosta Rikës luajti një rol integral në krijimin dhe zbatimin e BPGJ në atë vend. Instituti ka punuar që nga viti 2005 me Ministrinë e Financave dhe Planifikimit dhe Zyra Kombëtare e Auditimit në hartimin dhe zbatimin e BPGJ-së. Që nga themelimi i tij, Instituti ka trajnuar më shumë se 300 nëpunës civilë në një qasje gjithëpërfshirëse

për të inkorporuar buxhetimin gjinor në punën dhe planifikimin e tyre. Instituti ka prodhuar gjithashtu instrumente dhe udhëzime për ministrinë dhe agjencitë qeveritare për të mbështetur përdorimin e BPGJ.⁸⁸ Në Meksikë, një OSHC e njohur si Fundar punon me qeverinë për të mbështetur shpërndarjen e BPGJ. Gjatë dhjetë viteve të fundit, qeveria e ka futur BPGJ në kornizën buxhetore, në pjesë jo e vogël për shkak të përpjekjeve të shoqërisë civile për të promovuar këtë qëllim. Që kur është themeluar Fundar ka bërë analiza të detajuara buxhetore dhe ka punuar me ministri, si p.sh shëndetësi, për të zhvilluar mjete për të mbështetur analizën e buxhetit gjinor në sektorë të veçantë.⁸⁹ Organizata Movimiento Manuela Ramos ka punuar në Peru në mbështetje të BPGJ-së. Kjo ka përfshirë një rol monitorues në të cilin OSHC-ja ka zhvilluar tregues për të gjurmuar rezultatet që lidhen me barazinë gjinore siç parashikohet në buxhetin vjetor. OSHC gjithashtu ka mbështetur Kongresin e Perusë në monitorimin e zbatimit të ligjit mbi të Zbatimit të Barabartë.⁹⁰

88 Evidence and Lessons from Latin America (Ella), 2015. Advancing Gender Equality Through the Budget: Latin American Experiences with Gender-Responsive Budgeting. https://www.fundar.org.mx/mexico/pdf/Brief-Advancing_gGenderEqualityLAExperienceswithGender-ResponsiveBudgeting.pdf

89 Evidence and Lessons from Latin America (Ella), 2015. Advancing Gender Equality Through the Budget: Latin American Experiences with Gender-Responsive Budgeting. https://www.fundar.org.mx/mexico/pdf/Brief-Advancing_gGenderEqualityLAExperienceswithGender-ResponsiveBudgeting.pdf

90 Ibid.

4.3 Partneritetet

Programimi në mbështetje të një parlamenti nuk zbatohet në mënyrë të izoluar. Janë të shumta institucionet dhe aktorët e tjerë të jashtëm që ndërveprojnë me parlamentin – formalisht dhe joformalisht – dhe që mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në suksesin e programit. Në rastin e BPGJ-së, këto palë të tjera të interesuara mund të jenë gjithashtu partnerët që mund të mbështesin zbatimin e programit. Më poshtë është një listë e mundshme e palëve të interesuara që mund të jenë partnerë efektivë në përmirësimin e punës së BPGJ më parlamentin:

SHOQËRIA CIVILE/ORGANIZATAT E GRAVE

Marrëdhënia mes parlamenteve dhe shoqërisë civile është komplekse, por një program mbi BPGJ mund të ndërtojë lidhje ndërmjet OSHC-ve/organizatave të grave dhe komisioneve : për shembull, një njësi kërkimore parlamentare mund të bashkëpunojë me OSHC-të për të lejuar mbledhjen dhe shpërndarjen e të dhënave nga OSHC-të në lidhje me fushën e tyre të fokusit. OSHC-të që kryejnë analiza buxhetore mund të jenë burime të shkëlqyera informacioni dhe të dhënash për deputetët dhe komisionet për t'i përdorur si analiza të pavarura të veçanta nga ato të kryera nga qeveria.

GRUPET E GRAVE DEPUTETE

Një partner kyç brenda parlamentit mund të jenë grupet ndërpartiake të grave deputete (shpesh referuar si grup i grave deputete). Këto grupe janë një pikënisje e mirë për advokim dhe analiza gjinore. Angazhimi i një grupi të tillë në parlament mund të lejojë akses në grupet parlamentare dhe hedh bazat për krijimin e një lidhshirësi me të gjerë politik brenda institucionit.

Për shembull, UN Women ka punuar me Aleancën e Grave Deputete për të promovuar BPGJ në Shqipëri. Edhe pse ende në fazat fillestare të angazhimit parlamentar, Aleanca ka punuar jashtë linjave partiake dhe ka mundur që çështje që lidhen me barazinë gjinore, duke përfshirë BPGJ-në, të kapërcejnë një sistem parlamentar shumëpartiak.

KOMISIONET E PAVARURA MBIKËQYRËSE

Siç u diskutua më herët në këtë Udhëzues, ekzistojnë institucione të pavarura që kanë një rol kyç për të luajtur në menaxhimin e financave publike, monitorimin dhe auditimin e Buxhetit vjetor. Më i dukshëm është Auditori i Përgjithshëm ose një Institucioni Tjetër i Lartë Auditimi (psh Kontrolli i Lartë i Shtetit) . Roli i tyre në komponentin e auditimit të ciklit buxhetor i bën ato një pikë hyrëse kryesore për zhvillimin e kapaciteteve për t'i mundur ata të kryejnë auditimet gjinore ose të aplikojnë analizën e ndikimit gjinor në punën e tyre.

MINISTRIA E FINANCAVE

Ministria e Financave ka një rol të rëndësishëm për të luajtur në zbatimin e BPGJ si pjesë e procesit buxhetor. Është zakonisht kjo ministri që udhëheq procesin e formulimit të buxhetit të shtetit dhe raporton për zbatimin e tij. Duke pasur parasysh rolin qendror që luan ministria, mund të jetë e vlefshme përfshirja e Ministrisë në çdo program në BPGJ dhe parlamentet me qëllim për të mbështetur rol më efektiv të parlamentit në procesin e BPGJ-së.

AKADEMIKË DHE EKSPERTË TË JASHTËM

Qasja në ekspertizë të pavarur mund të jetë kritike që parlamenti të jetë në gjendje ta përmbushë mandatin e tij në procesin buxhetor. Nëse parlamentit i mungon kapaciteti i brendshëm për të analizuar buxhetin me perspektivë gjinore, mund të jetë me vlerë partneriteti me ekspertë me përvojë në analizën gjinore, ekonomi dhe/ose kontabilitet, ndër të tjera. Kjo mund të përfshijë akademikë që kanë kryer kërkime relevante për temën ose ata që ushtrojnë një profesion në fushën e BPGJ.

PARTNERËT E ZHVILLIMIT DHE ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE

Në shumë vende, mund të ketë më shumë se një partner zhvillimi që punon me parlamentin. Mund të ketë edhe projekte të tjera me parlamentin që përfshijnë një ose më shumë rezultate që lidhen me barazinë gjinore brenda institucionit dhe/ apo rolin e tij në sistemin e menaxhimit të financave publike apo mbikëqyrjen e qeverisë më gjerësisht. Ka një vlerë të shtuar për

të siguruar që çdo program me parlamentin të jetë i mirëkoordinuar me zbatuesit e tjerë që punojnë me institucionin. Kjo nënkupton se aty ku ka kapacitet teknik një zbatues tjetër, ekspertiza e tij mund të jetë e vleshme për t'u përdorur për çdo punë në mbështetje të parlamentit.

4.4 Pikat e hyrjes për angazhim

Pas përfundimit të analizës së kontekstit, identifikimit të sfidave të zhvillimit dhe teorisë së ndryshimit, programi i punës me parlamentin kërkon identifikimin e pikave të hyrjes të nevojshme për zbatimin e programit. Përcaktimi i pikave të varen nga disa variabla. Më domethënësja nga këto do të jetë gjendja e BPGJ në procesin buxhetor dhe sistemet MFP. Në varësi të


gjendjes së BPGJ, parlamenti do të duhet të marrë përsipër role të ndryshme.

Kshtu, ekzistojnë katër faza të përgjithshme për institucionalizimin e BPGJ-së, dhe për secilin fazë, parlamenti do t'i kërkohej të ndërmerri veprime të ndryshme:

1. BPGJ nuk është prezantuar ende;
2. Miratimi fillestar i BPGJ-së;
3. Aplikimi në rritje i BPGJ-së dhe
4. BPGJ i institucionalizuar plotësisht.

Aty ku BPGJ nuk ka qënë i miratuar/institucionalizuar përmes kuadrit ligjor, roli kryesor i parlamentit ka qënë të avokojë për miratimin e BPGJ si pjesë e procesit buxhetor.

Figura 6: Pikat hyrëse për mbështetjen e Parlamentin



A. BPGJ NUK ËSHTË PREZANTUAR FARE NË PROCESIN BUXHEOR

Partneritetet mund të jenë shumë të vlefshme në këtë fazë. Aty ku ka pasur mospërputhje në lidhje me miratimin e një sistemi BPGJ, parlamenti duhet të punojë për të bërë presion për ndryshimet ligjore dhe politike të nevojshme për të zbatuar një sistem të tillë.

Disa shembuj të formave të advokacisë përfshijnë:

- ⊙ Reformimi i kuadrit ligjor: me qëllim ndryshimin e ligjeve aktuale të buxhetit përmes amendamenteve të propozuara në parlament që të institucionalizohet përfshirja e BPGJ-së në procesin buxheor;
- ⊙ Programimi pilot BPGJ: Promovimi i aplikimi të parimeve dhe mjeteve të BPGJ-së në një ministri të linjës dhe/ose brenda vetë parlament si mjet testimi
- ⊙ Përdorimi i autoritetit parlamentar: Parlamenti dhe komisionet e tij kanë autoritet të konsiderueshëm për të kërkuar prova dhe dokumentacion nga ekzekutivi. Duke i kërkuar ministrave dhe/ose zyrtarëve të qeverisë për të dëshmuar dhe raportuar për analizat gjinore, parlamenti mund të fillojë të futë një qasje e BPGJ-së ndaj punës së ekzekutivit;
- ⊙ Analizë e pavarur: Puna me shoqërinë civile dhe/ose akademikët dhe parlamentin për të prodhuar raporte me analiza që pasqyrojnë aplikimin e BPGJ-së në procesin standard të buxhetit.

Përveç advokimit, parlamentet mund të nxisin transparencën në punën e tyre duke i hapur rrugë i një procesi buxhetor më të hapur dhe gjithëpërfshirës. Për shembull, komisionet parlamentare mund të zhvillojnë seanca dëgjimore publike për buxhetin vjetor, qoftë përpara saj miratimit ose gjatë monitorimit të zbatimit të tij.

Edhe kur BPGJ nuk është përfshirë ligjërisht në procesin buxhetor, komisionet mund të përdorin lente gjinore për të shqyrtuar buxhetin. . Bërja e këtij procesi të hapur dhe transparent do të sigurojë që kjo analiza alternative të bëhet publike dhe të mund të bëhet pjesë e një debat politik dhe publik.

B. MIRATIMI FILLESTAR I BPGJ-SË

Aty ku ekzekutivi ka filluar të prezantojë dhe/ose miratojë BPGJ por ende nuk ka arritur në pikën ku BPGJ zbatohet në mënyrë rutinë për të gjithë buxhetin vjetor, parlamenti mund të dëshirojë të advokojë për të siguruar që praktika të zbatohet plotësisht dhe të promovohet transparencë më e madhe në procesin buxhetor. Të pasurit e politikave, praktikave standarde dhe ligjeve që kërkojnë raportim dhe mbledhjen e të dhënave dhe etiketimin në lidhje me gjininë mund të mos të jetë e mjaftueshme. Pa një burim të jashtëm, si parlamenti, që kërkon pajtueshmëri me rregulla të tilla, mund të jetë sfiduese ngritja e BPGJ-së në një sistem për të kuptuar se si prodhohen dhe zbatohen buxhetet.

Kur një kërkesë për BPGJ futet/përfshihet në ligjet e buxhetit, deputetët mund të ushtrojnë rolin e tyre të rëndësishëm në shqyrtimin dhe miratimin e draftit të propozuar. Ata gjithashtu mund ta përdorin këtë bazë ligjore për të mbrojtur dhe analizuar zbatimin aktual të BPGJ-së nga departamentet dhe ministratë sektoriale. Parlamenti mund dhe duhet të thithë informacionin dhe të dhënat që po merr nga përdorimi fillestar i BPGJ-së.

Në këtë fazë, angazhimi i parlamentit duhet të lejojë identifikimin e mësimeve të nxjerra nga aplikimi i mjeteve të BPGJ-së në dhe përcaktojnë nëse ka mundësi për përmirësim në proces. Për shembull, a kanë raportet nga ministratë e linjës informacionin e saktë që deputetët dhe komisionet kërkojnë? A pasqyron analiza e kryer nga ekzekutivi provat e mbledhura? Nëse jo, si mund të përmirësohet sistemi?

C. RRITJA E APLIKIMIT TË BPGJ-SË

Aty ku BPGJ po zbatohet në disa sektorë/Ministri, por ende jo në të gjithë qeverinë, parlamenti mund të fillojë të marrë një rol më aktiv dhe të përhershëm. Kjo do të kërkojë monitorim rutinë nga parlamenti – monitorimi i sistemit për të siguruar që ai mbetet efektiv dhe monitorim të buxhetit vjetor për të siguruar që ai reflekton një ekuilibër të drejtë ndërmjet nevojave dhe interesave të burrave dhe grave.

Një monitorim i tillë mund të përfshijë:

- ⊙ Shqyrtim i thelluar i projekt buxhetit përpara miratimit përmes mbajtjes së debateve dhe seanceve dëgjimore të komisionit;
- ⊙ Kërkesa të rregullta mbikëqyrëse nga komisionet për të siguruar që objektivat gjinore janë duke u arritur;
- ⊙ Kërkimi i të dhënave nga shoqëria civile dhe publiku për vëzhgimet e tyre mbi zbatimin e BPGJ-së;
- ⊙ Dëshmi të rregullta (p.sh., tremujore) nga ministra ose zyrtarë të lartë të qeverisë që të raportojnë për zbatimin e buxhetit, duke përfshirë iniciativat gjinore.
- ⊙ Përveç monitorimit të sistemit të BPGJ-së dhe buxhetit të përgjithshëm të bazuar në parimet e BPGJ , parlamenti duhet të ndërtojë kapacitetet për të kryer një analizë të pavarur të buxhetit bazuar në parimet e BPGJ-së. Një analizë e tillë do të lejojë parlamentin të vlerësojë se si buxheti dhe shifrat e tij do të krijojnë rezultate aktuale.

Ekzistojnë dy mënyra alternative për zhvillimin e kapacitetit analitik të BPGJ-së:

- ⊙ Roli i parlamentit: Ai mund të krijojë një kapacitet të brendshëm për të kryer analiza atlherë kur parlamenti ka burimet – njerëzore dhe financiare. Në Austri, kjo nënkuptonte krijimin e një Zvre Buxhetore brenda Parlamentit që ka mandatin për të kryer analiza gjinore buxhetore. Në Itali, Divizioni i Kërkimeve i Parlamentit është përgjegjës për analizat e ndikimit gjinor. Duke ndërtuar kapacitetet e tij, parlamenti do të ketë një aftësi më e madhe për të drejtuar analizën dhe për ta përshtatur atë me nevojat e komisioneve dhe deputetëve.
- ⊙ Roli i organizatave të shoqërisë civile: Aty ku janë perspektivat se ndërtimi i kapaciteteve të brendshme të parlamentit për të kryer analiza gjinore të buxhetit është më afatgjatë, duhet t'i kushtohet vëmendje partneritetit me shoqërinë civile për të kryer analiza të tilla. Në Peru, Movimiento Manuela Ramos ofron një analizë të tillë ndaj deputetëve. Edhe aty ku një parlament mund të ketë njëfarë kapaciteti, bashkëpunimi me shoqërinë civile mund të jetë një vlerë e shtuar për analizën e buxhetit vjetor me lente gjinore.

D. BPGJ ËSHTË PLOTËSISHT I INSTITUCIONALIZUAR

Aty ku BPGJ është miratuar dhe institucionalizuar plotësisht brenda procesit buxhetor dhe sistemit të Menaxhimit të Financave Publike, parlamenti duhet të kryejë mbikëqyrje për të siguruar se sistemi funksionon siç duhet. Në këtë fazë, puna e komisioneve parlamentare në lidhje me monitorimin e buxhetit duhet të përfshijë aspektin e monitorimit gjinor. Gjithashtu, në këtë fazë parlamenti duhet të përdorë analizën e BPGJ-së dhe rezultatet e nxjerra prej saj për të promovuar barazinë gjinore. Me ekzekutivin tani tërësisht në bord, parlamenti duhet të marrë përsipër rolet e tij tradicionale të ligjvënës, mbikëqyrjes dhe përfaqësimit për të përdorur BPGJ për të bërë ndryshime në buxhetin vjetor dhe miratuar politika më të gjera të qeverisë që pasqyrojnë barazinë gjinore. Parlamenti, komisionet parlamentare dhe deputetët duhet t'i kërkojnë publikut të dhëna se si buxheti po ndikon në jetën e qytetarëve (përfaqësimit), duke propozuar ndryshime në rregullat për të promovuar politika më të drejta të qeverisë (ligjvënës) dhe monitorim të rregullave të tilla dhe fondeve të alokuara për t'u siguruar që po përmbush sfidën që ishte projektuar.

MESAZHET KRYESORE

1. Puna me parlamentin kërkon një nivel të caktuar mendjemprehtësie politike dhe të menduarit strategjik për t'u përshtatur ndryshimit të lidershit politik dhe rrethanave.
2. Ndërtimi i një rrjeti partnerësh për të mbështetur parlamentin dhe programimin do të mundësojë një qasje më kosto-efektive dhe do të mundësojë perspektivat të ndryshme që duhen marrë parasysh.
3. Programet për parlamentet duhet të fokusohet në analiza solide politike dhe ndërtimin e kapaciteteve përmes pilotimit, mentorimit dhe trajnimit të deputetëve dhe stafit si një mjet për të "mësuar duke bërë".
4. Programet me parlamentin për rolin e tyre në BPGJ do të varen nga gjendja e zbatimit të BPGJ-së nga ekzekutivi. Aty ku ka më pak pranim ose miratimi i parimeve të BPGJ-së nga qeveria, do t'i duhet parlamentit të luajë një rol më domethënës si advokues dhe monitorues i sistemit.

5. Konkluzione

Buxhetimi i përgjigjshëm gjinator përfshin analizimin e buxheteve dhe politikave qeveritare lidhur me ndikimin në pabarazitë ndërmjet grupeve të ndryshme të grave dhe burrave, me qëllim të promovimit të atyre buxheteve dhe politikave që do të çojnë në barazi më të madhe. Nga formulimi dhe miratimi i buxhetit tek zbatimi, monitorimi dhe auditimi, deputetët luajnë një rol vendimtar në mbështetjen një procesi të hapur dhe transparent të ndarjes së përgjigjshme të burimeve publike nëpërmjet buxhetit vjetor.

Ndërsa natyra dhe shtrirja e rolit të legjislativit në procesin e buxhetit ndryshon nga vendi në vend, deputetët mund të ndikojnë - si individualisht ashtu edhe në komisione - të gjitha fazat e ciklit buxhetor. Gjatë formulimit të buxhetit, deputetët mund të kryejnë analiza të ndikimit gjinator të projekt-buxhetit, organizojnë debate para-buxhetore për dimensionet gjinore të projekt buxhetit, bëjnë kërkesa për të dhëna të ndara sipas seksit dhe krahasojnë propozimet me performancën e kaluar ose ndikimin e parashikuar në grupe të ndryshme. Në fazën e miratimit, deputetët mund të shqyrtojnë performancën e buxhetit të kaluar dhe të identifikojnë përafrimin ndërmjet angazhimeve aktuale të barazisë gjinore dhe shpenzimeve të planifikuara në buxhetit. Gjatë zbatimit, deputetët mund të punojnë nëpërmjet komisioneve dhe të bashkëpunojë me palët e jashtme të interesuara për të analizuar dhe raportuar mbi ndikimet gjinore të shpenzimeve publike të përshkruara në rishikimet e buxhetit në mes të vitit dhe ofrojnë rekomandime se ku duhet të rialokohen fondet për të mbështetur më mirë rezultatet e barazisë gjinore. Në fazën e monitorimit dhe auditimit parlamenti dhe komisionet e tij mund të shqyrtojnë analizat gjinore dhe auditimet gjinore të prodhuara nga Qeveria dhe/ose Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Pa mbështetje të fortë së brendshmi , korniza të forta institucionale për të ndërtuar kapacitetet dhe bashkëpunim me aktorët shtetërorë dhe të shoqërisë civile , deputetët do të përballen me pengesa në rritje për integrimin e objektivat të barazisë gjinore në procesin buxhetor. Prandaj, është e rëndësishme që të ndërmerren hapa për të institucionalizuar sistemet dhe mbështetjen për BPGJ në të gjithë qeverinë, në mënyrë që buxhetimi i bazuar në barazi dhe i përgjigjshëm gjinator të bëhet një praktikë e mirë-mbështetur dhe e qëndrueshme.

Udhëzimet dhe teknikat për aplikimin parlamentar të BPGJ-së dhe shembujt e paraqitur në këtë Udhëzues praktik do t'u mundësojnë parlamentarëve të luajnë rolin e tyre kritik në avokimin, shqyrtimin dhe monitorimin e buxheteve të përgjigjshme gjinore.

Nëpërmjet partneriteteve efektive me aktorë qeveritarë dhe joqeveritar, veçanërisht shoqërinë civile, deputetët janë aktprë kyç për ngritjen e flamurit të BPGJ-së dhe duke siguruar që analiza gjinore të jetë pjesë e vlerësimit dhe vlerësimit legjislativ dhe vlerësimit të formulimit, ekzekutimit dhe mbikëqyrjes së buxhetit.

Aneks

Aneks 1: Pyetjet kryesore për të përcaktuar ndërhyrjet me parlamentin

Pyetjet e mëposhtme do të jenë një pikënisje e rëndësishme për t'u kuptuar rolin e Parlamentit në Buxhetimin e Përgjigjshëm Gjikor dhe statusin e BPGJ në vend.

1. Menaxhimi i financave publike dhe procesi i buxhetit vjetor të shtetit

a. Çfarë lloji i formatit të buxhetit përdoret?

- i. Linja buxhetore
- ii. Politika/Programi
- iii. Performanca

b. Cilat janë hapat në procesin e buxhetit?

- i. Përpara se të futet për miratim në parlament
- ii. Gjatë procesit të miratimit në parlament
- iii. Pas miratimit të buxhetit

c. A mbliidhen përgjithësisht të dhënat në mënyrë të ndarë sipas gjinisë? Nëse po, a ka aftësi për të të mbledhë gjithashtu të dhëna bazuar në karakteristika të tjera ndërsektoriale?

d. Cilat mjete përdoren nga ekzekutivi për të raportuar mbi zbatimin e buxhetit të tij? (p.sh.– qarkoret buxhetore; ligjet e buxhetit; raportet tremujore dhe vjetore)

e. Cilat lloje të konsultimeve para-buxhetore kryhen me palët e interesuara nga qeveria?

2. Buxhetimi i përgjigjshëm gjikor

a. A njihet BPGJ i detyrueshëm në ligjin organik të buxhetit të shtetit dhe kuadrin ligjor dhe nënligjor mbi buxhetin?

- i. Nëse po, në cilat ligje dhe cilat janë kërkesat specifike?

ii. Nëse jo, a ka udhëzime ose politika që promovojnë BPGJ si një alternativë ndaj legjislacionit?

b. Çfarë mbështetje apo asistencë teknike i ofrohet ekzekutivit (MFE; ministritë e linjës) për të zbatuar BPGJ?

c. A kryen qeveria ndonjë formë konsultimi në lidhje me ndikimin gjikor para formulimit të buxhetit?

d. A përfshin buxheti vjetor i shtetit etiketimin gjikor për të identifikuar ato programe që janë të fokusuara mbi barazinë gjinore?

e. A përfshin buxheti vjetor i shtetit një komponent të buxhetit gjikor apo një shtesë që shpjegon ndikimin gjikor të buxhetit?

f. A është rishikuar ekzekutivi përmes procesit të rishikimit të Menaxhimit të Financave Publike të përgjigjshme gjinore të PEFA-s?

g. A përdor Kontrolli i Lartë i shtetit instrumenta të auditimit gjikor si pjesë e punës së tij rutinë?

i. Nëse jo, a zbaton analizën e ndikimit gjikor në punën e tij të përditshme?

3. Parlamenti dhe BPGJ

a. A kryen parlamenti ose komisionet e tij konsultime para-buxhetore që përfshijnë perspektivën gjinore?

b. Çfarë ndodh me raportimin e buxhetit dhe raportimin mbi BPGJ-në (qarkulloret buxhetore; raportet vjetore; raportin gjikor në buxhetin vjetor) pasi të paraqitet në parlament?

- i. A shqyrtohen raportet nga një ose më shumë komisione?

- ii. A janë kryer konsultime publike dhe hetime mbikëqyrëse në lidhje me raportet?
 - iii. A i përdor parlamenti ose komisionet e tij raportet për të advokuar ndryshimet në procesin e BPGJ?
- c. Sa kohë ka parlamenti nga faza e debatimit të projekt buxhetit dhe afatit të miratimit?
- d. Çfarë autoriteti ka parlamenti për të ndryshuar buxhetin?
- i. De jure
 - ii. De fakto
- e. A ka parlamenti kapacitet të brendshëm për të analizuar në mënyrë efektive dokumentet buxhetore dhe për të raportuar përmes një:
- i. Zyra e Buxhetit Parlamentar (PBO);
 - ii. Departamenti/ Instituti të Kërkimeve; ose
 - iii. Stafi i komisionit?
- f. A është parlamenti partner me shoqërinë civile për të mbështetur punën e parlamentit në ciklin buxhetor?
- i. Nëse po, cila është natyra e mbështetjes së ofruar nga shoqëria civile?
- g. Cilat komisione monitorojnë në mënyrë aktive zbatimin e buxhetit pas miratimit të tij nga parlamenti?
- i. Si e kryejnë monitorimin? (p.sh. – seancat dëgjimore; kryerja e hetimeve; seancë dëgjimore me ministrin e Financave dhe Ekonomisë ose zyrtarëve të lartë të qeverisë për të dëshmuar dhe raportuar)
 - ii. Çfarë kapaciteti ka brenda parlamentit për të kryer monitorim efektiv?
 - iii. Çfarë aksesit ka një komision në ekspertizën e jashtme për ta mbështetur atë në monitorimin e buxhetit?
 1. Nga KLSH?
 2. Nga shoqëria civile?
 3. Nga partnerët e zhvillimit?
- h. Cila është marrëdhënia mes KLSH-së dhe Parlamentit?
- #### 4. Programimi BPGJ
- a. Si do të kryhet analiza e kontekstit? (Shih Aneksin 2 për pyetjet kryesore të sugjeruara)
- b. Bazuar në konkluzionet e analizës së kontekstit, cila është sfida e zhvillimit që po adresohet me mbështetjen e parlamentit në kuadër të rolit të tij në BPGJ?
- c. Si programi i propozuar për BPGJ me parlamentin do të adresojë sfidën e zhvillimit? (d.m.th. - Cila është Teoria e Ndryshimit?)
- d. Çfarë mjetesh/instrumentash të orientuara drejt rezultateve do të përdoren për të ndërtuar kapacitetet brenda parlamentit për të përmbushur rolin e tyre si pjesë e një procesi BPGJ?
- e. Në çfarë faze është institucionalizuar BPGJ brenda sistemit të menaxhimit të financave publike në vend?
- i. A kërkohet advokimi për miratimin e BPGJ-së (ose komponentëve të saj)?
 - ii. Si mund ta marrë parlamenti rolin e tij efektiv brenda procesit të BPGJ?
 - iii. Çfarë kapaciteti për analizën e buxhetit dhe BPGJ kërkohet brenda parlamentit?
 - iv. Çfarë ndryshimesh kërkohen në kuadrin ligjor për Buxhetin dhe për parlamentin që ky i fundit të zbatojë në mënyrë efektive BPGJ gjatë procesit buxhetor?
 - v. Cilat partneritete/bashkëpunime do t'i japin vlerë të shtuar punës së parlamentit në lidhje me BPGJ?

Aneks 2: Përmbledhje e këshillave të shpejta të ofruara në udhëzues

Merrni kohë për të kuptuar procesin e buxhetit

Çdo vend ose juridiksion ka një proces unik buxhetor. Pjesa më e madhe e procesit mund të gjendet në rregulla dhe ligje të shkruara, të tilla si Ligji për Buxhetin ose rregullorja e Kuvendit, por shumë nga praktikatat standarde mund të mos jenë të aksesueshme publikisht ose mund të jenë norma të pashkruara që janë zhvilluar me kalimin e kohës. Merrni kohë për t'u siguruar se ka një nivel të kuptuarit se si procesi i buxheti funksionon dhe cilat pika hyrëse, formale dhe joformale, ekzistojnë për të ndikuar në proces.

BPGJ fillon me të dhëna të ndara sipas seksit dhe statistika gjinore

Ju nuk mund ta zgjidhni një problem që nuk e dini se ekziston. Derisa të dhënat e mbledhura nga Qeveria të reflektojnë ndikimin e politikave veçmas tek grate dhe burrat, mund të jetë e pamundur për të treguar nëse gratë janë të disavantazhuara nga një program i caktuar. Përvoja nga puna e deritanishme e BPGJ ka konfirmuar se një hap i rëndësishëm është sigurimi i mbledhjes dhe shpërndarja e të dhënave të ndara sipas seksit të përdorura nga Ministrinë e linjës, shoqëria civile dhe parlamenti për të kryer analiza dhe ndjekur reforma që do reflektojnë një qasje më të përgjigjshme gjinore ndaj politikëbërjes.

Parlamenti duhet të konsultohet dhe të raportojë përpara finalizimit të buxhetit

Faza e formulimit të buxhetit është një mundësi për parlamentin dhe deputetët për të identifikuar dhe promovojnë aspekte të përgjigjshme gjinore të buxhetit vjetor. Kjo do të kërkojë një qasje proaktive të deputetëve në procesin buxhetor, duke përfshirë aktivizimin e deputetëve në komisionet parlamentare që të kryejnë seanca dëgjimore publike, kërkimi i të dhënave nga OSHC-të, organizatat e grave dhe publiku mbi shqetësimet e tyre dhe çfarë është nevojshme për t'u marrë në konsideratë me qëllim që buxheti të reflektojë nevojat dhe interesat e të gjithë burrave dhe grave.

Ndërtimi i besimit me parlamentet

Parlamentet janë institucione politike, dhe politika ka të bëjë me rrjetëzimin dhe marrëdhëniet. Në këtë kuptim, ndërmarrja e një iniciative apo ndërhyrje me Parlamentin nuk do të rezultonte e sukseshme pa ndërtimin e marrëdhënieve të besueshme afatgjata me parlamentin dhe aktorët kryesorë të tij – Kryetari, Sekretari i Përgjithshëm, Kryetarët e Komisioneve dhe Grupit të Grave Parlamentare. Ndërtimi i një marrëdhënie të tillë do kërkojë shenja të hershme të reagimit për nevojat e institucionit dhe individët që mbajnë poste kyçe brenda tij. Duke iu përgjigjur në kohë dhe me cilësi kërkesave për informacion dhe duke ofruar analiza të bazuara në të dhëna, UN Women mund të zhvillojë marrëdhëniet me Parlamentin. Kjo është thelbësore për hapjen e rrugës së bashkëpunimit jo vetëm për ndarjen e njohurive, por gjithashtu duke e çarë këtë mundësi si një gatishmëri për të eksploruar reforma që do t'i njihnin Parlamentit një rol kyç në procesin e BPGJ-së.

Parlamenteve iu duhet kohë e mjaftueshme për të analizuar dhe për t'u angazhuar në procesin e buxhetit

Një mesim kyç i nxjerrë nga ku parlamentet janë përpjekur të luajnë një rol më të rëndësishëm në BPGJ dhe në procesin e buxhetit është se rregullat e miratimit të buxhetit kërkojnë kohë të mjaftueshme për deputetët dhe komisionet që të të shqyrtojnë në mënyrë efektive buxhetin përpara miratimit. Por në shumë vende ka një afat kohor të shkurtër (deri në dy javë), që parlamenti të marrë, shqyrtojë dhe miratojë buxhetin vjetor. Kjo mungesë kohe rezulton në një proces miratimi që është më formal dhe, nga ana tjetër, kufizon aftësinë e parlamentit për të bërë rregullime në buxhet përpara miratimit. Hartimi i rregullores së procedurës ose legjisllacionit buxhetor që i lejon parlamentit kohë të mjaftueshme për t'u angazhuar dhe analizuar buxhetin vjetor janë thelbësore për një rol më efektiv të parlamentit në procesin e buxhetit .

Të gjitha fazat e procesit buxhetor (formulimi, miratimi, zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi) paraqesin mundësi për angazhim parlamentar

Gjatë formulimit të buxhetit, deputetët mund të kryejnë analiza të ndikimit gjinor të projekt-buxhetit, organizojnë debate para-buxhetore për dimensionet gjinore të projekt buxhetit, bëjnë kërkesa për të dhëna të ndara sipas seksit dhe krahasojnë propozimet me performancën e kaluar ose ndikimin e parashikuar në grupe të ndryshme. Në fazën e miratimit, deputetët mund të shqyrtojnë performancën e buxhetit të kaluar dhe të identifikojnë përafrimin ndërmjet angazhimeve aktuale të barazisë gjinore dhe shpenzimeve të planifikuara në buxhetit. Gjatë zbatimit, deputetët mund të punojnë nëpërmjet komisioneve dhe të bashkëpunojë me palët e jashtme të interesuara për të analizuar dhe raportuar mbi ndikimet gjinore të shpenzimeve publike të përshkruara në rishikimet e buxhetit në mes të vitit dhe ofrojnë rekomandime se ku duhet të rialokohen fondet për të mbështetur më mirë rezultatet e barazisë gjinore. Në fazën e monitorimit dhe auditimit parlamenti dhe komisionet e tij mund të shqyrtojnë analizat gjinore dhe auditimet gjinore të prodhuara nga Qeveria dhe/ose Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Vlera e shtuar e kampionëve brenda parlamentit

Pavarësisht nga shkalla e zbatimit të BPGJ-së në procesin buxhetor, ka një vlerë të shtuar të pasurit e një kampioni të BPGJ brenda parlamentit. Brenda Parlamentit, personi i duhur – një deputet, kryetar komisioni, ose një nëpunës i nivelit të lartë – mund të jetë katalizator që parlamenti të marrë rolin e tij kyç në BPGJ. Nga jashtë, të pasurit e një kampioni që është i gatshëm të shtyjë përpara agjendën e BPGJ me ekzekutivin, median dhe shoqërinë civile mund të kenë një ndikim të madh në adoptimin e një sistemi efektiv të BPGJ-së dhe përcaktimin e rolit për parlamentin në këtë sistem.

Kapacitetet e OSHC-ve për të analizuar buxhetin

Mësimet e nxjerra nga puna e mëparshme në BPGJ kanë treguar se aftësia për të ofruar analiza të pavarura të buxhetit ka një vlerë të shtuar të konsiderueshme për një parlament, duke i dhënë institucionit akses në të dhëna dhe analiza ai vetë nuk mund t'i kryente. Megjithatë, kapaciteti për të prodhuar analiza të këtij

lloji nga një OSHC nuk fitohet shpejt. Kjo kërkon punë të OSHC me ekonomistë, kontabilistë dhe ekspertë të tjerë teknikë.

Advokimi i BPGJ-së mund të vijë në shumë forma

Çelësi i advokimit është krijimi i vullnetit politik që do ta shtyjë ekzekutivin të miratojë parimet dhe mjetet e BPGJ-së. Në vend të kërkesës për të ndërtuar një sistem të plotë menjëherë, mund të jetë me vlerë për parlamentin të nxisë miratimit e elementëve themelore të sistemit të BPGJ. Për shembull, mbledhja e të dhënave të ndara sipas seksit është provuar të jenë e rëndësishme për BPGJ, pasi përpara se të ndërmerret çdo analizë është me rëndësi të kemi të dhëna të aksesueshme dhe nga ana tjetër analiza e të dhënave mund të na orientojë drejt miratimit të reformave të ndryshme. Marrja e raporteve të ministrive të linjës në bazë periodike (muajore; tremujore) mund të lejojë që parlamenti dhe komisionet e tij të marrin informacion të përditësuar mbi zbatimin e buxhetit nga perspektiva gjinore. Derisa një informacion i tillë të raportohet në mënyrë rutinore nga qeveria, është shumë e vështirë për një deputet që të luajë një rol aktiv në proces.

Aneksi 3: Pyetjet kryesore për analizën e kontekstit për punën e BPGJ

Kur stafi i UN Women dhe partnerët e tyre angazhojnë parlamentin në BPGJ, hapi i parë është të mbështetet analiza kontekstuale për të identifikuar faktorët që mund të ndikojnë në aftësinë e parlamentit për të ushtruar rol(in) në zbatimin e BPGJ-së. Pyetjet udhëzuese më poshtë ofrojnë një pikënisje për këtë analizë.

Përcaktoni qëllimin e analizës

1. Cilët faktorë specifikë kontekstualë po analizohen [politik, ekonomik, social]?
2. Kush do të jetë subjekti drejtues që kryen analizën dhe cilat palë të interesuara do të përfshihen?
3. Cilat janë nivelet e ndryshme të pushtetit dhe

objektivat e grupeve të ndryshme të interesit?

4. Si do të përfshihen në mënyrë kuptimplote gratë nga grupe të ndryshme në analizën e kontekstit?

5. Cili është objektivi i analizës, si do të përdoret dhe nga kush?

Konteksti aktual politik/ekonomik/social

1. Cilët faktorë gjeografikë, socio-ekonomikë ndikojnë në vend?

2. A kanë ndikuar ngjarjet specifike në vend në sistemin aktual politik dhe të menduarit politik në përgjithësi dhe/ose në lidhje me barazinë gjinore në veçanti?

3. A ka kërcënime të jashtme dhe/ose të brendshme për sistemin aktual politik?

4. Cilat janë burimet kryesore të financimit për vendin?

5. A janë përjashtuar historikisht gratë nga strukturat vendimmarrëse dhe nëse po, si? Çfarë roli ka luajtur kjo në vendimet se si janë hartuar dhe shpenzuar buxhetet?

6. Çfarë hapësirash ekzistojnë për angazhimin qytetar në sistemin politik dhe a kanë ndryshuar këto me kalimin e kohës? A janë në gjendje gratë nga të gjitha grupet të marrin pjesë në aksionin qytetar?

Legjislacioni dhe politika – Korniza formale

7. Çfarë angazhimesh ndërkombëtare, rajonale dhe/ose kombëtare për barazinë gjinore ekzistojnë?

8. Cili është kuadri ligjor nën të cilin është duke u zbatuar sistemi i menaxhimit të financave publike dhe/ose BPGJ në vend?

9. A ekzistojnë politika për barazinë gjinore (të përgjithshme dhe/ose sektoriale) dhe a kanë ato buxhete të alokuara për zbatimin e tyre?

10. Cilat palë të interesuara (shtetërore dhe joshtetërore) luajnë rol të rëndësishëm në hartimin e ligjeve dhe politikave dhe monitorimin e zbatimit të tyre?

Sistemet e pushtetit

11. Si ndërthuret gjinia me shpërndarjen e pushtetit formal dhe informal në shoqëri në aspektin e sferës publike (institucionet politike, institucionet sociale,

sundimi i ligji, tregu dhe ekonomia) dhe sfera private (jeta shtëpiake dhe familjare, marrëdhëniet intime)?

12. Si përkufizohet shoqëria civile dhe a ka kufizime në rolin e saj në sistemin politik?

13. A janë organizatat e grave dhe/ose gratë të përfshira në mënyrë aktive në dialogun publik mbi buxhetin?

Barrierat dhe mundësitë

14. Kush mund të advokojë zbatimin e BPGJ në pozitën e pushtetit formal? Kush mund të paraqesë sfida apo të kundërshtojë zbatimin e tij?

15. Çfarë hapësirash ekzistojnë (ose mund të ekzistojnë) që parlamenti të prezantojë analiza të ndryshme gjinore në fazat e ciklit buxhetor?

16. A ka çështje të reja që mund të ndikojnë në zbatimin e BPGJ [p.sh. Reformimi i sistemit mbi Menaxhimin e Financave Publike,; zgjedhjet]?

Aneksi 4: OZHQ 5 treguesi 5.c.1

Shënim: Pyetjet kryesore nga metodologjia e monitorimit të treguesit 5.c.1 janë paraqitur në Udhëzues sipas fazave të procesit buxhetor. Kjo Shtojcë ofron kriteret dhe pyetjet e zhvilluara nëpërmjet metodologjisë së treguesve. Kini parasysh se kriteri 3 është më i rëndësishëm për aktorët në nivel ekzekutiv dhe se sa për anëtarët e parlamentit, por të dhënat transparente/publike të prodhuara mund të përdoren nga deputetët. Treguesi synon të mbështesë qeveritë për të zhvilluar sistemeve të duhura gjurmimi të buxhetit dhe për të vendosur në dispozicion të publikut informacionet mbi ndarjen e shpenzimeve buxhetore për barazinë gjinore. Sistemi duhet të drejtohet nga Ministria e Financave në bashkëpunim me Ministrinë e Linjës dhe Makineritë Kombëtare të Barazisë Gjinore dhe të mbikëqyret nga një organ i pavarur si Parlamenti apo Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Konceptet:

Për të përcaktuar nëse një vend ka një sistem për të gjurmuar dhe bërë publike shpenzimet buxhetore për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, pyetëtori i

mëposhtëm i dërgohet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë:

Kriteri 1. Cilat nga aspektet e mëposhtme të shpenzimeve publike janë pasqyruar në programet e qeverisë dhe alokimet e burimeve të tij? (Në vitin e fundit fiskal të përfunduar)

Pyetja 1.1. A ka politika dhe/ose programe të qeverisë të dizajnuara për të adresuar qëllimet e mirë-identifikuara të barazisë gjinore, duke përfshirë ato ku barazia gjinore nuk është objektivi primar (si shërbimet publike, mbrojtja sociale dhe infrastruktura) por përfshijnë veprime për të ngushtuar/ eliminuar boshllëqet gjinore?

Pyetja 1.2. A kanë këto politika dhe/ose programe burime adekuate të alokuara brenda buxhetit, të mjaftueshme për të përmbushur njëkohësisht objektivat e tyre të përgjithshëm dhe objektivat e barazisë gjinore?

Pyetja 1.3. A ka procedura për të siguruar që këto burime janë ekzekutuar sipas buxhetit?

Kriteri 2. Deri në çfarë mase sistemi juaj i Menaxhimit të Financave Publike promovon qëllime të lidhura me gjininë ose të përgjigjshme gjinore? (Në vitin e fundit fiskal të përfunduar)

Pyetja 2.1. A lëshon Ministria e Financave/zyra e Buxhetit qarkore/ udhëzime që ofrojnë udhëzime specifike për ndarjet buxhetore të përgjigjshme gjinore?

Pyetja 2.2. A janë politikat dhe programet kryesore, të propozuara për t'u përfshirë në buxhet, subjekt i një vlerësimi ex ante të ndikimit gjinor?

Pyetja 2.3. A përdoren statistikat dhe të dhënat e ndara sipas gjinisë nëpër politikat dhe programet kryesore në një mënyrë që mund të informojë vendimet e politikave të lidhura me buxhetin?

Pyetja 2.4. A jep qeveria, në kuadër të buxhetit, një deklaratë të qartë të objektivave të lidhura me gjininë (d.m.th., pasqyra e buxhetit gjinor ose legjislacioni i buxhetit të përgjigjshëm gjinor) ?

Pyetja 2.5. A i nënshtrohen shpenzimet buxhetore "etiketimit" duke përfshirë edhe klasifikuesit funksionale, për të identifikuar lidhjen e tyre me objektivat e barazisë gjinore?

Pyetja 2.6. A janë politikat dhe programet kryesore që i nënshtrohen ndikimit subjekt i vlerësimit gjinor ex post?

Pyetja 2.7. A është buxheti në tërësi subjekt i një auditimi të pavarur për të vlerësuar deri në çfarë mase ai promovon politika të përgjigjshme gjinore?

Kriteri 3. A bëhen publike shpenzimet buxhetore për barazi gjinore dhe fuqizimin e grave? (në viti i fundit fiskal i përfunduar)

Pyetja 3.1. A publikohen të dhënat për shpenzimet e ndara për barazisë gjinore?

Pyetja 3.2. Nëse janë publikuar, a janë publikuar këto të dhëna në mënyrë të arritshme në Faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (ose zyra përgjegjëse për buxhetin) dhe/ose përmes njoftimeve publike për konsultim?

Pyetja 3.3. Nëse po, a janë publikuar të dhënat për ndarjet e shpenzimeve të barazisë gjinore në kohë të mjaftueshme⁹¹?

91 Informacioni mund të gjendet tek shënimi shpjegues mbi treguesin 5.c.1 të aksesueshme telk<https://unstats.un.org/wiki/display/SDGeHandbook/Indicator+5.c.1>.

